Kush nga inçizionet e mëposhtëme për drenimin e abcesit të radiks lingue është i saktë:

- A) Incizion ekstraoral në vijën mediane
- B) Incizion intraoral në sulkusin mandibulo-lingual
- C) Incizion në pjesën laterale të gjuhës
- D) Incizion në harkun palatoglos

PS)A

Pyetja 261 V)1

Pseudo parotiti është:

- A) Infeksion i gjëndrës parotis
- B) Infeksion i gjëndrës limfatike
- C) Infeksion i A.T.M
- D) Infeksion i veshit

PS)B

Pyetja 262 V)2

Diagnoza e një limfadeniti tuberkular nuk vendoset me :

- A) Anamnezë
- B) Biopsi
- C) Sialografi
- D) Provën Mantu

PS)C

Pyetja 263 V)1

Osteomyeliti zhvillohet me shumë ne :

- A) Mandibul
- B) Maxillë
- C) Sinusin maxillar
- D) Kockën zygomatike

PS)A

Pyetja 264 V)1

Drenazhi i sinusit maxillar bëhet në:

- A) Meatus nazi inferior
- B) Meatus nazi media
- C) Tubus faringeum
- D) Meatus nazi superior

PS)B

Pyetja 265 V)2

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është pjesë e tumorit mikst të gjëndrës parotis:

- A) Sipërfaqe lobulare
- B) Ecuri e ngadaltë
- C) Simptomi vincenti
- D) Krepitacione

PS)C

Pyetja 266 V)1

Ranula nuk zhvillohet:

- A) Mbi muskulin mylohyoid
- B) Nën muskulin mylohyoid
- C) Në të dy variantet e mësipërme
- D) Mbi muskulin platizma

PS)D

Pyetja 267 V)1

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është pjesë e sindromit Sjogren:

- A) Kserostomi
- B) Ksenofobi
- C) Kseroftalmi
- D) Edemë e gjëndrave parotis

PS)B

Pyetja 268 V)1

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristike për patologjitë e ATM:

- A) Dhimbje në gjuhë
- B) Çrregullime në shije dhe në nuhatje
- C) Dhimbje në farings
- D) Ndjesia e trupit të huaj

PS)C

Pyetja 269 V)3

Luksacioni recidivant nuk shkaktohet nga :

- A) Epilepsia
- B) Histeria
- C) Dismorfozat e nofullave
- D) Traumat

PS)D

Pyetja 270 V)2

Kush nga origjinat e mëposhtme të ankilozës nuk është e vërtetë:

- A) Gjenetike
- B) Infeksioze
- C) Traumatike
- D) Kongenitale

PS)A

Pyetja 271 V)1

Me cilat nga patologjitë e mëposhtme nuk bëhet diagnoza diferenciale e ankilozës së ATM:

- A) Laterogenitë
 - B) Mikrogenitë
 - C) Hemiatrofitë faciale
 - D) Makroglosia
- PS)D

Pyetja 272 V)1

Kush nga kontrakturat e mëposhtme nuk është e vërtetë:

- A) Desmogjene
 - B) Dermogjene
 - C) Otogjene
 - D) Mikste
- PS)C

Pyetja 273 V)1

Kush nga komponentët e mëposhtëm nuk merr pjesë në klasifikimin e dhimbjeve të kokës dhe të qafës:

- A) Komponenti sialogjen
 - B) Komponenti neurologjik
 - C) Komponenti muskulo skeletik
 - D) Komponenti vaskular
- PS)A

Pyetja 274 V)1

Kush nga neuralgjitë e mëposhtme nuk egziston:

- A) Neuralgji trigeminale
 - B) Neuralgji post herpetike
 - C) Neuralgji post imazherike
 - D) Neuralgji post traumatike
- PS)C

Pyetja 275 V)1

Kush nga emërtimet e mëposhtme nuk i takon neuralgjisë trigeminale:

- A) Tiku doloroz
 - B) Neuralgji epileptiforme
 - C) Sëmundja e Trusosë
 - D) Sëmundja Karapanziç
- PS)D

Pyetja 276 V)2

Diagnoza diferenciale e neuralgjisë trigeminale nuk bëhet me:

- A) Sindromin Sllader
 - B) Sindromin Eagle
 - C) Sklerozën multiple
 - D) Sindromin Mafuci
- PS)D

Pyetja 277 V)2

Neuralgjia e Hunterit ka origjinë nga:

- A) Tumoret
 - B) Herpes Zoster
 - C) Traumat
 - D) Gjenetike
- PS)B

Pyetja 278 V)2

Klasifikimi i dëmtimeve nervore nga Sunderland jepet me:

- A) Tre klasa
 - B) Katër klasa
 - C) Pesë klasa
 - D) Gjashtë klasa
- PS)C

Pyetja 279 V)3

Kush nga shkaqet e mëposhtme nuk egziston për paralizën faciale:

- A) Shkaqet neurologjike
 - B) Shkaqet traumatike
 - C) Intoksikacionet nga plumbi
 - D) Intoksikacioni nga striknina
- PS)D

Pyetja 280 V)3

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk janë shoqëruese të paralizës faciale:

- A) Dhimbje në fytyrë
 - B) Çrregullime të shijes
 - C) Vështirësi në nuhatje
 - D) Ndryshime të pamjes
- PS)C

Pyetja 281 V)2

Diagnoza diferenciale e paralizës faciale nuk bëhet me :

- A) Tetanozin
 - B) Traumën e kockës temporale
 - C) Infarktin e myokardit
 - D) Hemoragjitë cerebrale
- PS)C

Pyetja 282 V)2

Kush nga egzaminimet e mëposhtme nuk ndihmon për diagnozën e paralizës faciale:

- A) Gjak komplet
 - B) Audiogramë
 - C) Sialogramë
 - D) Titri i Lyme
- PS)C

Pyetja 283 V)3

Gradat e paralizës së nervit facial janë përshkruar nga :

- A) House dhe Brackman
- B) Frost
- C) Lyme
- D) Schirmer

PS)A

Pyetja 284 V)3

Paraliza e Bellit është me origjinë :

- A) Virusale
- B) Idioptike
- C) Vaskulare
- D) Immunologjike

PS)B

Pyetja 285 V)2

Acycloviri përdoret për trajtimin e :

- A) Sindromit Ramsay-Hunt
- B) Paralizën e Bellit
- C) Sindromin Melkerson-Rosendal
- D) Semundjen e Lymës

PS)A

Pyetja 286 V)2

Paraliza traumatike e nervit facial nuk shkaktohet nga :

- A) Traumat e kockës temporale
- B) Traumat e maxillës
- C) Face liftin
- D) Cistektominë brankiale

PS)B

Pyetja 287 V)2

Kush nga nervat e mëposhtëm përdoret si graft ndërmjetës për anastomozën e nervit facial:

- A) Nervi aurikularis magnus
- B) Nervi vagus
- C) Nervi lingual
- D) Nervi infratemporal

PS)A

Pyetja 288 V)1

Kush nga klasifikimet e mëposhtme të frakturave nuk egziston:

- A) Kominutive
- B) Infractio
- C) Patologjike
- D) Normotensive

PS)D

Pyetja 289 V)1

Kush nga traumat koronare nuk egziston :

- A) Fisurë
- B) Frakturë simplex
- C) Frakturë genoine
- D) Frakturë komplikata

PS)C

Pyetja 290 V)1

Kush nga frakturat radikulare të dhëmbit nuk egziston:

- A) Apikale
- B) Guerin
- C) Oblike
- D) Longitudinale

PS)B

Pyetja 291 V)1

Kush nga traumat dento-alveolare nuk egziston:

- A) Contuzio
- B) Continue
- C) Intruzio
- D) Ektruzio

PS)B

Pyetja 292 V)1

Kush nga traumat gingivo-mukoze nuk egziston:

- A) Vulnerabël
- B) Laceracio
- C) Contusio
- D) Abrasio

PS)A

Pyetja 293 V)1

Kush nga traumat e dhëmbit trajtohet nga kirurgu O.M.F:

- A) Traumat e kurorës
- B) Traumat korono-radikulare
- C) Traumat oblike të rrënjës
- D) Traumat e koletit të dhëmbit

PS)C

Pyetja 294 V)2

Kush nga thëniet e mëposhtme nuk është e vërtetë në frakturat në fëmijë:

- A) Fraktura në dru jeshil
- B) Dëmtim i zonave të rritjes
- C) Përdoret më shumë mjekimi ortopedik
- D) Kërkohet anestezi e përgjithshme

PS)C

Pyetja 295 V)2

Shkalla Glasgow përmban:

- A) 3-12 pikë
- B) 3-15 pikë
- C) 3-13 pikë
- D) 3-17 pikë

PS)B

Pyetja 296 V)1

Kush nga ndërlikimet e vona të një të traumatizuar nuk është e saktë:

- A) Malokluzion
- B) Pseudomembranozë
- C) Pseudoartrozë
- D) Cikatricë

PS)B

Pyetja 297 V)1

Kush nga emërtimet e mëposhtme për mjekimin ortopedik të frakturave nuk është i vërtetë:

- A) Ligatura Ivi
- B) Shina Erich
- C) Ligatura e Heimlich
- D) Shina Winter

PS)C

Pyetja 298 V)2

Kush nga klasifikimet e mëposhtme të plagëve nuk është i vërtetë:

- A) Vulnus Schlopetarum
- B) Vulnus perforatum
- C) Vulnus Morsum-Viperum
- D) Vulnus tetani

PS)D

Pyetja 299 V)1

Kush nga faktorët e mëposhtëm nuk ndikon në formimin e cikatricës:

- A) Puberteti
- B) Trauma
- C) Abrasio
- D) Grup gjaku A

PS)C

Pyetja 300 V)1

Kush nga veçoritë e mëposhtme nuk i përket tumoreve beninjë:

- A) Zhvillim ekspansiv
- B) Nuk recidivojnë shpesh
- C) Nuk japin gjëndje kahektike
- D) Rriten shpejt

PS)D

Pyetja 301 V)3

Kush nga thëniet e mëposhtëme nuk është e saktë për kistat radikular:

- A) Zenë 20 % të kistave të nofullave
- B) Takohen më shumë në moshat 20-40 vjeç
- C) Takohen më shumë në dhëmbët frontal sipër
- D) Prekin si dhëmbët e qumështit dhe ato të përherëshëm

PS)A

Pyetja 302 V)2

Kista e kanalit nazopalatin është :

- A) Kistë radikular
- B) Kistë folikular
- C) Kistë epidermoid
- D) Kist maksilar

PS)D

Pyetja 303 V)3

Kista globulo maksilar ka formë:

- A) Zemre
- B) Dardhë me bisht nga poshtë
- C) Dardhë me bisht nga sipër
- D) Formë qepe

PS)B

Pyetja 304 V)1

Kush nga përmbajtjet e mëposhtme të kistit traumatik nuk egziston:

- A) Lëng kistik (kristalet e kolesterolit)
- B) Gjak
- C) Ajër
- D) Bosh

PS)A

Pyetja 305 V)2

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është karakteristike e kistave të nofullave:

- A) Malokuzioni
- B) Krepitacioni
- C) Zhurmë në veshë
- D) Fluktuacion

PS)C

Pyetja 306 V)1

Kush nga kistat e mëposhtme nuk zhvillohet në sinusin maksilar:

- A) Kista brankial
- B) Mukocele
- C) Kista retencional
- D) Pseudokistat

PS)A

Pyetja 307 V)2

Kush nga kistat e mëposhtëm nuk bën pjesë në kistat e indeve të buta:

- A) Kista parazitare
- B) Kista sebace
- C) Kista epidermoid
- D) Kista epidermal

PS)C

Pyetja 308 V)1

Dhëmbët e përmbajtur nuk mund të trajtohen me:

- A) Ekstraksion
- B) Ortodonci
- C) Autotransplant
- D) Hetero-transplant

PS)D

Pyetja 309 V)2

Kaninët e përmbajtur maksilarë janë më shumë të vendosur:

- A) Nga ana vestibulare
- B) Nga ana palatinale
- C) Në pozicion vestibulo-palatinal
- D) Në pozicion vertikal

PS)B

Pyetja 310 V)1

Kendi i Bevelit ka të bëjë me:

- A) Kirurgjinë ortognatike
- B) Kirurgjinë estetike
- C) RezekSIONIN apikal
- D) Dhëmbët e përmbajtur

PS)C

Pyetja 311 V)1

Çfarë është pa vlerë në repozicionimin kirurgjikal të dhëmbëve:

- A) Rrënja e paformuar
- B) Hapësira e nevojshme
- C) Tëketë inde të buta dhe të mjaftueshme
- D) Regjioni

PS)D

Pyetja 312 V)1

Rënia e rrënjës në sinus nuk vjen për arsye të:

- A) Mjekut
- B) Pacientit
- C) Anatomisë
- D) Patologjisë

PS)B

Pyetja 313 V)1

Kush nga format e hemoragjisë pas interventit nuk ekziston:

- A) Primare
- B) Reflektore
- C) Intermediare
- D) Sekondare

PS)C

Pyetja 314 V)2

Kush nga simptomat nuk është në klasen e IV të hemoragjisë:

- A) Letargji
- B) Koma
- C) Epistotonus
- D) Hypotension

PS)C

Pyetja 315 V)1

Kush nga komplikacionet nuk ndodh në kirurgjinë paradontale:

- A) Infeksioni
- B) Recidiva
- C) Problemi estetik
- D) Emfizema subkutane

PS)D

Pyetja 316 V)3

Kush nga procedurat nuk bën pjesë në kirurgjinë preprotetike:

- A) G,B,R (rigjenerim kockor i drejtuar)
- B) Sinus lift
- C) Face lift
- D) Distraksion osteogjeneza

PS)C

Pyetja 317 V)1

A është ndërhyrje preprotetike në indet e buta:

- A) Korrigjimi labium duplex
- B) Korrigjimi i makroglosisë
- C) Komisuro-plastika
- D) Repozicionimi i nervit facial

PS)D

Pyetja 318 V)1

Kush nga rrugët e përhapjes së infeksionit në regjionin O.M.F nuk ekziston:

- A) Rruga transosea
- B) Rruga transmukoza
- C) Rruga limfatike
- D) Rruga centrale

PS)D

Pyetja 319 V)2

Kush nga rregjionet e mëposhtme nuk preket nga infeksionet përreth mandibulës:

- A) Parafaringeal
 - B) Intrakranial
 - C) Retrofaringeal
 - D) Mediastini
- PS)B

Pyetja 320 V)3

Graviteti i infeksionit sipas Flynn jepet në:

- A) Tre shkallë
 - B) Katër shkallë
 - C) Dy shkallë
 - D) Pesë shkallë
- PS)B

Pyetja 321 V)2

Kush nga komplikacionet loko-regjionale të proceseve infeksioze nuk ekziston:

- A) Trombozë e venës jugulare
 - B) Fistula intra dhe ekstraorale
 - C) Septicemia
 - D) Asfiksi
- PS)C

Pyetja 322 V)2

Kush nga mjekimet në absesin periapikal nuk ekziston:

- A) Trepanim i dhëmbit
 - B) Antibiotiko-terapi
 - C) Ekstraksion
 - D) Incision+drenim ekstraoral
- PS)D

Pyetja 323 V)1

Parulisi është:

- A) Abces periapikal
 - B) Abces submukoz
 - C) Abces subperiostal
 - D) Abces palatinal
- PS)B

Pyetja 324 V)2

Abcesi bukal nuk vendoset:

- A) Mbi muskulin bucinator
 - B) Nën muskulin bucinator
 - C) Nën lekurë
 - D) Mbi kockë
- PS)D

Pyetja 325 V)1

Kush nuk është shkaktar i abcesit palatinal:

- A) Lateral i sipërm
 - B) Premolarët dhe molarët e sipërm
 - C) Centrali i sipërm
 - D) Osteomyeliti i procesit alveolar
- PS)C

Pyetja 326 V)1

Kush nga shkaktarët e infeksioneve periorbitale është më i rrallë:

- A) Sinuziti
 - B) Dhëmbët
 - C) Osteomyeliti i orbitës
 - D) Traumat e këtij regjioni
- PS)B

Pyetja 327 V)2

Kush nga shkaktarët e trombozës së sinusit kavernoze nuk ekziston:

- A) Pleksusi venoz pterigoid
 - B) Vena angulare
 - C) Vena oftalmike
 - D) Vena meningea media
- PS)D

Pyetja 328 V)3

Në një situatë septike gjendja më e rëndë është:

- A) Sepsisi
 - B) Septicemia
 - C) Sindroma e disfunkcionit organor të shumfishtë
 - D) Shoku septik
- PS)C

Pyetja 329 V)1

Nuk marrin pjesë në infeksionin e llozhës sublinguale:

- A) Kalkulat salivare
 - B) Infeksionet e premolarëve dhe molarëve
 - C) Tonsiliti
 - D) Trupat e huaj
- PS)C

Pyetja 330 V)1

Nuk është shkaktar i abcesit të gjuhës:

- A) Traumat
 - B) Trupat e huaj
 - C) Tumoret
 - D) Ankiloglosia
- PS)D

Pyetja 331 V)1

Nuk marrin pjesë në shkaktimin e abscesit të llozhës submaseterike:

- A) Traumat
 - B) Infeksionet e molarit të tretë
 - C) Osteomyeliti i këndit të nofullës
 - D) Tonsiliti
- PS)D

Pyetja 332 V)2

Kush nga thëniet e mëposhtme për fascitin nekrotizant të qafës është e vërtetë:

- A) Infeksion i shpejtë subkutan
 - B) Infeksion muskular
 - C) Osteomyelit i vertebrave cervikale
 - D) Tromboemboli e venave jugulare
- PS)A

Pyetja 333 V)1

Diagnoza diferenciale e osteomyelitit kronik nuk bëhet me :

- A) Tumoret malinje të nofullave
 - B) Osteoradionekrozën
 - C) Morbus Paget
 - D) Osteomën e nofullave
- PS)D

Pyetja 334 V)2

Kush nga rrugët për shkaktimin e sinuzitit maksilar nuk është e vërtetë:

- A) Rruga hematogjene
 - B) Rruga alergjike
 - C) Rruga odontogjene
 - D) Rruga limfogjene
- PS)D

Pyetja 335 V)2

Kush nga rrugët për rënien e trupave të huaj në sinus nuk është e vërtetë:

- A) Rruga orale
 - B) Rruga nazale
 - C) Rruga hypofaringeale
 - D) Rruga traumatike
- PS)C

Pyetja 336 V)2

F.E.S.S. është një metodë diagnostikuese dhe trajtuese për:

- A) Kalkulat salivare
 - B) Sinusin maksilar
 - C) ATM
 - D) Traumat
- PS)B

Pyetja 337 V)1

Kush nga metodat për trajtimin e kistave nuk përdoret:

- A) Cistotomi
- B) Cistektomi
- C) Dekomprimim
- D) Dekoagulim

PS)D

Pyetja 338 V)2

Kush nga shkaktarët nuk akuzohet për recidivën e keratokistave:

- A) Qelizat epiteliale
- B) Epiteli
- C) Kocka
- D) Pareti i kistës

PS)C

Pyetja 339 V)2

Kush është shkaktar i kistës nazo-labiale:

- A) Hunda
- B) Kanali nazo-lakrimal
- C) Centralët e sipërm
- D) Sinusi maksilar

PS)B

Pyetja 340 V)1

Defektet osteoporotike të nofullave kanë nevojë për:

- A) RezekSION parcial
- B) Kyretazh të kockës
- C) Asnjë lloj trajtimi
- D) Antibiotiko-terapi

PS)C

Pyetja 341 V)2

Kush nga kistat e mëposhtme nuk zhvillohet në qafë:

- A) Kistat brankial
- B) Kistat tireogloss
- C) Kistat dermoid
- D) Kistat subepidermal

PS)D

Pyetja 342 V)1

Kush është shkaktar i osteodistrofisë fibroze:

- A) Çrregullimi i gjendrës tiroide
- B) Çrregullimi i gjendrës paratiroide
- C) Çrregullimi i hipofizës
- D) Gjendra mbiveshkore

PS)B

Pyetja 343 V)1

Kerrubizmi është:

- A) Tumor malinjë
 - B) Patologji e gjendrave të pështymës
 - C) Patologji e gjendrave limfatike
 - D) Patologji e mandibulës
- PS)D

Pyetja 344 V)1

Hemangioma intrakockore nuk trajtohet me:

- A) Ro-terapi
 - B) RezekSION në bllok
 - C) Embolizim
 - D) Alkolizim
- PS)D

Pyetja 345 V)2

Kush nga format e granulomës euzinofile nuk ekziston:

- A) E lokalizuar
 - B) Profunde
 - C) Difuze
 - D) E gjeneralizuar
- PS)B

Pyetja 346 V)1

Kush nga sindromat e patologjive vaskulare nuk ekziston:

- A) Sturge-Weber
 - B) Kasabach-Merrit
 - C) Hippel-Lindau
 - D) Pierre-Robin
- PS)D

Pyetja 347 V)1

Kush nga gjendjet prekanceroze nuk ekziston:

- A) Linea-alba
 - B) Leukoplakia
 - C) Eritroplazia
 - D) Lichen Rubber Planus
- PS)A

Pyetja 348 V)1

Kush nga format klinike të kancerit oral nuk ekziston:

- A) Forma ulcerative
 - B) Forma limfoide
 - C) Forma proliferative
 - D) Forma nodular
- PS)B

Pyetja 349 V)3

Limfonoduli Sentinel përcaktohet me:

- A) Imunohistiokimi
- B) Punksion biopsi
- C) Citologji eksfoliative
- D) Brush biopsi

PS)A

Pyetja 350 V)2

Kush nga teknikat nuk përdoret për korrigjimin e defekteve të fituara të buzës së poshtme:

- A) Karapandzic
- B) Fujimori
- C) Gillies
- D) Millard

PS)D

Pyetja 351 V)1

Kush nga patologjitë nuk zhvillohet në qafë:

- A) Tumoret neurale të kreshtës
- B) Laringocelat
- C) Traumat
- D) Disfunksioni i Eustakut

PS)D

Pyetja 352 V)2

Kush nga komplikacionet e disekSIONIT të qafës nuk qëndron:

- A) Rënia e shpatullës
- B) Verbim
- C) Nekrozë e karotisit
- D) Shurdhimi

PS)D

Pyetja 353 V)1

Klasifikimi sipas Clark është për:

- A) Ca kutis
- B) Melanoma malinje
- C) Sarkomën e nofullave
- D) Karcinomën e nofullave

PS)B

Pyetja 354 V)2

Skip metastaza është:

- A) Në nivelin e parë
- B) Në nivelin e dytë ose të tretë
- C) Në mushkëri
- D) Në mëlçi

PS)B

Pyetja 355 V)2

Kush nga transplantet kutane nuk ekziston:

- A) Ollier-Thiersch
- B) Blair-Brown
- C) Wolfe-Krause
- D) Bechet

PS)D

Pyetja 356 V)1

Kush nga lembot nuk ekziston:

- A) Lembo bilobare
- B) Lembo romboide
- C) Z-platik
- D) Lembo yll

PS)D

Pyetja 357 V)1

Kush nga lembot nuk ekziston:

- A) Avancuese
- B) Rrotulluese
- C) Përputhese
- D) Transpozuese

PS)C

Pyetja 358 V)1

Keratokista nuk trajtohet me:

- A) Cystektomi
- B) Cystektomi dhe rezeksion parcial
- C) Kyretazh
- D) Rezeksion parcial

PS)C

Pyetja 359 V)1

Kush nga simptomat e mëposhtme është karakteristikë e sindromit Pierre Robin:

- A) Cianoze
- B) Artrit reumatoid
- C) Artrit reumatizmal
- D) Alopeci

PS)A

Pyetja 360 V)1

Bllokimi i rrugëve të sipërme ajrore në sindromin Pierre Robin përveç të tjerave trajtohet me:

- A) Mandibular distraksion osteogjenezë
- B) Kelioplastikë
- C) Aparat fiks ortodontik
- D) Hyperbarik O2 terapi

PS)A

Pyetja 361 V)3

Kush nga shkaqet e mëposhtme nuk akuzohet për makroglosinë:

- A) Neurofibromatoza
- B) Ulçera dekubitale
- C) Akromegalia
- D) Duktus tyreoglos

PS)B

Pyetja 362 V)1

Kush nga teknikat e mëposhtme nuk përdoret në zëvendësimin e defekteve të krijuara pas maksilektomisë totale:

- A) Flapi temporal myo-facial
- B) Flapi osteo-facial temporo parietal
- C) Flapi rrotullues cerviko-pektoral
- D) Grafti Olier-Tiersh

PS)D

Pyetja 363 V)2

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është karakteristikë e defekteve të lindura të qiellzës:

- A) Çrregullimet fizike dhe mentale
- B) Hipernazaliteti
- C) Hiponazaliteti
- D) Disfunksioni i tubit të Eustakut

PS)C

Pyetja 364 V)1

Ekzaminimi rongenologjik për dhëmbët shtyllë në punime fikse ka vlerë:

- A) Para fillimit të trajtimit protetik
- B) Gjatë trajtimit protetik
- C) Pas trajtimit protetik
- D) Të gjitha të vërteta

PS)D

Pyetja 365 V)1

Kush nga specialistët e mëposhtme ka më pak mundësi për shkaktimin e sinuzitit maksilar odontogjen:

- A) Terapefti stomatolog
- B) Ortopedi
- C) Paradontologu
- D) Ortodonti

PS)C

Pyetja 366 V)2

Cili nga veprimet e mëposhtme nuk është pjesë e ndikimit biologjik të rrezeve lazer në O.M.F:

- A) Stimulon rigjenerimin dhe epitelizimin
- B) Veprim antiinflamator
- C) Stimulon sistemin imun
- D) Ngadalëson qarkullimin e gjakut në gjëndrat e pështymës apo ATM

PS)D

Pyetja 367 V)2

Të sëmurët me keilo-gnato-palato skize futen në grupin e rasteve me paaftësi:

- A) Të rëndë
- B) Gjysëm të rëndë
- C) Të lehtë
- D) Gjysëm të lehtë

PS)B

Pyetja 368 V)1

Kush nga variantet e mëposhtme nuk ka vlerë për kirurgun kur aplikon një rezeksion apikal apo cistektomi:

- A) Mbushja si në gjërësi dhe në gjatësi e rrënjës së dhëmbit
- B) Mbushja e dhëmbit 1mm nën apeksin radiologjik
- C) Vitaliteti i dhëmbëve fqinj
- D) Mbushja korrekte e kurorës së dhëmbit fqinj

PS)D

Pyetja 369 V)1

Kartela e të sëmurit ka vlerë:

- A) Mjekësore
- B) Ligjore
- C) Shkencore
- D) Të tri variantet bashke

PS)D

Pyetja 370 V)2

Kush nga arsyet e mëposhtme nuk ndikon për dështimin e rezeksionit apikal:

- A) Afërsia me kavitetet natyrale
- B) Prania e infeksionit në kanal in e rrënjës së amputuar
- C) Dhëmbët fqinj
- D) Imunodeficienca

PS)A

Pyetja 371 V)2

Në frakturat subkondilare të mandibulës mjekimi kirurgjikal nuk realizohet me:

- A) 1 pllakë të vetme me 4 vrima
- B) 2 pllaka me 4 vrima
- C) Pllakë katërkëndëshe
- D) Pllakë në formë trapezi

PS)C

Pyetja 372 V)1

Përcaktimi i moshës biologjike për të vlerësuar drejt maturitetin dentar dhe skeletik nuk bëhet me anë të:

- A) Moshës kronologjike
- B) Përcaktimi i shënjave seksuale sekondare
- C) Zhvillimi dentar në bazë të kalçifikimit të dhëmbëve permanentë
- D) Osifikimi skeletar

PS)A

Pyetja 373 V)1

Implanti intrakockore është një procedurë:

- A) Kirurgjikale
 - B) Paradontale
 - C) Protetike
 - D) Të tri variantet sëbashku
- PS)D

Pyetja 374 V)1

Sindromat malformative shoqëruese të skizave nuk hasen më shumë në:

- A) Defektet e buzës
 - B) Defektet e buzës dhe qiellzës
 - C) Defektet e palatumit
 - D) Defektet bilaterale buzë dhe qiellzë
- PS)A

Pyetja 375 V)2

Kush nga komplikacionet e mëposhtme nuk ndodh në trajtimin kirurgjikal të frakturës së procesit kondilar:

- A) Dëmtimi i arteries temporale
 - B) Dëmtimi i veshit të brendshëm
 - C) Dëmtimi i arteries maksilare interna
 - D) Dëmtimi i nervit facial
- PS)B

Pyetja 376 V)1

PET pozitron emission tomografi nuk ka vlera për:

- A) Përcaktimin e heqjes së masës tumorale në kufij onkologjik
 - B) Vlerësimin e recidivës post operatore
 - C) Në rritjen e mbijetesës së pacientit
 - D) Në vlerësimin e limfonodulave metastatike
- PS)C

Pyetja 377 V)1

Cila nga mënyrat e mëposhtme nuk përdoret në trajtimin e lezioneve vaskulare:

- A) Ultrasound terapia
 - B) Terapi me steroid
 - C) Elektrokirurgjia
 - D) Nd:YAG lazeri
- PS)A

Pyetja 378 V)1

Në cilat nga osteotomitë që përdoren në kirurgjinë ortognatike mund të perfitohet më shumë bonegraft:

- A) Le Fort 1 osteotomi
 - B) Obwegeser -Dal Pon me shtytje prapa
 - C) Obwegeser -Dal Pon me tërheqje përpara
 - D) Le Fort 2 osteotomia
- PS)B

Pyetja 379 V)3

Kush nga faktorët e mëposhtëm ndikon më shumë në suksesin e implantit:

- A) Cilësia e metalit
- B) Veshja e implantit
- C) Biokompatibiliteti
- D) Mosha e pacientit

PS)C

Pyetja 380 V)3

Cili nga kufijtë e gjëndrës parotis nuk është i saktë:

- A) Nga brënda lidhet me llozhën pterigomandibulare
- B) Nga përpara ramus ascendant mandibule dhe muskuli maseter
- C) Nga prapa veshi, mastoid dhe muskuli SCM
- D) Nga poshtë lëkura

PS)A

Pyetja 381 V)3

Në një traumë faciale kush nga simptomat e mëposhtme duhet vlerësuar më shumë:

- A) Hematoma masive e fytyrës
- B) Të vjellat
- C) Frakturat multiple
- D) Vështirësia në gëlltitje

PS)B

Pyetja 382 V)3

Kush nga materialet e mëposhtme nuk përdoret për ngritjen e dyshemesë së sinusit maksilar:

- A) Materialet alogjenike
- B) Materialet ksenogjenik
- C) Grafti kutan
- D) Materialet aloplastike

PS)C

Pyetja 383 V)3

Moszhvillimi i maksilës nuk ndodh në pacientet e mëposhtëm që kanë bërë:

- A) Keloplastikë
- B) Gnatoplastikë (bonegraft)
- C) Palatoplastikë
- D) Asnjë prej teknikave të mësipërme

PS)D

Pyetja 384 V)3

Cila nga unazat muskulare të mëposhtme nuk luan rol në riparimin e defekteve të buzëve dhe qellzës:

- A) Unaza perinazale
- B) Unaza periorale
- C) Unaza periglosale
- D) Unaza velofaringeale

PS)C

Pyetja 385 V)3

Kush nga trekëndëshat e mëposhtëm nuk bën pjesë në trekëndëshin anterior të qafës:

- A) Submandibular
 - B) Karotid
 - C) Muskular
 - D) Omohyoid
- PS)D

Pyetja 386 V)3

Kush nga formacionet nuk ndodhet në trekëndëshin submandibular:

- A) Glandula submandibulare
 - B) Nervi recurrens
 - C) Arteria dhe vena faciale
 - D) Nervi hypoglossus
- PS)B

Pyetja 387 V)3

Kush nga variantet e mëposhtme është i vërtetë. Duktusi Stenoni vendoset:

- A) Mbi muskulin maseter
 - B) Nën muskulin maseter
 - C) Mbi muskulin bukal
 - D) Afër venës aurikulare posteriore
- PS)A

Pyetja 388 V)3

Kush nga incizionet nuk përdoret në vijën mediane të qafës për:

- A) Drenimin e abcesave submentale
 - B) Ekscizionin e kistave tyreoglos
 - C) Krikotirotominë
 - D) Ekspozimi i pleksusit brakial
- PS)D

Pyetja 389 V)3

Dëmtimi bilateral i nervit hypoglossus shkakton veshitë në :

- A) Në shikim
 - B) Në dëgjim
 - C) Në ushqyerje
 - D) Në lëvizjen e qafës
- PS)C

Pyetja 390 V)3

Incizion biopsia duhet të merret në thellësi të lezionit deri në :

- A) Ind normal
 - B) Kufirin midis indit normal dhe tumoral
 - C) Në mesin e lezionit
 - D) Në sipërfaqe të lezionit
- PS)A

Pyetja 391 V)3

Cili variant nuk ka vlerë gjatë interventeve me dializë:

- A) Shmangia e medikamenteve që metabolizohen dhe eliminohen nga veshkat
- B) Shtyhet interveni një ditë pas dializës
- C) Aplikohet antibiotiko profilaksia
- D) Monitorohet frymëmarrja

PS)D

Pyetja 392 V)3

Për pregatitjen e kirurgut dhe asistentit ka rëndësi:

- A) Larja sociale e duarve
- B) Larja aseptike
- C) Larja kirurgjikale
- D) Të tre variantet e mësipërme

PS)D

Pyetja 393 V)3

Cila nga fazat nuk merr pjesë në shërimin e plagës:

- A) Faza inflamatore
- B) Faza proliferative
- C) Faza e imbibimit
- D) Faza e rimodelimit

PS)C

Pyetja 394 V)3

Cila nga fazat klinike të anestezisë së përgjithshme nuk është e vërtetë:

- A) Analgjezia
- B) Eksitimi
- C) Kirurgjikale
- D) Terapeutike

PS)D

Pyetja 395 V)3

Cili nga qëllimet e anestezisë lokale nuk është i saktë:

- A) Psikologjik
- B) Diagnostik
- C) Terapeutik
- D) Anestetik

PS)A

Pyetja 396 V)3

Efekti i anestezisë dentare intrapulpare varet nga:

- A) Veprimi farmakologjik
- B) Nga presioni
- C) Të dyja të vërteta
- D) Nga infeksioni

PS)C

Pyetja 397 V)3

Kush nga komplikacionet e autoplastikës nuk ekziston:

- A) Infeksioni
- B) Mosndjeshmëria
- C) Flakia
- D) Përthithja

PS)D

Pyetja 398 V)3

Ekspanderet indore nuk përmbajnë:

- A) Kalcium
- B) Kolagjen
- C) Elastinë
- D) Hyaluronat

PS)A

Pyetja 399 V)3

Kush është shkaktari i vërtetëi shytave:

- A) Paramiksovirusi
- B) Virusi Epstein Bar
- C) Virusi Hiv-Aids
- D) Virusi Hepatit B

PS)A

Pyetja 400 V)3

Për tumorin Warthin akuzohet më shumë:

- A) Alkoli
- B) Duhani
- C) Malnutricioni
- D) Rrezatimi diellor

PS)B

Pyetja 401 V)3

Cilindroma nuk zhvillohet në:

- A) Gjendrën parotis
- B) Sinusin maxillar
- C) Hundë
- D) Vesh

PS)D

Pyetja 402 V)3

Sindromi Sjogren është përshkruar nga një:

- A) Stomatolog
- B) ORL
- C) Okulist
- D) Neurolog

PS)C

Pyetja 403 V)3

Në disfunktionin diskal të ATM, disku zhvendoset më shumë:

- A) Mbrapa kondilit
- B) Para kondilit
- C) Nga brenda kondilit
- D) Nga jashtë kondilit

PS)B

Pyetja 404 V)3

Trizmusi central akut nuk shkaktohet nga :

- A) Tetanozi
- B) Hiperterminja malinje
- C) Infarkti i trurit
- D) Infarkti i myokardit

PS)D

Pyetja 405 V)3

Kush nga medikamentet nuk përdoret në trajtimin e neuralgjisë trigeminale:

- A) Fentanyl
- B) Clonazepam
- C) Topiramat
- D) Amitriptilin

PS)A

Pyetja 406 V)3

Dhimbja e kokës Cluster është:

- A) Sindrom hepatik
- B) Sindrom vaskular
- C) Sindrom kockor
- D) Sindrom kutan

PS)B

Pyetja 407 V)3

Rehabilitimi i nervit facial nuk realizohet me:

- A) Face lift
- B) Transpozicion të muskulit temporal
- C) Tarsorafi
- D) Kapsulorafi

PS)D

Pyetja 408 V)3

Kush nga vijat e frakturave sipas Le Fort nuk ekziston:

- A) Frakturë inferiore
- B) Frakturë paramediane
- C) Frakturë piramidale
- D) Frakturë superiore

PS)B

Pyetja 409 V)3

Kush nga akseset nuk ekziston për trajtimin e traumave të regjionit O.M.F:

- A) Bikoronal
- B) Preaurikular
- C) Degllaving
- D) Mandibulo-lingual

PS)D

Pyetja 410 V)3

Në raste urgjence kur humbja e hemoragjisë është e klasës së katërt dhe grupi i gjakut nuk dihet jepet:

- A) Gjak grup A
- B) Gjak grup AB
- C) Gjak grup 0 Rh negative
- D) Gjak grup 0 Rh pozitiv

PS)C

Pyetja 411 V)3

Kush nga shprehjet nuk është e vërtetë për ruajtjen e mbijetesës së periodontit në një dhëmb që ka rënë nga goja dhe mund të reimplantohet:

- A) Ruajtja e tij në solucion fiziologjik 6-7 orë
- B) Ruajtja e tij në të thatë 1,5-2 orë
- C) Ruajtja e tij në qumësht për 12 orë
- D) Ruajtja e tij në kloreksidine për 24 orë

PS)D

Pyetja 412 V)3

Kush nga % e frakturave të mandibulës në nofulla me dhëmbë është më e madhe:

- A) Procesit artikular
- B) Procesit alveolar
- C) Procesit koronar
- D) Trupit të nofullës

PS)D

Pyetja 413 V)3

Kush nga metodat për trajtimin e frakturave të sinusit frontal nuk ekziston:

- A) Osteosinteza me tel
- B) Kantoplastika
- C) Osteosinteza me minipllaka
- D) Një ballon që fryhet nga hunda nëpërmjet kanalit nazo-lakrimal

PS)B

Pyetja 414 V)3

Kush nga manovrat nuk bën pjesë në trajtimin e frakturave të kockave nazale:

- A) Manovra e hipokratit
- B) Reponimi manual
- C) Tamponada anteriore
- D) Spekulum i hundës

PS)A

Pyetja 415 V)3

Kush nga shprehjet nuk është e vërtetë në trajtimin kirurgjikal të frakturave të palatumit:

- A) Vendosja e minipllakës në anën vestibulare
- B) Vendosja e minipllakës në anën palatinale
- C) Vendosja e minipllakës në të dyja anët
- D) Vendosja e minipllakës në anën nazale

PS)D

Pyetja 416 V)3

Kush nga mjekimet nuk është i vërtetë në trajtimin e frakturave të harkut zygomatik:

- A) Reponim transoral
- B) Shinë unimaxillare me grepa
- C) Osteosintezë me tel
- D) Osteosintezë me minipllakë

PS)B

Pyetja 417 V)3

Kush nga flora mikrobike nuk ka rëndësi primare në trajtimin e plagëve të regjionit O.M.F:

- A) Tetanozi
- B) Terbimi
- C) Kandida albikans
- D) Antraksi

PS)C

Pyetja 418 V)3

Ekimoza periorbitale është shenjë e frakturave të :

- A) Harkut zygomatik
- B) Kockes zygomatike
- C) Sinusit frontal
- D) Kockes temporale

PS)B

Pyetja 419 V)3

Hemoragjia subkonjuktivale është shenjë e frakturave të :

- A) Le Fort II
- B) Le Fort I
- C) ATM
- D) Harkut zygomatik

PS)A

Pyetja 420 V)3

Kufizimi i lëvizjeve të nofullës së poshtme është shenjë e frakturave të :

- A) Orbitës
- B) Kockes zygomatike
- C) Harkut zygomatik
- D) Le Fort I

PS)C

Pyetja 421 V)3

Ekimoza në pjesën distale të vestibulim maksilar është shenjë e frakturave të :

- A) Orbitës
 - B) Le Fort II
 - C) Le Fort III
 - D) Kockës Zygomatike
- PS)D

Pyetja 422 V)3

Disnivelimi i linjës bipulare është shenjë e frakturave të :

- A) Sinusit frontal
 - B) Kockës temporale
 - C) Kockës zygomatike
 - D) Le Fort I
- PS)C

Pyetja 423 V)3

Diplopia është shenjë e frakturave të :

- A) Le Fort I
 - B) Kockës nazale
 - C) Kockës temporale
 - D) Kockës zygomatike
- PS)D

Pyetja 424 V)3

Për rikonstrukcionin e orbitës nuk përdoret :

- A) PDS
 - B) MCS
 - C) Kartilazh
 - D) Meshe titani
- PS)B

Pyetja 425 V)2

Kush nga kockat e mësipërme nuk ndodhet përreth sinusit maksilar :

- A) Kocka maksilare
 - B) Kocka zygomatike
 - C) Vomeri
 - D) Pllaka pterigoide e kockës temporale
- PS)D

Pyetja 426 V)2

Kush nga egzaminimet imazherike të mëposhtme nuk përdoret në vlerësimin e sinusit maksilar :

- A) Ro grafi sinusesh
 - B) Ro grafi okluzale
 - C) Ro grafi laterolaterale
 - D) CT
- PS)C

Pyetja 427 V)3

Kush nga frakturat e mëposhtme e përfshin okluzionin :

- A) Frakturat e kockës nazale
- B) Frakturat e harkut zygomatike
- C) Frakturat e kockës zygomatike
- D) Frakturat e kockës frontale

PS)D

Pyetja 428 V)3

Rritja e distancës interkantale është shenjë e frakturave :

- A) Le Fort I
- B) Le Fort II
- C) Kockës temporale
- D) Sinusit frontal

PS)B

Pyetja 429 V)3

Fytyra me pamjen e hënës është karakteristikë e frakturave :

- A) Le Fort II
- B) Kockës zygomatike
- C) Harkut zygomatik
- D) Kockës nazale

PS)A

Pyetja 430 V)3

Rrjedhja e lengut cerebrospinal ka të bëjë me frakturën e :

- A) Kockës lakrimale
- B) Kockës sfenoidale
- C) Pllakën kribriforme
- D) Kockën temporale

PS)C

Pyetja 431 V)3

Hematoma në palatum mole është karakteristikë e frakturave :

- A) Le Fort II
- B) Le Fort III
- C) Frakturës së palatumit
- D) Frakturës së ATM

PS)C

Pyetja 432 V)2

Kush nga shkaktarët e mëposhtëm të hemoragjisë nuk është sistemik :

- A) Hipertensioni arterial
- B) Defiçit i vitaminës B1
- C) Defiçit i vitaminës K
- D) Çrregullimet e mëlçisë

PS)B

Pyetja 433 V)3

Kush nga analizat e mëposhtme nuk ka vlerë në vlerësimin e faktorëve të koagulimit:

- A) Koha parciale e tromboplastines
 - B) Numer-Platelet
 - C) Koha e protrombinës
 - D) Koha totale e tromboplastinës
- PS)D

Pyetja 434 V)2

Kush nga termat e mëposhtme nuk është i saktë për klasifikimin e hemoragjisë pas heqjes së dhëmbit :

- A) Hemoragji primare
 - B) Hemoragji intermitente
 - C) Hemoragji intermediare
 - D) Hemoragji sekondare
- PS)B

Pyetja 435 V)1

Hemoragjia intermediare vjen :

- A) Direkt pas interventit
 - B) 2 orë pa interventit
 - C) 8 orë pas interventit
 - D) 24 orë pas interventit
- PS)C

Pyetja 436 V)1

Kush nga materialet e mëposhtme nuk përdoret për ndalimin e hemoragjisë kockore pas ekstraksionit të dhëmbit:

- A) Dyll kocke
 - B) EACA
 - C) Surgicell
 - D) EACMF
- PS)D

Pyetja 437 V)3

Tamponada anteriore nazale nuk përdoret në ndalimin e hemoragjisë së regjionit :

- A) Nazo-faringeal
 - B) Faringeal
 - C) Hypofaringeal
 - D) Nazal
- PS)C

Pyetja 438 V)1

Pacientë që marrin shpesh zëvendësues gjaku janë të infektuar nga :

- A) Hepatiti
- B) Gastriti
- C) Nefriti
- D) Mastiti

PS)A

Pyetja 439 V)1

Kush nga rrugët e mëposhtme të përhapjes së infeksionit odontogjen nuk egziston :

- A) Spongioza e kockës
- B) Nën periost
- C) Në indet e buta
- D) Nga lekura

PS)D

Pyetja 440 V)2

Molaret e sipërm nuk japin infeksion :

- A) Në anën vestibulare
- B) Në sinus
- C) Në llozhën bukale
- D) Në llozhën pterigomandibulare

PS)D

Pyetja 441 V)3

Molari i parë mandibular nuk jep infeksion në :

- A) Llozhën pterigomandibulare
- B) Anën vestibulare
- C) Anën sublinguale
- D) Llozhën bukale

PS)A

Pyetja 442 V)2

Molari i dytë nuk jep infeksion në:

- A) Llozhën sublinguale
- B) Llozhën bukale
- C) Llozhën submandibulare
- D) Llozhën linguale

PS)D

Pyetja 443 V)2

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është e vertetë për anginën Ludwig:

- A) Edeme bilaterale e llozhave sublinguale
- B) Edeme bilaterale e llozhave submandibulare
- C) Edeme e llozhës submentale
- D) Edeme bilaterale e llozhave bukale

PS)D

Pyetja 444 V)2

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë për anginën Ludwig:

- A) Pacienti mban gojën gjysëm të hapur
- B) Pacienti ka jargë nga goja
- C) Pacienti ka edemë shoqëruese të glotisit
- D) Pacienti ka edemë bilaterale të ostiumeve të Stenonit

PS)D

Pyetja 445 V)2

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë për anginën Ludwig:

- A) Nuk lëviz gjuhën
- B) Ka trizmus
- C) Ka rrjedhje pusi nga duktus Stenoni
- D) Ka rrezik për asfiksi

PS)C

Pyetja 446 V)2

Kush nga mjekimet e mëposhtme nuk ka vlerë në trajtimin e anginës Ludwig:

- A) Antibiotiko-terapi e menjëherëshme
- B) Trakeostomi
- C) Incizion dhe drenim
- D) Bronkoscopia

PS)D

Pyetja 447 V)1

Kush nga klasifikimet e mëposhtme nuk është i vërtetë për osteomyelitin e nofullave :

- A) Osteomyelit supurativ
- B) Osteomyelit jo supurativ
- C) Osteomyelit specifik
- D) Osteomyelit nga elektromyografia

PS)D

Pyetja 448 V)2

Kush nga klasifikimet e mëposhtme për kistat odontogjene nuk është i vërtetë:

- A) Keratokist
- B) Kist rezidual
- C) Kist perifokal
- D) Kist perikoronar

PS)C

Pyetja 449 V)3

Kush nga klasifikimet e mëposhtme nuk është i saktë për kistat jo odontogjen:

- A) Kist nazo-alveolar
- B) Kist solitar-kockor
- C) Kist dentigerous
- D) Kist aneurismal kockor

PS)C

Pyetja 450 V)2

Furnizimi me gjak i dhëmbëve të përfshirë në kist bëhet nga :

- A) Kapsula kistike
- B) Lengu kistik
- C) Kocka përreth
- D) Periosti

PS)A

Pyetja 451 V)2

Kush nga muret e mëposhtme nuk është pjesë e sinusit maksilar :

- A) Orbita
 - B) Procesi alveolar i maksilës
 - C) Muri sfeno maksilar
 - D) Muri sfeno palatin
- PS)D

Pyetja 452 V)1

Kush nga porositë e mëposhtme për të sëmurin lejohet kur kemi komunikim oro-sinuzal.

- A) Përdorimi i antibiotikëve
 - B) Shfryrjet e hundës
 - C) Kyretimi i komunikimit oro sinuzal
 - D) Vendosja e garzës në komunikim oro sinuzal
- PS)A

Pyetja 453 V)2

Kush nga simptomat e mëposhtme nuk është karakteristikë për komunikimi oro-sinuzal :

- A) I sëmuri fryn faqet
 - B) I kalon lëngu nga goja në hundë
 - C) Alterime të të folurit
 - D) Nuk pi dot cigare
- PS)A

Pyetja 454 V)1

ATM është një kyç:

- A) Sinovial
 - B) Kapsular
 - C) Diskal
 - D) Ligamentar
- PS)A

Pyetja 455 V)1

Kush nga degët e mëposhtme të nervit facial nuk egziston :

- A) Cervikale
 - B) Mandibulare
 - C) Zygomatike
 - D) Mastoide
- PS)D

Pyetja 456 V)2

Kush nga incizionet e mëposhtme nuk përdoret në kirurgjinë e ATM:

- A) Pre aurikular
 - B) Laterocervikal
 - C) Post aurikular
 - D) Intraoral
- PS)B

Pyetja 457 V)2

Kush nga klasifikimet e mëposhtme për ankilozën e ATM nuk qëndron :

- A) Fallco
- B) E vertetë
- C) Unifokale
- D) Kockore

PS)C

Pyetja 458 V)1

Kush nga infeksionet e mëposhtme nuk akuzohet për ankilozën e ATM:

- A) Otiti media
- B) Tonsiliti
- C) Osteomyeliti i nofullës
- D) Sinuziti

PS)D

Pyetja 459 V)2

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e ankilozës kockore unilaterale të ATM:

- A) Asimetria faciale
- B) Devijim i mjekrës në anën e sëmurë
- C) Devijim i mjekrës në anën e shëndoshë
- D) Mungesë e lëvizjes së kyçit në anën e sëmurë

PS)C

Pyetja 460 V)2

Kush nga shenjat e mëposhtme nuk është karakteristikë e ankilozës kockore bilaterale të ATM:

- A) Mikrogeni
- B) Fytyrë zogu
- C) Reduktim të këndit qafë-mjekër
- D) Rrjeshtim i kryqëzuar i dhëmbëve

PS)D

Pyetja 461 V)2

Kush nga procedurat kirurgjikale të mëposhtme nuk përdoret në trajtimin kirurgjikal të ankilozës kockore të ATM:

- A) Graft kosto kondral
- B) Artroplastike interpozicionale
- C) Gap artroplastika
- D) Kondilotomi

PS)D

Pyetja 462 V)1

Kush nga egzaminimet e mëposhtme nuk ka vlerë në ATM:

- A) Palpacion
- B) Auskultacion
- C) Perkusion
- D) Inspeksion

PS)C

Pyetja 463 V)2

Alveoloplastika sipas Dean është :

- A) Interseptale
 - B) Kortikale
 - C) Bikortikale
 - D) Ekstraseptale
- PS)A

Pyetja 464 V)2

Alveoloplastika kortikale ka të bëjë me :

- A) Reduktimin e pllakës kortikale orale
 - B) Reduktimin e pllakës kortikale vestibulare
 - C) Reduktimin e të dyjave sëbashku
 - D) Reduktimin e spongiozës së kockës
- PS)B

Pyetja 465 V)2

Reduktimi i tuberkulimit genian ka të bëjë me :

- A) Ndërhyrje në ramus ascendant mandibule
 - B) Në mjekër
 - C) Në tuber maksile
 - D) Në torus mandibule
- PS)B

Pyetja 466 V)2

Frenulumi i buzës është më shumë një shirit i përberë nga ind :

- A) Muskular
 - B) Fibroz
 - C) Mukoz
 - D) Kartilagjenez
- PS)B

Pyetja 467 V)2

Kush nga teknikat e mëposhtme të vestibuloplastikës nuk egziston :

- A) Me avancim të mukozës
 - B) Me graft
 - C) Me epitelizim sekondar
 - D) Me avancim të submukozës
- PS)D

Pyetja 468 V)2

Kush nga teknikat e mëposhtme të augmentimit të madibulës nuk egziston :

- A) Graft interpozicional
 - B) Visor teknike
 - C) Onlay graft
 - D) Pinelay graft
- PS)D

Pyetja 469 V)2

Cili nga solucionet e mëposhtme nuk ndikon në ruajtjen e dhëmbit për reimplantim :

- A) Pështyma e personit shoqërues
 - B) H₂O₂
 - C) Garzë e njomur me fiziologjik
 - D) Pështyma e personit të demtuar
- PS)B

Pyetja 470 V)2

Kush nga vlerësimet preoperative nuk ka vlerë në kirurgjinë ortognatike:

- A) Analiza e profilit
 - B) Analiza cefalometrike
 - C) Analiza encefalometrike
 - D) Modelet e planifikimit
- PS)C

Pyetja 471 V)2

Cila nga shprehjet e mëposhtme nuk përdoret në genioplastike:

- A) Zmadhim
 - B) Zvogelim
 - C) Korigjim asimetrie
 - D) Zmadhim me PDS
- PS)D

Pyetja 472 V)3

Lëkura e kokës dhe e qafës është e atashuar fort me struktura të skeletit tek :

- A) Skalpi dhe linja nukleare superiore
 - B) Qepallat dhe qerpikët
 - C) Mjekra dhe buzët
 - D) Veshi dhe ala nares
- PS)D

Pyetja 473 V)3

Kimio receptoret qendrore shtrihen :

- A) Në pons
 - B) Në medule
 - C) Në pleksusin koroid
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)B

Pyetja 474 V)3

Venat intrakraniale dhe ekstrakraniale komunikojnë nëpërmjet :

- A) Venave emisare dhe venës oftalmike
 - B) Pleksusit venoz përreth karotis interna dhe nervave kraniale
 - C) Venave diploike dhe oftalmike
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 475 V)3

Tek kreshta mylohyoide atashohet :

- A) Ligamenti sfenomandibular
- B) Ligamenti stilomandibular
- C) Rafe pterigomandibulare
- D) Fascia parotide

PS)C

Pyetja 476 V)3

Mandibula nuk furnizohet nga degët e :

- A) Arteries faringeale ascendente
- B) Arteries faciale
- C) Arteries maksilare
- D) Arteries linguale

PS)A

Pyetja 477 V)3

Sinusi më i vogël është :

- A) Frontal
- B) Sfenoid
- C) Etmoid
- D) Të gjithë të mësipërmit janë të përafërt në përmasa

PS)B

Pyetja 478 V)3

Veshi i jashtëm është i formuar nga:

- A) Procesi fronto nazal
- B) Harku i pare brankial
- C) Harku i dyte brankial
- D) Harqet e dytë dhe të tretë brankial

PS)B

Pyetja 479 V)3

Diametri i orbites në lindje është :

- A) Sa 1/2 e diamterit në moshë adulte
- B) Sa 5/8 e diamterit në moshë adulte
- C) Sa 3/4 e diamterit në moshë adulte
- D) Pothuajse njëloj me diametrin në moshë adulte

PS)C

Pyetja 480 V)3

Origjina e strukturave të para skeletike në embrion është:

- A) Endokondrale
- B) Intramembranoze
- C) Brankiale
- D) Asnjëra nga të mësipërmet

PS)A

Pyetja 481 V)3

Të 12 nervat kranialë formohen në:

- A) Javën e dytë të shtatzanisë
- B) Javën e katërt të shtatzanisë
- C) Javën e gjashtë të shtatzanisë
- D) Javën e tetë të shtatzanisë

PS)C

Pyetja 482 V)3

Mbetjet e laminave labiale janë:

- A) Buzët
- B) Frenulumet
- C) Gingivat
- D) Tonsilet

PS)B

Pyetja 483 V)3

Në faktorët teratogjenë nuk përfshihen :

- A) Herpes simpleks
- B) Hipoksia
- C) Duhani
- D) Acidi hialuronik

PS)D

Pyetja 484 V)3

Kartilagoja kondilare është :

- A) Kartilago primare
- B) Kartilago sekondare
- C) I nënshtrohet rezorbimit si përgjigje ndaj forcave
- D) Nxitës primar i rritjes së katit të mesëm të fytyrës

PS)B

Pyetja 485 V)3

Thënia e mëposhteme është e vërtetë :

- A) Prezenca e dhëmbëve është e nevojshme për rritjen dhe zhvillimin normal të nofullës
- B) Zhvillimi i dhëmbëve përcakton zhvillimin alveolar
- C) Errupsioni i dhëmbëve është i pavarur nga rritja e kocës
- D) Të gjitha të mësipërmet

PS)B

Pyetja 486 V)3

Gjerësia bizigomatike rritet :

- A) Nga mosha 2-5 vjec
- B) Deri në 7 vjec
- C) Deri në pubertet
- D) Deri në moshën adulte

PS)D

Pyetja 487 V)3

Sipërfaqja që rezorbohet më shumë nga këto është :

- A) Kreshta e procesit alveolar
 - B) Tuber maksile
 - C) Sipërfaqja laterale e harkut alveolar
 - D) Sipërfaqja anteriore e harkut alveolar
- PS)D

Pyetja 488 V)3

Tonsilet :

- A) Nuk kanë asnjë funksion tek adulti
 - B) Prodhonjë limfocite dhe antitrupa
 - C) Prodhonjë qelizat T
 - D) B dhe C
- PS)B

Pyetja 489 V)3

Bërthama e qelizave përmban :

- A) m.ARN
 - B) r.ARN
 - C) i.ARN
 - D) t.ARN
- PS)B

Pyetja 490 V)3

Cili nga formacionet e mëposhtëme ndodhet mbi linjën mylohyoide:

- A) Gjëndra e pështymës sublinguale
 - B) Gjëndra e pështymës submandibulare
 - C) Gjëndra limfatike submandibulare
 - D) Gjëndrat von ebner
- PS)A

Pyetja 491 V)3

Kryqëzimi i syve shkaktohet nga lezione në nervin kranial të:

- A) II
 - B) III
 - C) IV
 - D) VI
- PS)D

Pyetja 492 V)3

Gjuha formohet nga harku :

- A) I parë
 - B) I tretë
 - C) I katërt
 - D) Nga të gjithë të mësipërmit
- PS)D

Pyetja 493 V)3

Mosha skeletale përcaktohet nga :

- A) Kalcifikimi ulnar
 - B) Kockat sesamoide
 - C) Kockat hamate
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 494 V)3

Epistaksisi rekurent i rëndë nga pjesa kraniale e hundës kërkon ligimin e :

- A) Arteries maxillare
 - B) Arteries karotis eksterna
 - C) Arteries etmoidale
 - D) Arteries karotis interna
- PS)C

Pyetja 495 V)3

Pështyma :

- A) Çdo ditë sekreton 500 ml
 - B) Është lehtësisht alkaline
 - C) Është nën kontroll nervor dhe hormonal
 - D) Fluksi i gjëndrës parotis rregullohet nga nukleusi inferior salivator në medullë
- PS)D

Pyetja 496 V)3

Protruzioni mandibular shkaktohet nga muskuli :

- A) Masseter i thellë
 - B) Temporalis posterior
 - C) Pteridoid lateral
 - D) Të gjithë sëbashku
- PS)C

Pyetja 497 V)3

Hapja e vërtetë (e pastër) e ATM është :

- A) 30-40 mm
 - B) 35-45 mm
 - C) 20-25 mm
 - D) 15-20 mm
- PS)C

Pyetja 498 V)3

Refleksi i parë i njeriut është :

- A) Refleksi digital
 - B) Refleksi i ushqyerjes
 - C) Refleksi respirator
 - D) Refleksi i gjëlltitjes
- PS)B

Pyetja 499 V)3

Ndërveprimi i ilacit me receptorët shkakton :

- A) Efekte anësore
 - B) Efekte terapeutike
 - C) Efekte toksike
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 500 V)3

Organizmi njerëzor sekreton:

- A) Deksometazon
 - B) Prednizolon
 - C) Hemisulkusinat kortizoni
 - D) Hidrokortizon
- PS)D

Pyetja 501 V)3

Prania e gazit në gjakun arterial shërben për:

- A) Përcaktimin e terapisë në gjëndjen e hypoksisë dhe hypoventilimit
 - B) Aktivitetin fizik pre operator për anestezi
 - C) Nëse duhet ndërhyrë pas traumës ose efuzionit
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 502 V)3

Alkalinizmi i urinës eliminon :

- A) Acidet e dobta
 - B) Bazat e dobta
 - C) Ilacet e pa jonizuar
 - D) Asnjëra nga të mësipërmet
- PS)A

Pyetja 503 V)3

Sindromi akut i distresit respirator post operator mund të shkaktojë :

- A) Vdekje
 - B) Dispne takipne dhe takikardi
 - C) Semundje kronike restruktive e mushkurisë
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 504 V)3

Kapaciteti normal vital në litra është :

- A) 0.5-0.7
 - B) 2.5-3
 - C) 1.5-2
 - D) 5-6
- PS)D

Pyetja 505 V)3

Oksigjeni total në gjakun arterial është :

- A) 5ml/dl
- B) 10ml/dl
- C) 20ml/dl
- D) 40ml/dl

PS)C

Pyetja 506 V)3

Qendra respiratore përfshin:

- A) Qendrën inspiratore dhe ekspiratore
- B) Kimioreceptorët në trupin karotid dhe aortik
- C) Baroreceptorët në sinusin karotid dhe harkun aortik
- D) Të gjitha të mësipërmet

PS)A

Pyetja 507 V)3

Mandibula rritet nga :

- A) Apozicioni i kufirit anterior të ramusit
- B) Apozicionimi i kufirit posterior të ramusit
- C) Apozicionimi i mentumit
- D) Apozicionimi i procesit alveolar

PS)B

Pyetja 508 V)3

Zbulimi i rrënjës së dhëmbit shoqërohet:

- A) Apozicionimi i kockës alveolare
- B) Asnjë ndryshim në kockën alveolare
- C) Rezorbimi i kockës alveolare
- D) Rezorbimi i rrënjës

PS)C

Pyetja 509 V)3

Faktori XII (Hageman) shkakton :

- A) Mpiksjen
- B) Clirimin e kininës dhe fibrinolizën
- C) Aktivizimin e komplementit
- D) Të gjitha sëbashku

PS)D

Pyetja 510 V)3

Mekanizmat kompensator homeostatik në pacientët anemikë përfshijnë :

- A) Takikardi dhe zhurmat e fluksit të gjakut
- B) Shuntimi i gjakut nga organet jo esenciale
- C) Rritja e ritmit respirator
- D) Të gjitha të mësipërmet

PS)D

Pyetja 511 V)3

Ulja e antittrupave krijon predispozitë për :

- A) Infeksione akute bakteriale
 - B) Infeksione fungale
 - C) TBC
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 512 V)3

Lëvizja e dhëmbit :

- A) Është më e madhe në mëngjes sesa në darkë
 - B) Është më e madhe tek fëmijët se tek adultët
 - C) Është më e madhe tek femrat se tek meshkujt
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 513 V)3

Mekanoreceptorët e ATM përfshijnë :

- A) Mbaresat e Ruffinit
 - B) Tendinat e Golgit
 - C) Korpuskulat pacinoforme
 - D) Të gjitha të mësipërmet
- PS)D

Pyetja 514 V)3

Kur ne kafshojmë diçka të fortë frenohet shtërngimi i dhëmbëve dhe aktivizohet hapja e gojës , ky refleks quhet :

- A) Hapja e gojës
 - B) Zgogëlim i shtërngimit të dhëmbëve
 - C) Lëkundja e nofullës
 - D) Refleksi horizontal i nofullës
- PS)B

Pyetja 515 V)3

Fluksi salivar është:

- A) 0.3 ml/min në gjëndje të zgjuar
 - B) 0.1ml/min në gjumë
 - C) 4 ml/min gjatë përthypjes
 - D) Të gjitha sëbashku
- PS)D

Pyetja 516 V)3

Përshtyma përmban :

- A) Lëndë antibakteriale
 - B) Lëndë antifungale
 - C) A dhe B
 - D) Komplement
- PS)C

Pyetja 517 V)3

Parathormoni sekretohet nga :

- A) Qelizat kryesore
- B) Oksifile
- C) Bazofile
- D) Acidofile

PS)A

Pyetja 518 V)3

Organi limfoid primar është :

- A) Mëlcia
- B) Gjëndrat limfatike
- C) Palca e kockës
- D) Timusi

PS)C

Pyetja 519 V)3

Pesë klasat e imunoglobulinave bazohen në:

- A) Tipin e zinxhirit të lehtë
- B) Tipin e zinxhirit të rëndë
- C) Peshën molekulare të zinxhirit të lehtë
- D) Peshën molekulare të zinxhirit të rëndë

PS)B

Pyetja 520 V)3

Të gjitha të mësipërmet ndalojnë mpiksjen e gjakut përveç :

- A) Aktivizimi i plazminogjenit indor
- B) Trombina
- C) Antitrombina III
- D) Prostaciklina

PS)A

Pyetja 521 V)3

IgA është e pranishme në:

- A) Traktin respirator
- B) Pështymë
- C) Traktin genito-urinar
- D) Tek të gjithë të mësipërmit

PS)D

Pyetja 522 V)2

Çfarë përfshin tipi i dytë i alginatit:

- A) Alginate ku transformimi në xhel bëhet shumë shpejt
- B) Alginate ku transformimi në xhel bëhet mesatarisht
- C) Alginate ku transformimi në xhel bëhet normalisht
- D) Alginate ku transformimi në xhel bëhet me ngadalë

PS)C

Pyetja 523 V)2

Për çfarë mase përdoret alginati i klasit të III-të :

- A) Për inlei ose korona
 - B) Për proteza parciaie ose totale
 - C) Për urat fikse
 - D) Për modelet e studimit ose për përgatitjen e lugës individuale
- PS)D

Pyetja 524 V)2

Për çfarë shërben oksidi i zinkut në materialet polysulfide:

- A) Për të përcaktuar shkallën e viskozitetit
 - B) Për të dhënë konsistencë fortësie materialit
 - C) Për ta bërë të lëmuar materialin
 - D) Për t'u derdhur lehtësisht modeli
- PS)A

Pyetja 525 V)2

Pasta bazë e silikoneve të kondensimit quhet :

- A) Kopolimer
 - B) Dimetil silicone
 - C) Diklorbenzeni
 - D) Polieter
- PS)B

Pyetja 526 V)2

Polieteret përdoren:

- A) Për derdhjen e masës
 - B) Si material për riparimin e protezës
 - C) Në masat funksionale për përgatitjen e protezave totale
 - D) Si material për ribazimin e protezës
- PS)C

Pyetja 527 V)2

Temperatura e vlimit të dyllit të Bletës është:

- A) 350°C
 - B) 236°C
 - C) 329°C
 - D) 350°C
- PS)C

Pyetja 528 V)2

Dylli karnaub përzihet me dyllin e bletës në raportin:

- A) 1 : 1
 - B) 2 : 1
 - C) 1 : 2
 - D) 1 : 3
- PS)A

Pyetja 529 V)2

Çfarë funksioni ka dylli kandelila:

- A) Siguron saktësi të modelimit
 - B) Ndikon në intervalin e shkrirjes së produktit përfundimtar
 - C) Për të ulur plasticitetin
 - D) Për të ulur tkurrjen
- PS)D

Pyetja 530 V)2

Vëllimi i tkurrjes nga 80 deri në 20⁰C i dyllit inlei është :

- A) 1 %
 - B) 0.1 %
 - C) 1.5 %
 - D) 0.15 %
- PS)D

Pyetja 531 V)2

Çfarë shkalle rrjedhshmërie ka dylli i butë:

- A) Rrjedhshmëri të lartë
 - B) Rrjedhshmëri të mesme
 - C) Rrjedhshmëri të ulët
 - D) Rrjedhshmëri shumë të ulët
- PS)C

Pyetja 532 V)2

Bazis Plate shërben si:

- A) Material për të marrë masën
 - B) Material për përgatitjen e lugës individuale
 - C) Material për derdhjen e masës
 - D) Material për riparimin e protezës
- PS)B

Pyetja 533 V)2

Rezina sintetike në Bazis plate ka përmbajtjen :

- A) 25%
 - B) 12%
 - C) 2.5%
 - D) 3%
- PS)D

Pyetja 534 V)2

Në cilën temperaturë depolimerizohet polimeri:

- A) 125⁰C
 - B) 400⁰C
 - C) 250⁰C
 - D) 185⁰C
- PS)B

Pyetja 535 V)2

- C) Kurbaturës vestibulare të dhëmbëve frontalë
- D) Gjerësisë së dhëmbëve distalë

PS)A

Pyetja 775 V)1

Molarët e parë lart (16/26) prekin planin horizontal me:

- A) Të gjithë tuberkulat
- B) Tuberkulin mezio-vestibular
- C) Tuberkulin disto-palatinal
- D) Tuberkulin mezio-palatinal

PS)D

Pyetja 776 V)1

Molarët e dytë lart (17/27) në lidhje me planin horizontal kanë këtë pozitë:

- A) E prekin me të gjithë tuberkulat
- B) E prekin me tuberkulin mezio-palatinal
- C) Nuk e prekin fare
- D) E prekin me tuberkulin disto-palatinal

PS)C

Pyetja 777 V)1

Në molarët e dytë lart (17/27) më afër planit horizontal qëndron tuberkuli:

- A) Tuberkuli mezio-palatinal
- B) Tuberkuli mezio-vestibular
- C) Tuberkuli disto-palatinal
- D) Tuberkuli disto-vestibular

PS)A

Pyetja 778 V)1

Në molarët e dytë lart (17/27) më larg planit horizontal qëndron tuberkuli:

- A) Tuberkuli mezio-palatinal
- B) Tuberkuli mezio-vestibular
- C) Tuberkuli disto-palatinal
- D) Tuberkuli disto-vestibular

PS)D

Pyetja 779 V)1

Ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Tuber maksilar
- B) Tuberkulum alveolar mandibulae
- C) Frenulum linguae
- D) Llozha bucinatore

PS)C

Pyetja 780 V)1

Në okluzion normal në protezat totale, over-bite (mbulimi incizival) duhet të jetë:

- A) 0,5-1 mm
- B) 1-2mm
- C) 2-3mm
- D) 3-4mm

PS)A

Pyetja 781 V)1

Në okluzion normal në protezat totale, over-jet (distanca midis frontalëve lart dhe sipërfaqes vestibulare të frontalëve poshtë) duhet të jetë:

- A) 0,5 mm
- B) 1-2mm
- C) 2-3mm
- D) 3-4mm

PS)B

Pyetja 782 V)1

Okludatorët janë aparatet që imitojnë (riprodhojnë) :

- A) Të gjitha lëvizjet e ATM
- B) Vetëm lëvizjet vertikale (sharnier)
- C) Vetëm lëvizjet laterale
- D) Vetëm lëvizjet propulsive

PS)B

Pyetja 783 V)1

Artikulatorët janë aparatet që imitojnë (riprodhojnë) :

- A) Lëvizjet vertikale, laterale dhe propulsive të ATM
- B) Vetëm lëvizjet vertikale (sharnier)
- C) Vetëm lëvizjet laterale
- D) Vetëm lëvizjet propulsive

PS)A

Pyetja 784 V)1

Nëpërmjet metodës së gëlltitjes (në protezat totale) ne përcaktojmë:

- A) Pozicionin meziodistal të mandibulës
- B) Lartësinë e okluzionit
- C) Hapësirën minimale fonetike
- D) Planin e okluzionit

PS)A

Pyetja 785 V)1

Në metodën e zakonshme të polimerizimit, në fillim të ciklit të polimerizimit të rezinës, mufla futet në ujë me temperaturë:

- A) 0 gradë
- B) Temperaturë ambjenti
- C) 60-65 gradë

D) 100 gradë
PS)B

Pyetja 786 V)1

Për të realizuar shkrirjen dhe shplarjen e dyllit nga mufla, muflën e fusim për rreth 10 minuta në ujë me temperaturë:

A) 0 gradë
B) Temperaturë ambjenti
C) 60-65 gradë
D) 100 gradë
PS)D

Pyetja 787 V)1

Riparimet me dorë të lirë indikohen kur:

A) Kemi thyerje të protezës pa mungesë të pjesëve
B) Kemi thyerje të protezës me mungesë të pjesëve
C) Duhet të shtohen kroshe
D) Proteza lëviz
PS)A

Pyetja 788 V)1

Për një ribazim indirekt të një proteze totale duhet të merret masë:

A) Anatomike me lugë serie
B) Funksionale me lugë individuale
C) Funksionale me protezën ekzistuese
D) E pjesshme situacioni
PS)C

Pyetja 789 V)1

Një ribazim direkt mund të realizohet me:

A) Rezinë fotopolimerizuese
B) Rezinë vetëpolimerizuese
C) Oksid zink- eugenol
D) Alginat
PS)B

Pyetja 790 V)1

Në një riparim indirekt masa merret me:

A) Oksid zink -eugenol
B) Rezinë vetëpolimerizuese
C) Alginat
D) Stenc
PS)C

Pyetja 791 V)1

Premolarët e parë lart (14/24) mund të mos vendosen në protezat totale në rastet e:

A) Prognatisë
B) Okluzionit normal
C) Progenisë

D) Okluzionit të thellë
PS)C

Pyetja 792 V)1

Premolarët e parë poshtë (34/44) mund të mos vendosen në protezat totale në rastet e:

A) Prognatisë
B) Okluzionit normal
C) Progenisë
D) Okluzionit të kryqëzuar
PS)A

Pyetja 793 V)1

Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të sipërme:

A) Torusi palatinal
B) Torusi mandibular
C) Tuberi maksilar
D) Ruga palatine kanine
PS)C

Pyetja 794 V)1

Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

A) Tuberkulum alveolar mandibulae
B) Apofizat geniane
C) Frenulum linguae
D) Linea oblique interna
PS)A

Pyetja 795 V)1

Ndikon pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të poshtme:

A) Plika bukale anteriore
B) Linea obliqua interna
C) Torus mandibular
D) Llozha retro-milohioide
PS)D

Pyetja 796 V)1

Thyerja e protezës së sipërme në nivel të linjës mediane mund të shkaktohet nga:

A) Rreshtimi i dhëmbëve distalë më të lingualizuar
B) Mos lehtësimi i torusit palatinal të shprehur
C) Mos lehtësimi i tuberit maksilar të shprehur
D) Gjatësia më e madhe në zonën e postdam-it
PS)B

Pyetja 797 V)1

Refleksi i të vjellit nga proteza e sipërme mund të shkaktohet nga:

A) Mos lehtësimi i torusit palatinal të shprehur
B) Mos lehtësimi i tuberit maksilar të shprehur
C) Gjatësia më e madhe në zonën e postdam-it
D) Përcaktimi i gabuar i planit të okluzionit

PS)C

Pyetja 798 V)1

Ndikon negativisht në qëndrueshmërinë e protezës totale të sipërme:

- A) Zona e postdam-it (vibrimit)
- B) Papilla incizivale
- C) Torusi palatin I shprehur
- D) Tuberi maksilar

PS)C

Pyetja 799 V)1

Lartësia e katit të mesëm të fytyrës na ndihmon për përcaktimin e:

- A) Pozicionit mezio-distal të mandibulës
- B) Lartësisë së okluzionit qendror
- C) Nivelit të planit të okluzionit
- D) Drejtimit të planit të okluzionit

PS)B

Pyetja 800 V)1

Në protezat totale interferencat (paratakimet) :

- A) Ndikojnë pozitivisht
- B) Ndikojnë negativisht
- C) Nuk ndikojnë
- D) Varet nga veçoritë individuale

PS)B

Pyetja 801 V)1

Disku artikular ka formë:

- A) Sferike
- B) Bikonkave
- C) Bikonvekse
- D) Të sheshtë

PS)B

Pyetja 802 V)1

Kondili artikular ka formë:

- A) Sferike të çrregullt
- B) Elipsi të çrregullt
- C) Të sheshtë
- D) Trekëndore

PS)B

Pyetja 803 V)1

Në një artikulacion temporo-mandibular normal, në fazën fillestarë të hapjes së gojës, disku artikular ndodhet:

- A) Para kondilit artikular
- B) Prapa kondilit artikular
- C) Në mes kondilit dhe fosës artikulare
- D) Varet nga veçoritë individuale

PS)C

Pyetja 804 V)1

Ndikojnë pozitivisht në protezimin me proteza totale, kreshtat reziduale:

- A) Paralele
- B) Konvergjente
- C) Divergjente
- D) Me atrofi jouniforme

PS)A

Pyetja 805 V)1

Gjate rregullimit funksional të lugës individuale në zonën e vibrimit (post-damit) pacienti instruktohet:

- A) Të shfryjë hundët me vrima të mbyllura
- B) Të shqiptojë germën "S"
- C) Të shqiptojë "Ah" të lehtë e të zgjatur
- D) Të shqiptojë germën "M"

PS)C

Pyetja 806 V)1

Gjate rregullimit funksional të lugës individuale në zonën anteriore vestibulare, pacienti instruktohet:

- A) Të bëjë sikur fërshëllen
- B) Të hapë gojën në maksimum
- C) Të bëjë lëvizje të gjuhës
- D) Të gëlltitet

PS)A

Pyetja 807 V)1

Gjatë fleksionit (përkuljes) së kokës maksimalisht prapa, mandibula shkon vetëvetiu në pozicionin e :

- A) Qetësisë
- B) Relacionit qendror
- C) Formimit të hapësirës fiziologjike
- D) Protruzionit maksimal

PS)B

Pyetja 808 V)1

Hapësira e lirë fiziologjike është mesatarisht:

- A) 0,5- 1mm
- B) 2-3mm
- C) 5mm
- D) 6mm

PS)B

Pyetja 809 V)1

Nuk mund të konstruktohet një protezë immediate në një pacient me:

- A) Probleme alergjike
- B) Artrite
- C) Kandidozë
- D) Hemofili

PS)D

Pyetja 810 V)1

Ka qëndrueshmëri më të lartë proteza totale e sipërme:

- A) Axhuste
- B) Me pllakë të reduktuar
- C) Me pllakë të plote rezine
- D) Me pllakë të plotë metalike

PS)C

Pyetja 811 V)1

Paraqet vështirësi për ribazim një protezë e sipërme:

- A) Axhuste
- B) Me pllakë të reduktuar
- C) Me pllakë të plote rezine
- D) Me pllakë të plotë metalike

PS)D

Pyetja 812 V)1

Nuk mund të konstruktohet një protezë imediate në një pacient me:

- A) Probleme alergjike
- B) Refleks të vjelli
- C) Kandidozë
- D) Diabet

PS)D

Pyetja 813 V)1

Në dhëmbët distalë maksilarë tuberkulat jofunksionalë janë:

- A) Tuberkulat palatinalë
- B) Tuberkulat vestibularë
- C) Tuberkulum Carabeli
- D) Tuberkulat vestibularë dhe palatinalë

PS)B

Pyetja 814 V)1

Në dhëmbët distalë mandibularë tuberkulat jofunksionalë janë:

- A) Tuberkulat lingualë
- B) Tuberkulat vestibularë
- C) Tuberkulum Carabeli
- D) Tuberkulat vestibularë dhe lingualë

PS)A

Pyetja 815 V)1

Në protezimin me protezë totale në një pacient me torus palatinal të shrehur, bëhet:

- A) Gravim I modelit në zonën e torusit
- B) Lënie e torusit jashtë kufirit të protezës
- C) Lehtësim ortopedik ose kirurgjikal I torusit
- D) Thellim kirurgjikal I sulkuseve

PS)C

Pyetja 816 V)1

Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në sulkusin pterigo-maksilar, pacientit i thuhet të:

- A) Bëjë sikur fërshëllen
- B) Hap gojën në maksimum
- C) Lëviz gjuhën anash
- D) Gëlltitet

PS)B

Pyetja 817 V)1

Gjatë rregullimit funksional të lugës individuale në zonën sublinguale, pacientit i thuhet të:

- A) Bëjë sikur fërshëllen
- B) Hap gojën në maksimum
- C) Lëvizë gjuhën anash e të gëlltitet
- D) Të shqiptojë " Ah " të lehtë e të zgjatur

PS)C

Pyetja 818 V)1

Kufiri posterior i protezës së sipërme duhet të shtrihet:

- A) 2-3 mm para linjës posteriore të vibrimit
- B) 2-3 mm pas linjës posteriore të vibrimit
- C) 0,5-1mm pas linjës posteriore të vibrimit
- D) 2-3 mm para linjës anteriore të vibrimit

PS)C

Pyetja 819 V)1

Një masë për proteza totale, e marrë me alginat:

- A) Mund të rrijë gjatë pa u derdhur
- B) Duhet të derdhet brenda 5-10 min
- C) Duhet të izolohet para derdhjes
- D) Futet në një enë me ujë, derisa të derdhet

PS)B

Pyetja 820 V)1

Një masë për proteza totale, e marrë me allçi:

- A) Deformohet po të rrijë gjatë pa u derdhur
- B) Duhet të derdhet brenda 5-10 min
- C) Duhet të izolohet para derdhjes
- D) Futet në një enë me ujë, derisa të derdhet

PS)C

Pyetja 821 V)1

Një masë për proteza totale, e marrë me silikon putty:

- A) Mund të rrijë gjatë pa u derdhur
- B) Deformohet po të rrijë gjatë pa u derdhur
- C) Duhet të izolohet para derdhjes
- D) Futet në një enë me ujë, derisa të derdhet

PS)A

Pyetja 822 V)2

Rezina fotopolimerizuese përdoret për:

- A) Marrje mase anatomike
 - B) Konstruktimin e gjithë bazës së protezës
 - C) Riparime të ndryshme të protezës
 - D) Përgatitjen e lugëve individuale
- PS)D

Pyetja 823 V)2

Mungesa e hapësirës minimale fonetike tregon që:

- A) Lartësia e okluzionit është më e ulët se sa duhet
 - B) Lartësia e okluzionit është më e lartë se sa duhet
 - C) Pozicioni mezio-distal i mandibulës është përcaktuar gabim
 - D) Plani i okluzionit është përcaktuar gabim
- PS)B

Pyetja 824 V)2

Cila mënyrë e bashkimit të qiellzës së fortë me qiellzën e butë ndikon më pozitivisht në qëndrueshmërinë e protezës totale:

- A) Bashkimi me kënd 90 gradë
 - B) Bashkimi me kënd 120 gradë
 - C) Bashkimi me kënd 135 gradë
 - D) Bashkimi me kënd 180 gradë
- PS)D

Pyetja 825 V)2

Apofizat geniane ndodhen në pjesën:

- A) Vestibulare të mandibulës në nivel të linjës mediane
 - B) Linguale të mandibulës në dy anët e linjës mediane
 - C) Vestibulare të mandibulës në nivel të premolarëve
 - D) Linguale të mandibulës në nivel të molarëve
- PS)B

Pyetja 826 V)2

Trekëndëshi i Bonwill-it formohet nga bashkimi i qendrës së dy kondileve dhe:

- A) Spina nasalis anterior
 - B) Spina nasalis posterior
 - C) Pikës incizivale
 - D) Mentumit
- PS)C

Pyetja 827 V)2

Dhëmbët joanatomikë (pa tuberkula) përdoren me sukses në protezat totale në nofulla :

- A) Shumë të atrofizuara
- B) Të pa atrofizuara
- C) Me atrofi jouniforme

D) Me kreshta reziduale të gjera
PS)A

Pyetja 828 V)2

Në progeny Kyci I Angel-it (Kyci I okluzionit) është :

- A) I mezializuar
 - B) I distalizuar
 - C) Normal
 - D) Varet nga grada e progenisë
- PS)B

Pyetja 829 V)2

Në prognati Kyci I Angel-it (Kyci I okluzionit) është :

- A) I mezializuar
 - B) I distalizuar
 - C) Normal
 - D) Varet nga grada e prognatisë
- PS)A

Pyetja 830 V)2

Në okluzionin e balancuar bilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën e punës kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
 - B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
 - C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distal lart dhe poshtë
 - D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart
- PS)B

Pyetja 831 V)2

Në okluzionin e balancuar bilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën balancuese kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
 - B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
 - C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distalë lart dhe poshtë
 - D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart
- PS)A

Pyetja 832 V)2

Në okluzionin e balancuar unilateral, gjatë lëvizjes laterale, në anën balancuese kemi:

- A) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të kundërt
 - B) Kontakt të dhëmbëve distalë lart dhe poshtë me tuberkulat me emër të njëjtë
 - C) Mungesë kontakti midis dhëmbëve distalë lart dhe poshtë
 - D) Rrëshqitje të kaninit poshtë në sipërfaqen palatinale të kaninit lart
- PS)C

Pyetja 833 V)2

Cili nga pohimet është i vërtetë

- A) Plani i okluzionit është rreth 2mm mbi buzën e sipërme
- B) Plani i okluzionit është rreth 2mm mbi buzën e poshtme
- C) Plani i okluzionit është rreth 2mm nën buzën e sipërme
- D) Plani i okluzionit është në një nivel me tuberin maksilar

PS)C

Pyetja 834 V)2

Plani i okluzionit distalisht është në nivelin:

- A) E tuber maksilae
- B) E ndarjes së 1/3 së sipërme nga 2/3 e poshtme të tuberkulum alveolar mandibulae
- C) E torusit mandibular
- D) E ndarjes së 1/3 së sipërme nga 2/3 e poshtme të tuber maksilae

PS)B

Pyetja 835 V)2

Cili nga pohimet është i vërtetë

- A) Maksila atrofizohet 4 herë më shpejt se mandibula
- B) Maksila dhe mandibula atrofizohen me të njejtën shpejtësi
- C) Mandibula atrofizohet 4 herë më shpejt se maksila
- D) Maksila atrofizohet 2 herë më shpejt se mandibula

PS)C

Pyetja 836 V)2

Zona e vetme që mund të shfrytëzohet për të zgjeruar sipërfaqen e protezës së poshtme në atrofi të shprehura të saj, është:

- A) Zona sublinguale anteriore
- B) Zona e fornixit vestibular anterior
- C) Dyshemeja e gojës dhe muskuli mylohioid
- D) Llozha retro-mylohioid

PS)D

Pyetja 837 V)2

Kur gjatë lëvizjes së gjuhës majtas, konstatohet lëvizje e protezës së poshtme, kemi një protezë me:

- A) Kufi më të gjatë sublingual majtas
- B) Kufi më të gjatë sublingual djathtas
- C) Kufi më të gjatë vestibular djathtas
- D) Kufi më të gjatë vestibular majtas

PS)B

Pyetja 838 V)2

Në pacientin për protezë totale, metoda e gëlltitjes shfrytëzohet për të përcaktuar :

- A) Planin e okluzionit
- B) Lartësinë e okluzionit
- C) Përmasat e dhëmbëve artificialë
- D) Pozicionin mezio-distal të mandibulës

PS)D

Pyetja 839 V)1

Agenezia e një dhëmbi permanent më frekuent është:

- A) Premolari superior
- B) Premolari inferior
- C) Inci zivi inferior
- D) Kanini superior

PS)B

Pyetja 840 V)1

Për të përcaktuar me numurim me 2 shifra kaninin e qumështit sipër në të djathtë formulimi i drejtë është:

- A) 35
- B) 53
- C) 23
- D) 31

PS)B

Pyetja 841 V)1

Dhëmbi i parë permanent që del në arkadën dentare është në normë:

- A) Molari i parë superior
- B) Incizivi central inferior
- C) Molari i parë inferior
- D) Incizivi parë superior

PS)C

Pyetja 842 V)1

Për një dioagnozë radiologjike të kariesit aproksimal në molarët e qumështit janë përcaktuese :

- A) Rx ortopanomike të arkadave dentare
- B) 2 Rx endorale bite-ëing
- C) 2Rx endorale peri-apikale
- D) 2Rx endorale - okluzale

PS)B

Pyetja 843 V)1

Cilit sindrom patollogjik i bashkengjitet dentinogenezis imperfekta.

- A) Sindromi i Dawnit
- B) Osteogeneza imperfekta
- C) Dizostoza kleidokraniale
- D) Labiopalatoskiza

PS)B

Pyetja 844 V)1

Kush është shkaku i një ekstraksioni dentar të një dhëmbi permanentë

- A) Kariesi i grades se dyte
- B) Kariesi destruktues me shkatërrim të koronës me rezorbim kockor periradikular
- C) Pulpit akut
- D) Cimentoma apikale

PS)B

Pyetja 845 V)1

Ç'farë kuptohet me " Dizodontiazi"ë

- A) Mungesa e një dhëmbi në arkadën dentare
- B) Me proces inflamator perikoronar
- C) Një ç'rregullim okluzioni
- D) Një dalje dentare e veshtirë me simptomatologji të shprehur klinikisht

PS)D

Pyetja 846 V)1

Kush është percaktimi më i përshtatshëm i "epulis":

- A) Një kist me lokalizim sopra gingival
- B) Një proces inflamator perikoronar
- C) Një tumor beninjë i paradontit
- D) Një tumor malinj konjuktival

PS)C

Pyetja 847 V)1

Dentinoma është një ind patologjik që instalohet në ngarkim të :

- A) Të indit kockor
- B) Të indit konjuktivar
- C) Të indit epithelial
- D) Të indit dentar

PS)D

Pyetja 848 V)1

Në granulomën apikale nuk janë present:

- A) Leukocitet polimorfo nukleare
- B) Limfocitet
- C) Fibroblastet
- D) Odontoblastet

PS)D

Pyetja 849 V)1

Mungesa e pikave të kontaktit ndërmjet dhëmbëve përcaktohet:

- A) Bruksizmi
- B) Atrofi gingivale
- C) Kariesi interproksimal
- D) Kontakt okluzal i parakohshëm

PS)C

Pyetja 850 V)1

Periodontiti apical kronik purulent është karakterizuar

- A) Tumefaksion i lokalizuar
- B) Hemoragji gingivale
- C) Hapje fistuloze
- D) Dhimje spontane

PS)C

Pyetja 851 V)1

Klasifikimi i Blakut paraqet:

- A) Vendin preçiz te kariesit
- B) Faza të ndryshme të evolucionit të kariesit
- C) Kavitate te kariesit
- D) Histopatologjine e kariesit

PS)C

Pyetja 852 V)1

Prizmat e smaltit janë:

- A) Paralel me sipërfaqen e koronës
- B) Perpendikular me sipërfaqen e koronës
- C) Të inklinuar 45 gradë kundrejt sipërfaqes së koronës
- D) Koncentrike me aksin qendror të koronës

PS)B

Pyetja 853 V)1

Në cilat raste nuk është i indikuar përdorimi ë vazokonstuktoreve në anestezinë lokale:

- A) Gravidanca
- B) Hipertiroidizmi
- C) Glomerulonefrit
- D) Ulçera duodenale

PS)B

Pyetja 854 V)1

Fagocitoza është një aftësi e:

- A) Eritrociteve
- B) Linfociteve
- C) Leukocitet neutrofile
- D) Fibroblastet

PS)C

Pyetja 855 V)1

Për veprim të cilës substancë ndodh transformimi i fibrinogjenit në fibrin:

- A) Ca
- B) Protrombina
- C) Trombina
- D) Serotonina

PS)C

Pyetja 856 V)1

Dekstrani që ka një rol primar në formimin e pllakës bakteriale është:

- A) Një polisaharid i sintetizuar nga disa bakterie sporogjene
- B) Një polisaharid i sintetizuar nga disa streptokok në prezencë të saharozës
- C) Një polisaharid i sintetizuar nga disa stafilokok
- D) Një polisaharid i sintetizuar nga disa laktobacile

PS)B

Pyetja 857 V)2

Në kariesin e gradës së 3-të takojmë:

- A) Kariesi që i intereson vetëm smaltit
- B) Kamera pulpare e hapur dhe pulpa e inflamuar
- C) Pulpa ka humbur vitalitetin
- D) Kariesi prek smaltin dhe dentinën

PS)B

Pyetja 858 V)2

Formula dentare në vazhdim 55 54 53 52 51 përfaqëson:

- A) Denticionin e qumështit në harkadën superiore të majtë
- B) Denticionin e qumështit në harkadën superiore të djathtë
- C) Denticionin e qumështit në harkadën inferiore djathtas
- D) Dedenticionin permanent në harkadën superiore djathtas

PS)B

Pyetja 859 V)2

Kiste folikulare janë:

- A) Kiste nga inkluzioni epitelial
- B) Kiste fallco
- C) Kiste odontogjene derivues nga indet formuese të dhëmbit
- D) Kiste marginale

PS)C

Pyetja 860 V)2

Streptokoket e florës bakteriale të kavitetit oral paraqiten:

- A) Në përqindje më të vogël përkundrejt stafilokokeve
- B) Në përqindje më të madhe përkundrejt stafilokokeve
- C) Në përqindje të njëjtë me stafilokoket
- D) Në përqindje të njëjtë me laktobacilet

PS)B

Pyetja 861 V)2

Linea neonatal ndan:

- A) Organin e smaltit nga papilla dentare
- B) Ndan dentine e mineralizuar para lindjes nga ajo pas lindjes
- C) Ndan smaltin e mineralizuar para lindjes nga ai i mineralizuar pas lindjes
- D) Ndan cementin aceluar nga ai celular

PS)C

Pyetja 862 V)2

Abrazioni kuneiform vjen nga:

- A) Hipoplazia e smaltit
- B) Hipokalçifikimi i smaltit
- C) Veprimi mekanik
- D) Faktor hereditary

PS)C

Pyetja 863 V)2

Cilët janë elementët fiziologjikë të dhëmbit të paformuar për të formuar rrënjët dhe apeksin:

- A) Indi pulpar
- B) Indi pulpar dhe indi konjuktiv
- C) Indi epitelial
- D) Indi cementoid

PS)B

Pyetja 864 V)2

Në mbulimin indirekt në dhëmbët e paformuar kontrolli klinik dhe radiologjik bëhet pas:

- A) 1muaji
- B) 3muajsh
- C) 6muajsh
- D) 8muajsh

PS)B

Pyetja 865 V)2

Përdorimi i silanteve ndikon në:

- A) Parandalimi i thyerjeve(frakturës) së kurorës:
- B) Parandalimin e kariesit në fisurat e premolarëve dhe molarëve
- C) Parandalimin e kariesit në kolet
- D) Parandalimin e kariesit në sipërfaqet aproksimale

PS)B

Pyetja 866 V)2

Cili nga faktorët e virulencës së streptokokut mutans shkakton demineralizim të indeve dentare:

- A) Sintezë e polimereve extracelular
- B) Sintezë e polimerëve intracelular
- C) Faktori acidogenik
- D) Acidotolerancë

PS)C

Pyetja 867 V)2

Në testin me natyrë mikrobiologjike për përcaktimin e individëve me risk karioz numri i laktobacileve është:

- A) në80.000 për ml
- B) në10.000për ml
- C) në12.000për ml
- D) në15.000për ml

PS)B

Pyetja 868 V)2

Në dhëmbët permanentë me rrënjë të paformuar në mbulimin indirekt formohet:

- A) Dentinë primare
- B) Dentinë sekondare
- C) Dentinë terciare
- D) Dentinë sklerotike

PS)C

Pyetja 869 V)2

Kur përdorim MTA në mbulimin direkt të pulpës formimi i urës dentinare formohet:

- A) 6 javë
- B) 3javë
- C) 2javë
- D) 8javë

PS)B

Pyetja 870 V)2

Maturimi i dhëmbit dhe vendosja e lidhjes cemento-dentinare ndodh pas daljes së dhëmbit për:

- A) 2vjet
 - B) 2,5vjet
 - C) 3vjet
 - D) 3,4-4vjet
- PS)D

Pyetja 871 V)2

Në dhëmbët permanent me rrënjë të paformuara cili medikament është më i suksesshëm:

- A) Formokrezol
 - B) Glutardehida
 - C) M.T.A
 - D) Ca(OH)_2
- PS)C

Pyetja 872 V)2

Në çfare periudhe një ç'rregullim i rendë i metabolizmit të Ca mund të përcaktojë alterime të smaltit të premolarëve

- A) Gjatë 3 mujorit të fundit të shtatzanisë
 - B) Nga lindja në 10 muajt e parë të jetës
 - C) Nga 10 muaj-2 vjeç
 - D) 2 vjeç - 5 vjeç
- PS)D

Pyetja 873 V)2

Statet e formimit të rrënjes janë:

- A) 8
 - B) 10
 - C) 6
 - D) 7
- PS)B

Pyetja 874 V)2

Aplikimi i MTA në trajtimin e dhëmbëve me rrënjë të paformuar realizon formimin e apexit për:

- A) 5-6muaj
 - B) 3-4muaj
 - C) 2-3muaj
 - D) 8-10muaj
- PS)D

Pyetja 875 V)2

Dhëmbët permanent dalin në arkadën dentare pasi rrënjët e tyre janë formuar :

- A) 1/3 e rrënjës
- B) 1/2 e rrënjës
- C) 2/3 e rrënjës
- D) Kur është formuar vetëm korona

PS)C

Pyetja 876 V)2

Fundi i një kaviteti është i stabilizuar për trajtim nqs është në formë:

- A) Oblik
- B) Sferoidal
- C) Përpindikular me forcat përtypëse
- D) I valëzuar

PS)C

Pyetja 877 V)2

Dentina e zbutur në një proces karioz të thellë në molar permanent hiqet:

- A) Me freze turbine
- B) Me frezë çeliku në formë konike
- C) Eskavator
- D) Me frezë cilindrike

PS)C

Pyetja 878 V)3

Vendosja e varnisheve ndërmjet kavitetit dhe mbushjes shërben për:

- A) Bën hermetike mbushjen
- B) Mbron pulpën nga stimujt fizikë dhe kimikë
- C) Lejon një kavitet të ç'rregullt
- D) E bën mbushjen më të qëndrueshme

PS)B

Pyetja 879 V)3

Kanini superior ka një gjatësi:

- A) 18-20mm
- B) 20-23mm
- C) 25-30mm
- D) 30-35mm

PS)C

Pyetja 880 V)3

Mungesa e cilës vitaminë shkakton hipoplazi të smaltit:

- A) Vit E
- B) Vit A
- C) Vit B6
- D) Niacina

PS)B

Pyetja 881 V)3

Prizmat e smaltit janë me diameter:

- A) 7mikron
- B) 2-6mikron
- C) 12mikron
- D) 10mikron

PS)B

Pyetja 882 V)3

Koronat e incizive central permanent janë komplet të mineralizuara:

- A) 1-2vjeç
 - B) 2-3vjeç
 - C) 3-4vjeç
 - D) 6-7vjeç
- PS)D

Pyetja 883 V)3

Në cilën moshë fillon rezorbimi i molarëve të qumështit:

- A) 3-4vjeç
 - B) 4-5vjeç
 - C) 5-6vjeç
 - D) 6-7vjeç
- PS)D

Pyetja 884 V)3

Mbas traumave prova e vitalitetit do të bëhet:

- A) Mbas 24 orëve
 - B) Mbas 30 ditëve
 - C) Mbas 10 ditëve
 - D) Mbas 3 muajsh
- PS)C

Pyetja 885 V)3

Clorexidina shërben për:

- A) Dizifektim të kanaleve radikular
 - B) Në terapinë e kariesit dentar
 - C) Në kontroll të places bakteriale
 - D) Për pastrim proteze
- PS)C

Pyetja 886 V)3

Anestezia lokale infiltrative me lidokaine zgjat :

- A) 5-10 min
 - B) 30-60min
 - C) 10-15min
 - D) 15-30min
- PS)B

Pyetja 887 V)3

Faktori më i rëndësishëm për shërimin e frakturave:

- A) Disponibilitet lokal për kalcium
 - B) Ndikimi lokal i gjakut
 - C) Mungesa e trupave të huaj
 - D) Formimi i parakohshëm i indit kartilag
- PS)B

Pyetja 888 V)2

Nga çfarë kufizohet muri i prapëm i fosës glenoidë

- A) Nga ligamentet artikulare,
 - B) Eminenca artikulare të pjesës skumanoze,
 - C) Kapsula artikulare
 - D) Procesi post glenoid
- PS)D

Pyetja 889 V)2

Nga varet thellësia e fosës glenoidë

- A) Forma dhe tipi okluzionit
 - B) Përmasat e kondilit
 - C) Nga inserimi i ligamenteve
 - D) Nga inserimi i kapsules
- PS)A

Pyetja 890 V)2

Sa është këndi që krijon eminenca me planin horizontalë

- A) 45 gradë;
 - B) 33 gradë;
 - C) 65 gradë;
 - D) 90 gradë;
- PS)B

Pyetja 891 V)2

Sa është gjatësia sagitale e eminencesë

- A) 12 mm;
 - B) 10 mm;
 - C) 9 mm,;
 - D) 11 mm.
- PS)C

Pyetja 892 V)2

Në sa dhoma e ndan disku artikular fosen glenoidë

- A) Në dy dhoma;
 - B) Në tre dhoma;
 - C) Në kater dhoma;
 - D) Nuk e ndan në asnjë dhomë.
- PS)A

Pyetja 893 V)2

Ku janë të vendosura fibrat elastike të diskut

- A) Në pjesën distale;
 - B) Në pjesën anteriore të diskut
 - C) Në të gjithë gjatësinë e diskut
 - D) Në qendër të shtresës sipërfaqësore të zonës së mesme të diskut
- PS)D

Pyetja 894 V)2

Funksionimi i kapsulës artikulare është

- A) Hapja e gojës;
 - B) Mbyllja e gojës;
 - C) Levizja laterale;
 - D) kufizimi i levizjeve mandibulare
- PS)D

Pyetja 895 V)2

Nervi që inervon kapsulën shtë

- A) aurikulotemporal;
 - B) diagnostikues
 - C) Mental;
 - D) Mandibular
- PS)A

Pyetja 896 V)2

Cilat fibra të m. Temporal tkurren në pozicionin protruziv të mandibulës

- A) Fibrat anteriore;
 - B) Fibrat e mesme;
 - C) Fibrat posteriore;
 - D) Apo të treja së bashku.
- PS)C

Pyetja 897 V)2

Çfare pjerrësie formojnë fijet e shtresës së thellë të muskulit maseterë

- A) 45 - 50 gradë;
 - B) 30 - 40 gradë;
 - C) 30 - 33 gradë;
 - D) 60 - 90 gradë.
- PS)B

Pyetja 898 V)2

Si quhet tendini që bashkon fibrat e muskulit pterogoid medial me muskulin maseterë

- A) Pterigo - masseterik;
 - B) Tempro - masterik;
 - C) Mastero - masterik;
 - D) Mastero - digastrik.
- PS)A

Pyetja 899 V)2

Çfare funksioni ka dega superiore e m. Pterog lateralë

- A) Gjatë lëvizjes së hapjes së gojës;
- B) Gjatë lëvizjes protruzive;
- C) Gjatë lëvizjes laterale;

D) Gjatë lëvizjeve së mbylljes së gojës.

PS)A

Pyetja 900 V)2

Çfarë funksioni ka dega inferiore e muskulit pterigoid laterale

A) Gjatë lëvizjes së mbylljes së gojës

B) Gjatë lëvizjes së hapjes

C) Gjatë lëvizjeve të mbylljes

D) Gjatë lëvizjeve laterale

PS)B

Pyetja 901 V)2

Në ATM sa lloj lëvizjes kryhen?

A) dy,

B) kater

C) tre

D) pese

PS)A

Pyetja 902 V)2

Në sa plane kryhet lëvizja rrotulluese?

A) katër plane

B) dy plane

C) tre plane

D) pesë plane

PS)C

Pyetja 903 V)2

Në sa komponente ndahet lëvizja mandibulare në planin sagital?

A) pesë komponentë

B) tri komponentë

C) dy komponentë

D) katër komponentë

PS)D

Pyetja 904 V)2

Nga çfarë kufizohet lëvizja kufi posteriorë

A) Nga ligamentet,

B) nga muskujt master,

C) nga kapsula artikulare

D) nga muskujt temporale

PS)A

Pyetja 905 V)2

Nga çfarë kufizohet lëvizja kufi anteriorë

A) nga muskujt temporale

B) nga muskujt maseter

C) nga morfologjia e ATM-së

D) nga kapsula artikulare

PS)C

Pyetja 906 V)2

Sa lloj lëvizjesh ekscentrike kryhen mandibula?

- A) tre llojesh
- B) dy llojesh
- C) katër llojesh
- D) pesë llojesh

PS)A

Pyetja 907 V)2

Sa është translación lateral e menjëhershëm ?

- A) 2, 6 mm
- B) 0,4 mm
- C) 12,6 mm
- D) 2.00 mm

PS)B

Pyetja 908 V)2

Sa llojesh janë levizjet përtypëse ?

- A) tre llojesh
- B) dy llojesh
- C) katër llojesh
- D) pesë llojesh

PS)B

Pyetja 909 V)2

Cili muskul është aktiv ájate incizionitë

- A) muskuli maseter
- B) muskuli temporal
- C) të dy fashikujt e muskulit pteriogoi lateral
- D) muskuli pterigoid medial

PS)C

Pyetja 910 V)2

Cili është përcaktuesi i lëvizjes mandibulare?

- A) ligamentet
- B) sistemi propioceptiv neuromuskular
- C) kapsula artikulare
- D) muskujt përtypes

PS)B

Pyetja 911 V)2

Cili është përcaktuesi i lëvizjes mandibulare?

- A) muskujt përtypës
- B) kapsula artikulare
- C) sistemi dentar
- D) ligamentet

PS)C

Pyetja 912 V)2

Pse shkaktohet devijimi i nofullës?

- A) nga hapja posteriore e kufizuar
 - B) nga hapja anteriore e kufizuar
 - C) lëvizje tipike funksionale
 - D) nga miospazma e muskujve maseter
- PS)D

Pyetja 913 V)2

Si paraqitet forma e prerjes cervikale të incizivit lateral maksilar:

- A) Katrore
 - B) Vezoreje
 - C) E rrumbullakët
 - D) Veshkë
- PS)C

Pyetja 914 V)2

Kur erupton premolari i dytë permanent mandibular:

- A) 9 - 10 vjeç
 - B) 10 - 11 vjeç
 - C) 11 - 12 vjeç
 - D) 12 - 13 vjeç
- PS)C

Pyetja 915 V)2

Kur kompletohet rrënja e molarit të parë maksilar:

- A) 6 - 7 vjeç
 - B) 9 - 10 vjeç
 - C) 11 - 13 vjeç
 - D) 14 - 15 vjeç
- PS)B

Pyetja 916 V)2

Cili kuspид mungon te molari i dytë maksilar:

- A) Kuspидi distolingual
 - B) Kuspидi karabeli
 - C) Disto-bukali
 - D) Meziolinguali
- PS)B

Pyetja 917 V)2

Kush nga dhëmbët ka formë konoide:

- A) Premolarët maksilarë
- B) Kaninët maksilarë
- C) Incizivët lateralë maksilarë
- D) Incizivët centralë maksilarë

PS)C

Pyetja 918 V)2

Formimi i kurorës për dhëmbët e qumështit pas lindjes bëhet për molarin e dytë:

- A) 3 muaj
- B) 7 muaj
- C) 8.5 muaj
- D) 10.5 muaj

PS)D

Pyetja 919 V)2

Kush nga dhëmbët ka një antagonistë:

- A) Molari i tretë mandibular
- B) Molari i parë mandibular
- C) Molari i tretë maksilar
- D) Molari i dytë mandibular

PS)C

Pyetja 920 V)2

Cila është shenja dalluese e dhëmbit:

- A) Shenja e rrënjës
- B) Shenja e okluzionit
- C) Shenja e ngjyrës
- D) Shenja e kontakteve të dhëmbit

PS)A

Pyetja 921 V)2

Kur kompletohet kurora e molarit të dytë maksilar:

- A) 6-7 vjeç
- B) 7-8 vjeç
- C) 8-9 vjeç
- D) 12-16 vjeç

PS)B

Pyetja 922 V)2

Si janë odontoblastet në pulpën koronare:

- A) Kuboidale
- B) Hekzagonale
- C) Të rrumbullakta
- D) Trapezoidale

PS)A

Pyetja 923 V)2

Pozicioni në hark i kaninit maksilar në drejtim mezio-distal është:

- A) 12 - 14°
- B) 16 - 17°
- C) 22 - 23°

D) 24 - 27s

PS)B

Pyetja 924 V)1

Kalçifikimi fillestar i molarit të parë mandibular:

A) Në lindje

B) 1 - 2 vjeç

C) 2.5 - 3 vjeç

D) 6 - 7 vjeç

PS)A

Pyetja 925 V)1

Kurbatura cervikale meziale dhe distale e kaninit maksilar është:

A) 1.0 - 0.0 mm

B) 1.0 - 1.5 mm

C) 2.5 -1.5 mm

D) 3.5 -2.5 mm

PS)C

Pyetja 926 V)1

Premolari i dytë maksilar erupton në moshën:

A) 9-10 vjeç

B) 10-12 vjeç

C) 12-14 vjeç

D) 13-14 vjeç

PS)B

Pyetja 927 V)1

Kush nga dhëmbët e ka formen e sipërfaqes përtypëse heksagonale:

A) Premolari i dytë mandibular

B) Molari i dytë mandibular

C) Molari i dytë maksilar

D) Premolari i parë maksilar

PS)D

Pyetja 928 V)1

Ku ndodhet zona e kontaktit midis kaninit dhe premolarit të parë maksilar:

A) Në të tretën incizale të kurorës

B) Në të tretën e mesit të çdo kurore

C) Në vendin e bashkimit të 1/3 okluzale me 1/3 e mesme

D) Në vendin e bashkimit të 1/3 cervikale me 1/3 e mesme

PS)C

Pyetja 929 V)1

Ku shtrihet kurbatura e dhëmbëve të poshtëm mandibularë:

A) Lingualisht rreth 1 mm pas linjës cervikale

B) Mezialisht rreth 0.5 mm pas linjës cervikale

C) Distalisht rreth 1.5 mm pas linjës cervikale

D) Bukalisht rreth 1.8 mm pas linjës cervikale

PS)A

Pyetja 930 V)1

Si paraqitet aspekti distal i dhëmbëve posteriorë mandibularë:

- A) Trapezoid
- B) Trekendesh
- C) Katerkendesh
- D) Romboidal

PS)D

Pyetja 931 V)1

Llogaritja e moshës adulte bazohet në nivelin:

- A) E ligamenteve periodontale
- B) E kontaktit ndërmjet dhembëve
- C) Okluzal
- D) Estetik

PS)A

Pyetja 932 V)1

Koha e erupimit të molarit të parë të qumështit mandibular është:

- A) 10 (8-12 muaj)
- B) 16 (13-19 muaj)
- C) 19 (16 -22 muaj)
- D) 29 (25-33 muaj)

PS)B

Pyetja 933 V)3

Diametri buko lingual i 16 është:

- A) 8.8 mm
- B) 9 -10 mm
- C) 11.0 mm
- D) 13.0 mm

PS)C

Pyetja 934 V)3

Mosha kronologjike bazohet në:

- A) Abrazionin e dhëmbëve
- B) Raportet reciproke të dhëmbëve
- C) Ngjyrën e dhëmbëve
- D) Hapësirat interproximale

PS)A

Pyetja 935 V)3

Kush nga dhëmbët mandibularë ka rrënjën me dy kanale:

- A) Incizivi central mandibular
- B) Kanini mandibular
- C) Incizivi lateral mandibular
- D) Molari i tretë mandibular

PS)B

Pyetja 936 V)3

Kaviteti pulpar i premolarit të parë maksilar në prerjen buko-linguale është:

- A) Formë veshke
- B) Rektangulare
- C) Katrore
- D) Ovale

PS)C

Pyetja 937 V)3

Kur erupton premolari i dytë permanent mandibular:

- A) 9-10 vjeç
- B) 10-11 vjeç
- C) 11-12 vjeç
- D) 12-13 vjeç

PS)C

Pyetja 938 V)3

Sa është distanca mesatare nga pllaka bukale e brëndshme tek apeksi i premolarit të dytë mandibular në lidhje me kanalin mandibular:

- A) 3.1 ± 0.98 mm
- B) 3.78 ± 1.04 mm
- C) 4.1 ± 0.98 mm
- D) 4.03 ± 1.08 mm

PS)B

Pyetja 939 V)3

Sa është gjatësia cerviko-okluzale e kurorës së premolarit të dytë mandibular:

- A) 7.0 mm
- B) 7.6 mm
- C) 8.0 mm
- D) 9.5 mm

PS)C

Pyetja 940 V)3

Në cilën zonë të kurorës kapen indet e buta:

- A) Në 1/3 incizale të kurorës
- B) Në te tretën okluzo-meziale të kurorës
- C) Në te tretën cervikale të kurorës
- D) Në te tretën proksimale të kurorës

PS)C

Pyetja 941 V)3

Sa mm është ndryshimi midis relacionit qëndror dhe interkupsidimit maksimal:

- A) 0.2 - 0.6 mm
- B) 0.7 - 0.8 mm
- C) 0.8 - 1.5 mm
- D) 0.9 - 1.4 mm

PS)C

Pyetja 942 V)3

Funksioni i kurbës së kompensimit sagital:

- A) Siguron vendosjen e dhëmbëve në alveolë
- B) Mbron papilën gingivale
- C) Siguron stabilizimin e arkadës dentare në lëvizjet propulsive
- D) Siguron estetikën

PS)C

Pyetja 943 V)3

Cili është funksioni i kurbës proksimale të dhëmbëve:

- A) Siguron estetikën e dhëmbit
- B) Siguron mbrojtjen e gingivës
- C) Siguron formën e saktë të dhëmbit
- D) Siguron raporte normale me dhëmbët antagonist

PS)B

Pyetja 944 V)3

Pozicioni në hark i incizivit lateral maksilar në drejtim labio-lingual është:

- A) $25-26^{\circ}$
- B) $18-22^{\circ}$
- C) $16-17^{\circ}$
- D) $5-7^{\circ}$

PS)A

Pyetja 945 V)3

Cili është reaksioni që përcakton ADN në dhëmbë:

- A) Reaksioni dezoksiribonukleik
- B) Reaksioni i zinxhirit të krebit
- C) Polimerazës zinxhir
- D) Infiltrimit zinxhir

PS)C

Pyetja 946 V)3

Distanca vertikale mesatare nga kanali mandibular tek apeksi i molarit të dytë mandibular është:

- A) 1.96 ± 0.27 mm
- B) 2.5 ± 0.25 mm
- C) 3.07 ± 0.43 mm
- D) 4.03 ± 0.31 mm

PS)B

Pyetja 947 V)3

Zonat e kontaktit për molarin e parë dhe të dytë mandibular bukolingualisht janë pothuajse në:

- A) Qendër bukolingualisht
- B) Vendin e bashkimit të 1/3 okluzale dhe të mesme
- C) 1/3 e mesme dhe cervikale
- D) 1/3 okluzale dhe cervikale

PS)A

Pyetja 948 V)3

Cili është sistemi i kodifikimit universal për dhëmbët e përhershëm:

- A) 21 22 23 24 25 26 27
 - B) 9 10 11 12 13 14 15 16
 - C) 1 2 3 4 5 6 7
 - D) +1 +2 +3 +4 +5 +6 +7
- PS)B

Pyetja 949 V)3

Çfare lloj lobesh kanë dhëmbët anteriorë:

- A) 2 linguale 2 labiale
 - B) 1 linguale, 2 labiale, 1 proksimale
 - C) 3 labiale, 1 linguale
 - D) 3 linguale, 1 labiale
- PS)C

Pyetja 950 V)3

Harku i kompensimit transversal duhet të respektohet gjatë përgatitjes së protezës totale për arsye se siguron qëndrueshmerinë e protezës gjatë lëvizjes:

- A) Laterale
 - B) Propulsive
 - C) Lateropulsive
 - D) Ekscentrike
- PS)A

Pyetja 951 V)3

Sa është kurbatura normale nga CEI deri te kreshta e konturit:

- A) 0.8 mm në shtrirje
 - B) 0.7 mm në shtrirje
 - C) 0.5 mm në shtrirje
 - D) 0.4 mm në shtrirje
- PS)C

Pyetja 952 V)3

Kur kalçifikohet rrënja e premolarit të dytë maksilar:

- A) 6 -7 vjeç
 - B) 8 - 9 vjeç
 - C) 9 - 11 vjeç
 - D) 12 - 14 vjeç
- PS)D

Pyetja 953 V)3

Çfarë forme ka prerja transversal në cerviks e Incizivit central mandibular :

- A) Konike
- B) Të rrumbullakët
- C) Elipsoide
- D) veshke

PS)B

Pyetja 954 V)3

Në çfarë moshe kalçifikohet plotësisht rrënja e Incizit central mandibular:

- A) 6 - 7 vjeç
- B) 4 - 5 vjeç
- C) 9 vjeç
- D) 8 vjeç

PS)C

Pyetja 955 V)3

Çfarë sistem kodifikimi paraqet dhëmbi 32 :

- A) European
- B) Chevron
- C) FDI
- D) Universal

PS)C

Pyetja 956 V)3

Cili nga dhëmbët ka një antagonist:

- A) Shtata mandibulare (47)
- B) Teta maksilare (18)
- C) Kanini maksilar (13)
- D) Laterali Mandibular (41)

PS)B

Pyetja 957 V)3

Çfarë dhëmbë shtyllë është kanini mandibular:

- A) Dhëmbë shtyllë i klasit të parë
- B) Dhëmbë shtyllë i klasit të dytë
- C) Dhëmbë shtyllë i klasit të tretë
- D) Dhëmbë shtyllë i klasit të katërt

PS)A

Pyetja 958 V)3

Sa llojesh është lidhja cement - zmal :

- A) 3 llojesh
- B) 2 llojesh
- C) 5 llojesh
- D) 4 llojesh

PS)D

Pyetja 959 V)3

Cementoblastet janë qeliza që formojnë:

- A) cementin
- B) dentinën
- C) zmalin
- D) pulpën

PS)A

Pyetja 960 V)3

Çfarë është Dentina:

- A) Substantia osteoidea
- B) Substantia eburnea
- C) Substantia adamantina
- D) Substantia oseoze

PS)B

Pyetja 961 V)3

Zona e kontaktit midis dy incizivëve central është:

- A) Në vendin e bashkimit të 1/3 dhe të mesme
- B) Në qendër bukolingualisht
- C) Në 1/3 e mesme të kurorës
- D) Në 1/3 incizale të kurorës dhe është në qendër bukolingualisht

PS)D

Pyetja 962 V)3

Kur erupton kanini mandibular:

- A) 11 - 2 vjeç
- B) 8 - 9 vjeç
- C) 9 - 10 vjeç
- D) 10 - 12 vjeç

PS)C

Pyetja 963 V)3

Formimi i kurorës për dhëmbët e qumështit pas lindjes bëhet për kaninin:

- A) 8.5 muaj
- B) 3 muaj
- C) 7 muaj
- D) 10.5 muaj

PS)A

Pyetja 964 V)3

Cili nga dhëmbët ka formën e sipërfaqes përtypëse rromboidale:

- A) Molari i parë mandibular
- B) Molari i parë maxilar
- C) Molari i dytë maxilar
- D) Molari i dytë mandibular

PS)B

Pyetja 965 V)3

Sa kanale ka molari i parë mandibular:

- A) Dy kanale
- B) Katër kanale
- C) Tre kanale
- D) Një kanal

PS)C

Pyetja 966 V)3

Çfarë forme paraqet prerja transversal cervikale e premolarit të dytë mandibular:

- A) Veshke
 - B) Katërkëndëshe
 - C) Elipsoide
 - D) E rrumbullakët
- PS)B

Pyetja 967 V)3

Çfarë forme ka fossa triangulare e Molarit të parë Maxilar:

- A) Formë trapezoidale
 - B) Formë rromboidale
 - C) Formë katrore
 - D) Formë trekëndëshi
- PS)D

Pyetja 968 V)3

Çfarë forme ka Dhoma pulpare e molarit të parë maxilar në prerjen mezio-distale :

- A) rromboidale
 - B) katrore
 - C) ovale
 - D) të rrumbullakët
- PS)B

Pyetja 969 V)3

Në çfarë moshe kompletohet kurora e Molarit të parë mandibular:

- A) 6 - 7 vjeç
 - B) Në lindje
 - C) 5 - 6 vjeç
 - D) 2.5 - 3 vjeç
- PS)D

Pyetja 970 V)3

Sa është numri i lobeve të zhvillimit ka Molari i parë mandibular :

- A) 3 lobe
 - B) 4 lobe
 - C) 5 lobe
 - D) 2 lobe
- PS)C

Pyetja 971 V)3

Çfarë pjerrësie në drejtim labio-palatinal ka incizivi central maxilar:

- A) Ka pjerrësi palatinale 2°
 - B) Ka pjerrësi palatinale 28°
 - C) Ka pjerrësi palatinale 15°
 - D) Ka pjerrësi palatinale 22°
- PS)B

Pyetja 972 V)3

Sa është kurbatura e linjës cervikale meziale e Incizivit central mandibular:

- A) 2.0 mm
- B) 2.5 mm
- C) 3.0 mm
- D) 3.5 mm

PS)C

Pyetja 973 V)3

Çfarë këndi formon kanini mandibular në drejtim Mezio-distal:

- A) Formon një kënd 12°
- B) Formon një kënd 6°
- C) Formon një kënd 28°
- D) Formon një kënd 15°

PS)B

Pyetja 974 V)3

Çfarë forme ka sipërfaqja proximale meziale e premolarit të parë maksilarë:

- A) rromboidale
- B) katrore
- C) trapezoidale
- D) trekëndore

PS)C

Pyetja 975 V)3

Në pamjen proximale meziale të Molarit të parë maxilar kush kuspид është më i lartë:

- A) Kuspидi mezio-lingual
- B) Kuspидi mezio-bukal
- C) Kuspидi disto-lingual
- D) Kuspидi disto-bukal

PS)A

Pyetja 976 V)3

Çfarë antagonisti sekondarë ka molari i parë mandibular:

- A) Molarin e parë mandibular
- B) Molarin e dytë maxilar
- C) Premolarin e dytë maxilar
- D) Premolarin e parë maxilar

PS)C

Pyetja 977 V)3

Cili është funksioni i harkut vestibular në aparatit e levizshëm ortodontik:

- A) Ekstrudon dhëmbët frontalë
- B) Intrudon dhe lingualizon dhëmbët frontalë
- C) Intrudon dhëmbët frontalë
- D) Retrudon dhëmbët frontalë

PS)D

Pyetja 978 V)2

Kush është forca optimale për lëvizjen intruduese dentare:

- A) 0,05 - 0,1 N
- B) 0,2 - 0,4 N
- C) 0,5 - 1.0 N
- D) 5 - 10 N

PS)B

Pyetja 979 V)2

Sindromi Treacher-Collins është rezultat i:

- A) Traumës postnatale
- B) Traumës gjatë lindjes
- C) Të dyja së bashku
- D) Defekt i migrimit të qelizave të kreshtës neurale

PS)D

Pyetja 980 V)1

Egocentrizmi është veti psikologjike e fëmijëve të moshës:

- A) 0-2 vjeç
- B) 2-5 vjeç
- C) 5-7vjeç
- D) Të gjitha të vërteta

PS)B

Pyetja 981 V)2

Si një dentist i përgjithshëm, cili pacient kërkon trajtim të menjëhershëm:

- A) 8 vjeçar me kafshim të thellë
- B) 8 vjeçar me devijim të vijës mediane vetëm në pozicionin e okluzionit qendror
- C) 8 vjeçar me malokluzion te klasës II/2
- D) 8 vjeçar me malokluzion te klasës I-re me grumbullime serioze

PS)B

Pyetja 982 V)2

!Në një kafshim të kryqëzuar: molari i parë i sipërm është i zhvendosur palatinal, molari i parë mandibular është lingual. Si do ta korrigjoni këtë gjendje:

- A) Përdoret një plan i inklinuar
- B) Përdoret një aparat me vidë sagitale
- C) Përdoret një elastik i kafshimit të kryqëzuar mes dy molarëve
- D) Përdoret një headgear

PS)C

Pyetja 983 V)1

Në humbjen e hershme spontane të kaninëve të qumështit:

- A) Rezultat i kariesit të pamjekuar
- B) Ndodh në rastet e mungesës kongjenitale të 33,43
- C) Një indikacion për vendosjen e ruajtësit të vendit
- D) Një simptomë e grumbullimit të dhëmbëve permanentë

PS)D

Pyetja 984 V)1

Cefalometria jep të dhëna :

- A) Funksionale
- B) Vertikale dhe transversale
- C) Sagitale dhe transversale
- D) Sagitale dhe vertikale

PS)D

Pyetja 985 V)2

Cili model heqjeje është më i përshtatshëm për një pacient me klasë të II/1:

- A) 14,24 dhe 35,45
- B) 15,25 dhe 34,44
- C) 14,24 dhe 34,44
- D) 14,24

PS)A

Pyetja 986 V)1

Trajtimi ortodontik në moshat e rritura mund të përfshijë korrigjimin:

- A) E klasës së II-të skeletale
- B) E klasës së II-të dentare
- C) E klasës së III-të skeletale
- D) Devijimin lateral skeletal

PS)B

Pyetja 987 V)3

Headgear cervikal përdoret për:

- A) Korrigjimin e klasës së III-të dentare
- B) Korrigjimin e klasës së III-të skeletale
- C) Perforues ankorimi
- D) Korrigjimin e komprimimit skeletal transversal

PS)C

Pyetja 988 V)2

Në pamjen cefalometrike, një simfizë e gjatë dhe e holle është karakteristikë e subjektit me tipologji:

- A) Brakofaciale
- B) Dolikofaciale
- C) Normofaciale
- D) Mikse

PS)B

Pyetja 989 V)2

Një kënd i vogël i inklinimit maksilar çon në:

- A) Buzëqeshje gingivare
- B) Rrit over-jet
- C) Të dyja të vërteta
- D) Tendencë për kafshim normal

PS)A

Pyetja 990 V)2

Prezenca në ekzaminimin klinik e diastemës është shpesh rezultat i:

- A) Thithjes së gishtit
- B) Makroglosisë
- C) Respiracionit oral
- D) Frenulumit hipertrofik superior

PS)D

Pyetja 991 V)3

Në sindromën e obstrukcionit respirator, cila nga simptomat e mëposhtme është prezente:

- A) Rritja e tipit horizontal
- B) Buzët kompetente
- C) Rotacioni mandibular posterior
- D) Mbulimi i rritur vertikal

PS)C

Pyetja 992 V)2

Humbja parakohe e dhëmbit 75 mund të shkaktojë:

- A) Grumbullime posteriore
- B) Klasë të III-të molare bilaterale
- C) Kafshim të kryqëzuar bilateral
- D) Pseudo klasë të III-të molare majtas

PS)D

Pyetja 993 V)2

Cila nga këndet cefalometrike parashikon rritjen e dimensioneve vertikale:

- A) ANB
- B) SNA
- C) NSGn
- D) NSAr

PS)C

Pyetja 994 V)1

Cila është një arsye për të përfshirë heqjen si pjesë e planit trajtues ortodontik:

- A) Kafshimi i kryqëzuar
- B) Asimetria e harkut
- C) Hapësirat dentare
- D) Incizivët e retruduar

PS)B

Pyetja 995 V)2

Cila është e vërtetë për sa i përket aparateve të lëvizshme:

- A) Mund të tërheqin dhëmbet në mënyrë trupore
- B) Mund të korrigjojnë dhëmbet me rotacion
- C) Nuk përdoren në subjektet e rritura
- D) Zhvillojnë një forcë të rendë të vazhdueshme

PS)B

Pyetja 996 V)1

Çfarë tregon këndi ANB në cefalometrië

- A) Prognati maksilare
- B) Prognati mandibulare
- C) Klasat sagitale skeletale
- D) Klasat sagitale vertikale

PS)C

Pyetja 997 V)2

Zhvillimi i iniciativës sipas psikologëve është karakteristike për moshën:

- A) 0-2 vjeç
- B) 3-6 vjeç
- C) 9-12 vjeç
- D) 14-17 vjeç

PS)B

Pyetja 998 V)2

Modifikimi morfologjik i këndit mandibular i atribuohet:

- A) Teorisë së Moss-it
- B) Teorisë piezoelektrike
- C) Teorisë kartilagjinoze
- D) Teorisë së rrjedhjes së gjakut

PS)A

Pyetja 999 V)2

Mikrosomia hemifaciale shoqërohet me:

- A) Veshtirësi në frymëmarrje
- B) Humbje të dëgjimit
- C) Asimetri mandibulare
- D) Dhëmbë supernumeratum

PS)C

Pyetja 1000 V)2

Proceset mediane nazale kontribojnë në formimin e:

- A) Maksilës
- B) Palatumit primar
- C) Palatumit sekondar
- D) Palatumit terciar

PS)B

Pyetja 1001 V)3

Fytyra embrionale perbehet nga:

- A) 2 procese primitive
- B) 3 procese primitive
- C) 4 procese primitive
- D) 5 procese primitive

PS)D

Pyetja 1002 V)2

Mandibula merr origjinën nga:

- A) Harku i 1-rë brankial
- B) Harku i 2-të brankial
- C) Harku i 3-të brankial
- D) Harku i 4-të brankial

PS)A

Pyetja 1003 V)3

Ku është e lokalizuar qendra e rrotullimit të dhëmbit:

- A) Në ë gingivare të koronës
- B) Në ë apikale të rrënjës
- C) Në ë gingivare të rrënjës
- D) Ndryshon në raport me sistemin e forcave të aplikuara mbi elementet dentare

PS)D

Pyetja 1004 V)2

Harku palatinal Nance:

- A) Favorizon humbjen e ankorimit posterior
- B) Rrit ankorimin e molarëve
- C) Favorizon retraksionin e bllokut inciziv
- D) Asnjë përgjigje e saktë

PS)B

Pyetja 1005 V)2

Përdorimi i retainer fiks këshillohet në:

- A) Prezencë të deviacionit të vijës mediane
- B) Mbas korigjimit të kafshimit të kryqëzuar lateral
- C) Mbas mbylljes së hapësirave interdentalë
- D) Mbas ndërhyrjes së germektomisë

PS)C

Pyetja 1006 V)3

Kafshimi konstruktiv me dyll për përparatjen e aparatit Frankel 2, merret:

- A) Duke centruar linjat mediane
- B) Pa ndryshuar okluzionin
- C) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën mbrapa
- D) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën para

PS)D

Pyetja 1007 V)2

Rimodelimi i koronave të kaninëve kryhet në prani të:

- A) Agenezisë së premolarëve të parë
- B) Incizivëve lateralë me diametër mesio-distal të rritur
- C) Agenezisë së incizivëve lateralë
- D) Grumbullimeve në sektorin anterior

PS)C

Pyetja 1008 V)2

Pllaka labiale superiore është prezent në :

- A) Aparatin fiks
- B) Aparatin Frankel 2
- C) Aparatin Frankel 3
- D) Bionator

PS)C

Pyetja 1009 V)2

Për çfarë shërbejnë elastikët e klasës së II-të:

- A) Për të spostuar distalisht kaninët inferiorë
- B) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë
- C) Për të ricentruar linjat mediane asimetrike
- D) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë dhe mezialisht molarët inferiorë

PS)D

Pyetja 1010 V)2

Pllaka labiale inferiore është prezent në :

- A) Aparatin fiks
- B) Aparatin Frankel 2
- C) Aparatin Frankel 3
- D) Bionator

PS)B

Pyetja 1011 V)2

Kafshimi konstruktiv me dyll për përparatjen e aparatit Frankel 3, merret:

- A) Duke centruar linjat mediane
- B) Pa ndryshuar okluzionin
- C) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën mbrapa
- D) Duke centruar linjat mediane dhe tërhequr mandibulën para

PS)C

Pyetja 1012 V)3

Përdorimi i retainer fiks nuk këshillohet:

- A) Mbas korigjimit të rotacioneve të dhëmbëve frontalë
- B) Mbas korigjimit të kafshimit të kryqëzuar lateral
- C) Mbas mbylljes së hapësirave interdentalë
- D) Mbas korigjimit të rotacioneve të dhëmbëve distalë

PS)B

Pyetja 1013 V)2

Për çfarë shërbejnë elastikët e klasës së III-të:

- A) Për të spostuar distalisht kaninët inferiorë
- B) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë
- C) Për të ricentruar linjat mediane asimetrike
- D) Për të spostuar distalisht kaninët superiorë dhe mezialisht molarët inferiorë

PS)A

Pyetja 1014 V)3

Indikacioni për lip-bumper:

- A) Buzë inferiore hipotonike
 - B) Gëlltitje atipike
 - C) Thithje e gishtit
 - D) Linguo-version i incizivëve inferiorë nga hipertonia labiale
- PS)D

Pyetja 1015 V)1

Në çfarë manovre terapeutike duhen ekstraktuar kaninët e qumështit:

- A) Kur kërkohet hapësirë për të kaluar kroshetë e aparatit
 - B) Në ekstraksionet seriale
 - C) Në klasën e III-të me hipozhvillim maksilar
 - D) Në terapinë e klasës II/1
- PS)B

Pyetja 1016 V)2

Programi i ekstraksioneve seriale fillon:

- A) Në moshën 4-5 vjeç
 - B) Në moshën 6-7 vjeç
 - C) Në moshën 8-9 vjeç
 - D) Në moshën 10-11 vjeç
- PS)C

Pyetja 1017 V)2

Kur indikohet ekstraksioni i dhëmbëve permanentë në harkadën superiore:

- A) Në klasën e III-të skeletale hipodivergente
 - B) Në klasën e II/2 hiperdivergente me grumbullime anteriore
 - C) Në klasën e II/2 hipodivergente
 - D) Në klasën e II/1 me kafshim të thellë skeletal
- PS)B

Pyetja 1018 V)1

Në çfarë tipi të malokluzionit përdoret grila fikse ose e lëvizshme:

- A) Në klasën e II/1 me kafshim të hapur
 - B) Respiracion oral
 - C) Malokluzion shkaktuar nga ankiloglosia
 - D) Gëlltitje atipike
- PS)D

Pyetja 1019 V)2

Lamina pasardhëse shfaqet në:

- A) Në fazën e bulëzës së dhëmbëve të qumështit
 - B) Në fazën e kupës së dhëmbëve të qumështit
 - C) Në fazën e këmbanës së dhëmbëve të qumështit
 - D) Në procesin e mineralizimit
- PS)C

Pyetja 1020 V)2

Dhëmbët që preken më shpesh nga variacionet e numrit dhe formës janë:

- A) Lateralët maksilarë
- B) Lateralët mandibularë
- C) Premolarët maksilarë
- D) Premolarët mandibularë

PS)A

Pyetja 1021 V)1

Dhëmbët që preken më shpesh nga pozicioni ektopik janë:

- A) Lateralët maksilarë
- B) Molarët mandibularë
- C) Kaninët maksilarë
- D) Premolarët mandibularë

PS)D

Pyetja 1022 V)2

Ndryshimi i pozicionit të kockës maksilare gjatë zgjerimit të shpejtë:

- A) Përcakton një rotacion anterior të mandibulës
- B) Përcakton një rotacion posterior të mandibulës
- C) Nuk influencon rotacionin mandibular
- D) Përcakton një ulje të dimensioneve vertikale anteriore

PS)B

Pyetja 1023 V)2

Është e mundur të kombinohet aparati i lëvizshëm me një ekstraoral:

- A) Po
- B) Jo
- C) Po, por vetëm në pacientë që kanë mbaruar rritjen
- D) Po, por vetëm nëse aparati i lëvizshëm ka të inseruara elementet për ekstraoralin

PS)D

Pyetja 1024 V)1

Ekzistojnë aparate funksionale të tipit fiks:

- A) Jo
- B) Bionator
- C) Herbst
- D) Frankel

PS)C

Pyetja 1025 V)2

Kur indikohet fibrotomia e fibrave suprakreshtale:

- A) Xhepa paradontalë më shumë se 4 mm
- B) Ankiloza e dhëmbëve të qumështit
- C) Ankiloza e dhëmbëve permanentë
- D) Për të parandaluar recidivën në rastet e derotacioneve

PS)D

Pyetja 1026 V)3

Çfarë është harku W :

- A) Është harku ideal
 - B) Është harku i nivelimit
 - C) Është hark ekspansioni
 - D) Është hark ekstraoral
- PS)C

Pyetja 1027 V)2

Si matet forca në tërheqjen ekstraorale:

- A) Me dinamometër në të dyja anët e tërheqjes
 - B) Me dinamometër vetëm në një anë të tërheqjes
 - C) Me goniometër
 - D) Me sy
- PS)A

Pyetja 1028 V)1

Prevenzioni në ortodonci përfshin:

- A) Ekstraksionet
 - B) Heqjen e veseve
 - C) Higjenën orale dhe fluorizimin
 - D) Trajtimet endodontike
- PS)B

Pyetja 1029 V)1

Çfarë drejtimi duhet të ketë mentoniera në rastin e tendencës të rritjes orare:

- A) Lart
 - B) Poshtë
 - C) Cervikal
 - D) Anterior
- PS)A

Pyetja 1030 V)2

Cili është funksioni i planit (trashjes) anterior në aparatën e lëvizshëm:

- A) Favorizimi i ekstruzionit të dhëmbëve posteriorë
 - B) Intruzioni i kaninëve superiorë
 - C) Vestibularizim i incizivëve superiorë
 - D) Lingualizim i incizivëve superiorë
- PS)A

Pyetja 1031 V)2

Çfarë kuptohet me ankorimin në biomekanikën ortodontike:

- A) Rezistenca e ofruar nga dhëmbët posteriorë ndaj spostimeve dentare
 - B) Rezistenca e ofruar nga grupet e dhëmbëve ndaj distalizimeve
 - C) Rezistenca e një dhëmbi ose grup dhëmbësh ndaj spostimeve dentare
 - D) Të treja janë të vërteta
- PS)C

Pyetja 1032 V)2

Cili sistem force duhet të përdoret për lëvizjen intruduese:

- A) Një kopje forcash
- B) Një forcë e vetme drejtuar gjatë aksit të elementit dentar
- C) Një sistem i përbërë nga forcë e vetme dhe kopje forcash
- D) Një forcë në drejtim lingual

PS)B

Pyetja 1033 V)1

Për sa orë këshillohet të mbahet aparati ekstraoral për të marrë efekt ortopedik:

- A) 24 orë
- B) 20 orë
- C) 18 orë
- D) 14 orë

PS)D

Pyetja 1034 V)1

Cilat janë elementet retentive në një aparat të lëvizshëm:

- A) Kroshetë, sustat, harku vestibular
- B) Kroshetë
- C) Kroshetë, sustat, vida
- D) Kroshetë, harku vestibular, pllaka e rezinës

PS)D

Pyetja 1035 V)1

Cilat janë elementet aktive në një aparat të lëvizshëm:

- A) Kroshetë, sustat, harku vestibular
- B) Kroshetë
- C) Harku vestibular, sustat, vida zgjeruese
- D) Sustat, harku vestibular, pllaka e rezinës

PS)C

Pyetja 1036 V)3

Cili është funksioni biomekanik i pllakave laterale dhe labiale të aparatit Frankel:

- A) Retensioni
- B) Aplikimi i forcës ortodontike mbi elementet dentare të harkadës inferiore
- C) Aplikimi i presionit mbi indet e buta
- D) Eliminimi i presionit të indeve të buta

PS)D

Pyetja 1037 V)3

Cili është funksioni biomekanik i harkut transpalatinal:

- A) Ankorues
- B) Ekspandues palatinal
- C) Eviton interinferencat në lëvizjet laterale
- D) Ankorues, ekspandues palatinal dhe derotullues për molarët

PS)D

Pyetja 1038 V)2

Cili sistem force aplikohet nga një aparat të lëvizshëm:

- A) Një forcë e vetme ose një kopje forcash
- B) Një forcë e vetme
- C) Një kopje forcash
- D) Asnjë përgjigje e saktë

PS)A

Pyetja 1039 V)2

Cili është funksioni biomekanik i kthesave vertikale në harkun vestibular në një aparat të lëvizshëm:

- A) Ul reziliencën e telit
- B) Rrit mundësinë e rezistencës ndaj deformimeve të telit
- C) Rrit gjatësinë e telit dhe elasticitetin
- D) Asnjë përgjigje e saktë

PS)C

Pyetja 1040 V)1

Aktivizimi i kthesave vertikale në harkun vestibular në një aparat të lëvizshëm çon në:

- A) Lëvizje dentare në planin horizontal për dhëmbët anteriorë
- B) Lëvizje dentare në planin vertikal
- C) Lëvizje dentare në planin horizontal për anteriorët dhe vertikal për posteriorët
- D) Lëvizje dentare në planin horizontal për posteriorët dhe vertikal për anteriorët

PS)A

Pyetja 1041 V)1

Vlera mesatare e translacionit lateral të menjëhershëm është:

- A) 0.4 mm
- B) 1.5 mm
- C) 2.0 mm
- D) 2.6 mm

PS)A

Pyetja 1042 V)1

Faktori që vlerëson dhëmbin është raporti:

- A) Kurorë-rrënjë
- B) I rrënjës me alveolën
- C) I kurorës me buzën
- D) I kurorës me procesin karioz

PS)A

Pyetja 1043 V)1

Shkaku pse dhëmbët anteriorë janë të përshtatshëm për drejtimin e mandibulës:

- A) Dhëmbët anteriorë kanë kurorë të madhe
- B) Pragu proprioceptiv dhe refleksët shoqëruese zvogëlojnë forcat
- C) Dhëmbët anteriorë sigurojnë estetikë
- D) Dhëmbët anteriorë kariohen më pak

PS)B

Pyetja 1044 V)1

Kunjat parapulpare përdoren në:

- A) Dy mënyra
- B) Katër mënyra
- C) Tre mënyra
- D) Pesë mënyra

PS)A

Pyetja 1045 V)1

Nga se varet zgjedhja e aliazhit për një kurorë të plotë metalike:

- A) Përkulshmëria e tij
- B) Zvogëlimi i oksideve
- C) Derdhshmëria
- D) Kuspidet mezio-disto-bukale

PS)C

Pyetja 1046 V)1

Kush nga kuspidet e molarëve të poshtëm do të jenë më të shkurtër:

- A) Kuspidet bukale
- B) Kuspidi disto-bukal
- C) Kuspidet linguale
- D) Kuspidet mezio-disto-bukale

PS)C

Pyetja 1047 V)1

Koeficienti i tkurrjes së aliazheve të zakonshme është :

- A) 1.5%
- B) 2.4%
- C) 2.8%
- D) 3.4%

PS)B

Pyetja 1048 V)1

Grada optimale për konicitetin e preparimit të molarit të dytë maksilar është :

- A) 14°
- B) 21°
- C) 24°
- D) 28°

PS)B

Pyetja 1049 V)1

Çfarë bën përqëndrimi i madh i Aluminit në porcelan:

- A) Formohen kristale që sigurojnë estetikën
- B) Formohen kristale që janë rregulluese
- C) Formohen kristale që parandalojnë frakturat
- D) Formohen kristale që parandalojnë ngjitjen

PS)C

Pyetja 1050 V)1

Gjatë preparimit të një dhëmbi për kurora metal-porcelan, si duhet të jenë dy muret e kundërta të jashtme:

- A) Duhet të konvergojnë
- B) Duhet të divergojnë
- C) Duhet të jenë paralele
- D) Duhet të jenë të shpërndara

PS)A

Pyetja 1051 V)1

Kërkesa më e rëndësishme për kurorat provizore është:

- A) Përgatitja e lehtë
- B) Përdorimi i plastmasës bis-gma
- C) Mbrojtja e pulpës
- D) Përgatitja direkt në zgavrën e gojës

PS)C

Pyetja 1052 V)1

Përdorimi i Aliazheve të Arit të tipit të parë është për:

- A) Urat fiske
- B) Protezat parciaie të skeletuara
- C) Shinat në paradontologji
- D) Inley të vogla

PS)D

Pyetja 1053 V)1

Linja e mbylljes për kurorën metal porcelan për dhëmbët distalë është:

- A) Shpatull
- B) Shpatull e rrumbullakosur
- C) Teh thike
- D) Chamfer

PS)D

Pyetja 1054 V)1

Trashësia e porcelanit në kurorat metal porcelan është :

- A) 0.7-1 mm
- B) 1.0-1.5 mm
- C) 1.5-2 mm
- D) 2-2.7 mm

PS)A

Pyetja 1055 V)1

Faseta Vener përdoret në dhëmbët:

- A) E dekoloruar
- B) Me pozicion të theksuar vestibular
- C) Me pozicion të theksuar lingual
- D) Me rrotacion të theksuar

PS)A

Pyetja 1056 V)1

Kurora metalike përdoret:

- A) Për sigurimin e estetikës
 - B) Për mjekimin protetik të paradontozës
 - C) Për mjekimin e mikrodoncisë
 - D) Në dhëmbët me hipoplazi
- PS)B

Pyetja 1057 V)1

Ulluku horizontal në kurorat 3/4 anteriore bëhet:

- A) Në mesin e faqes linguale
 - B) Në 1/3 cervikale të faqes linguale
 - C) Direkt nën margon incizale të faqes linguale
 - D) Paralel me faqet proksimale
- PS)C

Pyetja 1058 V)1

Ana negative e intermedierit higjenik:

- A) Lehtësi për pastrimin e ushqimit
 - B) Nuk takon gingivën
 - C) Nuk dëmtohen indet e buta
 - D) Nuk siguron estetikën
- PS)D

Pyetja 1059 V)1

Kur metali është i gatshëm të derdhet në cilindrin e skuqur:

- A) Kur metali i shkrirë është me ngjyrë të kuqe
 - B) Kur metali i shkrirë ka ngjyrë të bardhë si pasqyrë
 - C) Kur metali ka ngjyrë portokalli
 - D) Kur metali ka ngjyrë të bardhë pa shkëlqim
- PS)B

Pyetja 1060 V)1

Kush janë kufijtë vestibularë më të përdorshëm në kurorën metal-porcelan:

- A) Vilar metalik
 - B) Porcelan që mbulon vilarin
 - C) Kufi krejt porcelani
 - D) Kufiri metal-porcelan
- PS)D

Pyetja 1061 V)2

Për restaurimet intrakoronale:

- A) Glassionomeret
 - B) Kurorat tërësisht qeramike
 - C) Kurorat e pjesshme
 - D) Fasetat qeramike
- PS)A

Pyetja 1062 V)2

Çfarë drejtimi ka rruga punuese dhe jo punuese:

- A) Bukal
 - B) Lingual e distobukal
 - C) Mezial
 - D) Buko-mezial
- PS)B

Pyetja 1063 V)2

Cila është përgjigja e saktë se si duhet të jetë profili i emergjencës:

- A) Konvekse
 - B) Konkav
 - C) I drejtë
 - D) I kombinuar konkav-konveks
- PS)C

Pyetja 1064 V)2

Sa është ekspansioni higroskopik i rivestimentit:

- A) 0.4%
 - B) 0.8%
 - C) 1.2-2.2%
 - D) 2.3-2.4%
- PS)C

Pyetja 1065 V)2

Stresi i cementit midis dhëmbit dhe restaurimit rritet me shpejtësi në:

- A) $2.5^0-6.5^0$
 - B) $3^0-5.6^0$
 - C) 10^0-14^0
 - D) 20^0
- PS)D

Pyetja 1066 V)2

Lëvizja mandibulare në aksin vertikal ndodh:

- A) Në planin sagital kur mandibula lëviz përpara
 - B) Në planin horizontal kur mandibula lëviz lateralisht
 - C) Në planin sagital kur mandibula lëviz prapa
 - D) Në planin sagital kur mandibula bën lëvizje hapje-mbyllje
- PS)B

Pyetja 1067 V)2

Inklinimi mezio-distal i rrugës së inserimit të kurorës artificiale duhet të jetë paralel me :

- A) Murin vestibular të dhëmbit
 - B) Pikat e kontaktit të dhëmbëve fqinjë
 - C) Murin lingual të dhëmbit
 - D) Margon incizale të dhëmbit
- PS)B

Pyetja 1068 V)2

Përcaktuesit e levizjes mandibulare janë:

- A) ATM në të dy anët
- B) Muskujt rezorius
- C) Muskujt përtypës
- D) Muskujt e faqes

PS)A

Pyetja 1069 V)2

Vendosja e modeleve në artikulator për diangostikim bëhet me kondilet në:

- A) Pozicionin e interkuspidimit maksimal
- B) Okluzion qëndror
- C) Pozicionin majë më majë
- D) Pozicionin e relacionit qëndror

PS)D

Pyetja 1070 V)1

Këndi i Bennet

- A) Regjistrohet në anën punuese
- B) Regjistrohet në anën jopunuese
- C) Regjistrohet në lëvizje sharnier
- D) Regjistrohet në lëvizje propulsive

PS)B

Pyetja 1071 V)1

Okluzioni më optimal është

- A) Okluzion i balancuar bilateral
- B) Okluzion i balancuar unilateral
- C) Okluzion qëndror
- D) Okluzion i mbrojtur në mënyrë të dyanëshme

PS)D

Pyetja 1072 V)1

Artikulatorët arkon

- A) Kryejnë vetëm lëvizje hapëse e mbyllëse
- B) Këndi i inklinimit kondilar mbetet i njëjtë në hapje dhe në mbyllje të artikulatorit
- C) Janë të përdorshëm për shkak të vlerave të shumta që duhen regjistruar
- D) Nuk përdorin hark facial

PS)B

Pyetja 1073 V)1

Harku i fytyrës :

- A) Na ndihmon të realizojmë regjistrime të raporteve ndërnofullore të ngjashme me ato të pacientit
- B) Na ndihmon të përcaktojmë lehtësisht linjën mediane
- C) Vështirëson vlerësimin e okluzionit
- D) Ndihmon në përcaktimin e dimensioneve të dhëmbëve

PS)A

Pyetja 1074 V)2

Raporti optimal kurorë-rrënjë për të vendosur një punim fiks duhet të jetë:

- A) 3/2
- B) 1/1
- C) 4/3
- D) 2/3

PS)D

Pyetja 1075 V)2

Mungesa e kaninit dhe e një dhëmbi fqinjë mund të restaurohet më mirë me:

- A) Protezë pjesore fikse me kurora të plota
- B) Protezë pjesore e cementuar me cemente rezinoze
- C) Protezë totale
- D) Proteze pjesore e levizëshme

PS)D

Pyetja 1076 V)2

Sa janë principet e preparimit :

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

PS)C

Pyetja 1077 V)2

Raporti i retensionit dhe rezistencës me sipërfaqen është:

- A) Në proporcion të drejtë
- B) Në proporcion të zhdrejtë
- C) Retensioni është në proporcion të zhdrejtë, rezistenca në proporcion të drejtë
- D) Retensioni është në proporcion të drejtë, rezistenca në proporcion të zhdrejtë

PS)A

Pyetja 1078 V)1

Retensioni :

- A) Rritet me rritjen e konicitetit
- B) Zvogëlohet me rritjen e konicitetit
- C) Nuk ndikohet nga koniciteti
- D) Nuk ka një raport të saktë mes konicitetit dhe retensionit

PS)B

Pyetja 1079 V)2

Koniciteti optimal i preparimit është vlerësuar të jetë:

- A) $3-6^{\circ}$
- B) 20°
- C) 15°
- D) 22°

PS)A

Pyetja 1080 V)2

Rruga e inserimit të punimit fiks:

- A) Ka një inklinim mezio-distal paralel me pikat e kontaktit të dhëmbëve fqinje
- B) Mund të jetë më shumë se një
- C) Të jetë e inklinuar vestibularisht
- D) Të jetë e inklinuar lingualisht

PS)A

Pyetja 1081 V)1

Në varësi të materialit të përdorur preparimi në kuspidet funksional varion nga

- A) 1,5-2 mm
- B) 1-1,5 mm
- C) 1-3 mm
- D) 2-4 mm

PS)A

Pyetja 1082 V)2

Pozicionimi i linjes së mbylljes kushtëzohet nga

- A) Shtrirja e restaurimeve të mëpareshme
- B) Kariesi okluzal
- C) Vitaliteti i dhembëve
- D) Okluzioni qendror

PS)A

Pyetja 1083 V)2

Linja e mbylljes marginale më e indikuar është

- A) Shpatull
- B) Teh thike
- C) Teh thike e pjerrësuar
- D) Chamfer

PS)A

Pyetja 1084 V)2

Linja e mbylljes duhet të pozicionohet për kurorat e plotë

- A) Mbi ekuatorin e dhëmbit
- B) Subgingivar deri në atashmentin epitelial
- C) Nën atashmentin epitelial
- D) Nuk ka rëndësi pozicionimi i saj

PS)B

Pyetja 1085 V)3

Nëse nuk respektohet trashësia e preparimit të linjës së mbylljes

- A) Nuk respektohet profili i emergjencës
- B) Nuk paraqitet asnjë vështirësi në përgatitjen e punimit fiks
- C) Kemi konicitet të vogël
- D) Punimi është estetik

PS)A

Pyetja 1086 V)2

Pozicionimi i linjës së mbylljes supragingivar mundëson

- A) Pastrim të lehtë nga pacienti dhe përpunim nga dentisti
- B) Favorizon kariesin dentar
- C) Rrit mundësinë për recesion gingivar
- D) Rrit mundësinë për shfaqje të paradontopatisë

PS)A

Pyetja 1087 V)2

Në përgatitjen për vidën intrakanalare preparojmë

- A) Vetëm në hyrje të kanalit
- B) E zgjerojmë kanalën por nuk e përpunojmë në gjatësi
- C) Përpunojmë me pak se mesi i gjatësisë së kanalit
- D) Përpunojmë në gjatësi aq sa të mbetet minimalisht 4 mm gutaperkë

PS)D

Pyetja 1088 V)2

Për përgatitjen e vidës së derdhur:

- A) Duhet bërë trajtim endodontik
- B) Mjafton mbulimi biologjik
- C) E lemë dhembin vital
- D) Nuk ka nevojë për asnjë parapërgatitje

PS)A

Pyetja 1089 V)2

Margo e kurorës kur vendoset mbi një dhemb me vidë duhet të shtrihet:

- A) Nën gingivë
- B) Mbi indin dhembor të shëndetshëm përtej kufirit të vidës
- C) Mbi strukturën e vidës së derdhur
- D) Pjesërisht në strukturën e vidës pjesërisht në strukturë dentare

PS)B

Pyetja 1090 V)3

Gjatësia e vidës duhet të jetë

- A) Sa l' të gjatësisë së kurorës
- B) Sa gjatësia e kurorës ose më e madhe
- C) Nuk ka rëndësi gjatësia e vidës
- D) Më pak se gjatësia e kurorës

PS)B

Pyetja 1091 V)3

Reduktimi i kuspitit jofunksional që të jetë i pranueshëm duhet të jetë minimalisht:

- A) 0.5 mm
- B) 0.7 mm
- C) 0.9 mm
- D) 1.2 mm

PS)A

Pyetja 1092 V)2

Kur kontrollojmë preparimin për pragje duhet

- A) Mbyllim njërën sy dhe drita e reflektuar nga pasqyra duhet të prek të gjithë sipërfaqen e dhëmbit uniformisht
 - B) I themi pacientit të mbyllë gojën në okluzion qëndror
 - C) Kontrollojmë me anë të sondës sipërfaqet aksiale të dhëmbit
 - D) Kontrollojmë linjën fundore
- PS)A

Pyetja 1093 V)1

Restaurimet provizore

- A) Ruajnë vitalitetin e pulpës
 - B) Ruajnë dentinën nga ngjyrosja
 - C) Realizohen vetëm me kërkesë të pacientit
 - D) Nuk kanë ndonjë rëndësi të veçantë protetike
- PS)A

Pyetja 1094 V)1

Restaurimet provizore realizohen me sa metoda

- A) 1
 - B) 2
 - C) 3
 - D) 4
- PS)B

Pyetja 1095 V)1

Cila nga të poshtëshenuarat nuk shërben për kontrollin e fluideve

- A) Antisialogogët
 - B) Antibiotikët
 - C) Antimykotikët
 - D) Antinflamatorët
- PS)A

Pyetja 1096 V)2

Për të realizuar teknikën e kyretazhit instrumentar për ekspozimin e margos gingivare duhet:

- A) Të ketë thellësi sulkusi më të vogël se 3mm
 - B) Të ketë thellësi sulkusi më të madhe se 3 mm
 - C) Nuk ka rëndësi thellësia e sulkusit kyretazhi kryhet gjithmonë
 - D) Kyretazhi instrumentar nuk përdoret si teknike për ekspozimin e margos
- PS)A

Pyetja 1097 V)3

Cili nga materialet e mëposhtëme është me hidrofilik

- A) Hidrokoloidet irreversibël
- B) Polieteret
- C) Silikonet e aditionit
- D) Polisulfidet

PS)A

Pyetja 1098 V)3

Cili nga materialet e mëposhtme është me hidrofobik

- A) Silikonet e adisionit
- B) Silikonet e kondensimit
- C) Polisulfidet
- D) Polieteret

PS)B

Pyetja 1099 V)2

Cili nga materialet e mëposhtme nuk është hidrofobik

- A) Silikoni i kondensimit
- B) Polisulfidet
- C) Silikonet e adisionit
- D) Gipsi

PS)D

Pyetja 1100 V)2

Tek silikonet e kondensimit reaksioni ndodh me

- A) Eliminimin e ujit
- B) Eliminimi i grupeve tiokol
- C) Eliminimin e gazit të hidrogjenit
- D) Eliminimin e alkoolit metilik apo etilik

PS)D

Pyetja 1101 V)2

Silikonet e adisionit

- A) Rezultojnë me formim të një produkti dytesor
- B) Ka qendrueshmëri dimensionale
- C) Ndikohet shumë nga vonesat e derdhjes
- D) Nuk janë të këshillueshme për protetiken fikse

PS)B

Pyetja 1102 V)2

Kontaktet proksimale në molarin e parë dhe të dytë sipër lokalizohen

- A) Në 1/3 okluzale
- B) Në 1/3 të mesme
- C) Në 1/3 gingivare
- D) Përgjatë gjithë gjatësisë

PS)B

Pyetja 1103 V)2

Aliazhet jofisnike kanë në përmbajtje

- A) Më shumë se 30 % të metaleve fisnike
- B) 30 % metale fisnike
- C) Nuk përmbajnë fare në përberje metale fisnike
- D) Më pak se 25 % metale fisnike

PS)D

Pyetja 1104 V)3

Ekspansioni termik i rivestimentit ndodh:

- A) Në banjon e ujit në tempeaturën 38
 - B) Gjatë përgatitjes së rivestimentit
 - C) Në derdhjen e metalit
 - D) Në furrën e ngrohjes
- PS)D

Pyetja 1105 V)3

Cili nga mekanizmat e mëposhtme nuk ndikon në zgjerimin e formës

- A) Ekspansioni higroskopik
 - B) Ekspansioni i ngurtësimit të rivestimentit
 - C) Ekspansioni i modelit të dyllit
 - D) Ekspansioni i metalit
- PS)D

Pyetja 1106 V)2

Konturi aksial në drejtim cervical me kontaktet proksimale është me optimal nëse ka formë:

- A) Të sheshtë
 - B) Konkave
 - C) Konvekse
 - D) Kubike
- PS)A

Pyetja 1107 V)2

Cili është mekanizmi i ngjitjes tek Cementet zink oksifosfat

- A) Ngjitja joadezive
 - B) Lidhja mikromekanike
 - C) Adezioni molekular
 - D) Forcat e Van der valsit
- PS)A

Pyetja 1108 V)1

Muskuli që merr pjesë në hapjen e gojës është

- A) Muskuli temporal
 - B) Muskuli masseter
 - C) Muskuli digastrik
 - D) Muskuli buccinator
- PS)C

Pyetja 1109 V)1

Relacioni qëndror është

- A) Pozicioni me antero-superior i kondilit në eminencen artikulare të fosses glenoide
 - B) Pozicioni me antero-inferior i kondilit në eminencen artikulare të fosses glenoide
 - C) Pozicioni me posterior superior i kondilit në eminencen artikulare të fosses glenoide
 - D) Pozicioni me posterior-inferior i kondilit në eminencen artikulare të fosses glenoide
- PS)A

Pyetja 1110 V)2

Lëvizja mandibulare sipas aksit horizontal është:

- A) një lëvizje e pastër rotatore
- B) lëvizje laterale
- C) lëvizje protruduese
- D) lëvizje retruduese

PS)A

Pyetja 1111 V)3

Lëvizja kur mandibula lëviz në planin horizontal në drejtim lateral është lëvizje që realizohet sipas

- A) aksit vertikal
- B) aksit sagital
- C) aksit horizontal
- D) aksit oblik

PS)A

Pyetja 1112 V)2

vlera mesatare e këndit të Bennet (vlera mesatare e translacionit lateral progresiv) është

- A) 13.9°
- B) 19.3°
- C) 12.8°
- D) 18.2°

PS)C

Pyetja 1113 V)3

Vlera mesatare e translacionit të menjëhershëm është

- A) 0.4 mm
- B) 1.4 mm
- C) 2.4 mm
- D) 3.4 mm

PS)A

Pyetja 1114 V)1

Një grua 49 vjeçare paraqet kollë produktive, ethe me frisione, opacitet homogjen në lobin pulmonar medial dex. Ekzaminimi bakterioskopik i ekspektorantit evidenton koke gram pozitive. Cili agjent etiologjik ka mundësi të jetë më i akuzuari ë

- A) Mycoplasma pneumonie
- B) Streptococcus pneumonie
- C) Staphylococcus aureus
- D) Legionela pneumophila
- E) Mycobacterium tuberculosis

PS)B

Pyetja 1115 V)1

Cili është medikamenti më i përdorur për kontrollin e inflamacionit të rrugëve ajrore tek një pacient astmatikë

- A) Kortikosteroid në rrugë sistemike
- B) Kortikosteroid në rrugë inhalatore
- C) Teofilina
- D) Inhibitori i Cox-2
- E) Beta-2 agonisti

PS)B

Pyetja 1116 V)1

Vendi më i shpeshtë i hemorragjive cerebrale është:

- A) Cerebelumi
- B) Cauda
- C) Truncus cerebri
- D) Capsula interna
- E) Nucleus ruber

PS)D

Pyetja 1117 V)1

Qelizat akustike janë të lokalizuara në nivel të:

- A) Membranes Reissner
- B) Organit të Cortit
- C) Kanalit koklear
- D) Utrikulit
- E) Sakulit

PS)B

Pyetja 1118 V)2

Mendimi në konfuzionin mendor është:

- A) I kthjellët dhe i logjikshëm
- B) Jo i logjikshëm dhe i fragmentarizuar
- C) I shpejtuar por i logjikshëm
- D) J mbushur me ide obsesive
- E) Qartësisht delirant

PS)B

Pyetja 1119 V)1

Në cilën nga këto artropati aspekti radiologjik artikular është plotësisht negativë

- A) Sindroma e Felty
- B) Artrit reumatoid
- C) Podagër kronike
- D) Artrozë
- E) Reumatizmi artikular akut

PS)E

Pyetja 1120 V)1

Cila nga citokinat e mëposhtme është thelbësore për proliferimin e qelizave T në përgjigjen imunitareë

- A) IL-1
 - B) IL-2
 - C) IL-6
 - D) GM-CSF
 - E) G-CSF
- PS)B

Pyetja 1121 V)1

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm duhet të bëhet fillimisht për një burrë 64 vjeçar që ka ikter prej 4 javëshë

- A) Echografia
 - B) CT skaner
 - C) Kolangiopankreatografia endoskopike
 - D) Kolangiografia transhepatike perkutane
 - E) Koleshintigrafia
- PS)A

Pyetja 1122 V)2

Piku i LH-së në pubertetet është:

- A) Mungues
 - B) Diurn
 - C) Nokturn
 - D) Në raport me pikun e kortizolit
 - E) I ndryshueshëm
- PS)C

Pyetja 1123 V)1

Aspekti histologjik 'në mozaik' është tipik për:

- A) Osteomën osteoide
 - B) Sëmundjen e Camerati-Engelman
 - C) Morbus Paget
 - D) Sëmundjen e Albers-Schoenberg
 - E) Osteomielitin kronik
- PS)C

Pyetja 1124 V)1

Të gjitha rrethanat e mëposhtme përfaqësojnë faktorët e riskut të kolelitiazës kolesterolike, përveç:

- A) Obezitetit
 - B) Terapisë me clofibrate
 - C) Terapisë me estrogenike
 - D) RezekSIONIT kirurgjikal të ileusit
 - E) Rekto-kolitit ulceroz
- PS)E

Pyetja 1125 V)2

Një embol i madh që bllokon arterien pulmonare të djathtë mund ta ketë origjinën:

- A) Nga atriumi i majtë
- B) Nga arteria subklavie e djathtë
- C) Nga vena pulmonare e djathtë
- D) Nga vena axilare e majtë
- E) Nga ventrikuli i majtë

PS)D

Pyetja 1126 V)1

Çfarë është një mesazh paradoksalë

- A) Është një mesazh që pohon diçka në një nivel (psh verbal) dhe kundërshton në një nivel tjetër (psh jo verbal).
- B) Është një mesazh negativ duke mos patur mundësinë e komenteve.
- C) Është një mesazh i karakterizuar nga ironia.
- D) Është një mesazh i tërthortë.
- E) Është një mesazh autoritar.

PS)A

Pyetja 1127 V)1

Karakteristikat e edemës pulmonare karakteristikat e mëposhtme, përveç:

- A) Dispnesë
- B) Dhimbjes pleurale
- C) Kollës
- D) Raleve në bazat pulmonare
- E) Alteracioneve radiologjike

PS)B

Pyetja 1128 V)2

Sindroma e Waterhouse-Friderichsen provokohet nga:

- A) Trauma kraniale
- B) Tromboza e a.koronare të djathtë
- C) K.I.D (koagulimi intravaskular i diseminuar)
- D) Hipertensioni arterial
- E) Hipotiroidizmi

PS)C

Pyetja 1129 V)1

Me termin 'efekt të kalimit të parë' kuptojmë:

- A) Efektin e parë që një medikament përcakton kur mbërrin në vendin e veprimit
- B) Efektet neurologjike që një medikament jep gjatë kalimit të parë në sistemin nervor qendror
- C) Biotransformimin e plotë që medikamenti pëson në kalimin e parë përmes mëlçisë
- D) Eliminimin e plotë të medikamentit në kalimin e tij të parë përmes veshkës
- E) Efektin intestinal të një medikamenti të administruar për os

PS)C

Pyetja 1130 V)1

Përqindja vdekshmërisë foshnjore është raporti midis:

- A) Numrit vjetor të të vdekurve në moshë më pak se një vjeç dhe numrit të lindjeve (të gjallë ose të vdekur) në të njëjtin vit
- B) Numrit vjetor të vdekjeve tek fëmijet me moshë me pak se një vjeç dhe numrit të të lindurve gjallë në të njëjtin vit
- C) Numrit të vdekjeve në 28 ditët e para të jetës dhe numrit të të lindurve gjallë në një vit
- D) Numrit të të lindurve të vdekur plus (+) numrin e të vdekurve në javën e parë dhe numrit të të lindurve gjallë plus (+) numrit të të lindurve të vdekur
- E) Numrit të vdekjeve në një vit dhe popullatës infantile (=8 vjeç)

PS)B

Pyetja 1131 V)1

Me hermafrodizëm të vërtetë nënkuptohet:

- A) Prania e njëkohshme e testikut dhe uterusit
- B) Prania e njëkohshme e penisit dhe uterusit
- C) Prania e njëkohshme e indit ovarian dhe testikular
- D) Prania e kavitetit vaginal dhe testikujve
- E) Organe genitale të padiferencuara, hipertrofi klitori dhe fuzionim labio-scrotal

PS)C

Pyetja 1132 V)1

Inhibitor i enzimës xantin-oksidade është medikamenti që quhet:

- A) Probenicid.
- B) Metotrexate.
- C) Allopurinol.
- D) Etambutol.
- E) Metoprolol.

PS)C

Pyetja 1133 V)2

Në sklerozën sistematike progresive, rezultati laboratorik më i rëndësishëm në diagnozë është:

- A) Prania e faktorit reumatoid në serum.
- B) Prania e antikorpeve antinukleare.
- C) Pozitiviteti i testeve biologjike të inflamacionit.
- D) Eozinofilia.
- E) Rritja e hidroksiprolinurisë.

PS)B

Pyetja 1134 V)1

Endospora është:

- A) Një etapë e detyrueshme e ciklit të jetës së prokarioteve.
- B) Një formë e veçantë riprodhimi e disa bakterieve Gram-pozitive.
- C) Një formë e veçantë riprodhimi e disa bakterieve Gram-negative.
- D) Një fleksion extern i paretit bakterial.
- E) Një formë e rezistencës ndaj kushteve ambientale të pafavorshme.

PS)E

Pyetja 1135 V)1

Nuk bën pjesë tek vendet e privileguara imunologjike:

- A) Truri.
- B) Testikujt.
- C) Apendiksi .
- D) Kornea.
- E) Dhoma anteriore e syrit.

PS)C

Pyetja 1136 V)1

Simptoma e hershme më e zakonshme në embolinë pulmonare ështëNJe

- A) Dispnea.
- B) Cianoza.
- C) Hemoptisia.
- D) Edema e anesive inferiore.
- E) Dhimbje torakale të lidhura me frymarrjen.

PS)A

Pyetja 1137 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme është manifestim alergjik nga medikamentetë

- A) Lupus eritematoz nga procainamidi
- B) Të vjellat nga estrogeniket
- C) Insuficienca kardiake nga beta-blokuesit
- D) Agranulocitoza nga anti-neoplaziket alkilante
- E) Ulcera gastrike nga salicilatet

PS)A

Pyetja 1138 V)1

Në lidhje me ndërveprimet host-parazit, flora mikrobike intestinale

- A) Ka një rol fiziologjik.
- B) Formohet nga parazitët.
- C) Formohet nga patogenët oportunistë.
- D) Është kercunuese për hostin.
- E) Favorizon mbivendosjen e patogenëve të jashtëm.

PS)A

Pyetja 1139 V)1

Prania e dhimbjes torakale retro-sternale, dispnesë, hemoptizisë, hypotensionit arterial dhe hipoksisë shkakton

- A) Pneumoninë lobare.
- B) IAM të komplikuar.
- C) Edemën pulmonare.
- D) Pneumotoraksin.
- E) Perikarditin.

PS)C

Pyetja 1140 V)1

Cili nga tumoret e mëposhtëm nuk bashkëshoqëron AIDSë

- A) Sarcoma e Kaposit
- B) Carcinoma e cervix-it uterin
- C) Carcinoma e gjirit
- D) Limfoma Jo-Hodgkiniane me malinjitet të shtuar
- E) Limfoma cerebrale

PS)C

Pyetja 1141 V)1

Tetraciklinat janë të efektshme për të gjitha infeksionet e mëposhtëm, përveç:

- A) Brucellozës.
- B) Kolerës.
- C) Candidosis.
- D) Rikēciosis.
- E) Amebiasis.

PS)C

Pyetja 1142 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm konsiderohet si faktor risku i rëndësishëm për karcinomën skuamoze të ezofagutë

- A) Ekspozim i shtuar i mukozës ezofageale ndaj acidit.
- B) Refluksi gastro-ezofageal.
- C) Obeziteti.
- D) Alkooli.
- E) Kandidoza ezofageale.

PS)D

Pyetja 1143 V)1

Simptomat dhe shenjat klasike të kolangitit akut janë:

- A) Të vjella biliare, dhimbje në hypokondrin e djathtë, ikter
- B) Ethe, të vjella biliare, leukocitoze neutrofilike
- C) Dhimbje në hypokondrin e djathtë, melena, ethe
- D) Dhimbje në hypokondrin e djathtë, ikter, ethe
- E) Leukocitoze neutrofilike, melena, të vjella ushqimore

PS)D

Pyetja 1144 V)1

Cila nga alterimet EKG-ive të mëposhtme nuk është e pranishme në perikarditin akutë

- A) Supranivelin e segmentit S-T
- B) Prania e valëve Q në derivacionet prekordiale
- C) Inversionin e valës T në derivacionet prekordiale
- D) Kompleksi QRS me voltazh të ulur
- E) Aritmi atriale

PS)B

Pyetja 1145 V)1

Markuesi më specifik i diagnozës bio-humorale'enzimatike' të infarktut akut të miokardit përfaqësohet nga:

- A) LDH-ëja.
- B) GOT-i
- C) Mioglobina
- D) Troponina
- E) Kolinesteraza

PS)D

Pyetja 1146 V)2

Një grua e re dëshiron të shkojë në Afrikën Qendrore për turizëm. Profilaksia me meflokinë për malarjen:

- A) Nuk duhet të kryhet sepse efektshmëria e saj është e debatueshëm.
- B) Do të bëhet vetëm nëse do të shkojë në vendet ku P. Vivax është endemik.
- C) Duhet të behet duke u nisur nga një ditë para nisjes drejt zonës endemike dhe do të perfundojë një javë para rikthimit në atdhe.
- D) Duhet të realizohet duke u nisur një javë para nisjes, gjatë gjithë qëndrimit dhe të vazhdojë deri 4 javë pas rikthimit.
- E) Nuk duhet të realizohet nëse pacientja është shtatzënë, sepse është vërtetuar se risku i pickimit të mushkonjës Anopheles është tepër i ulët tek gratë shtatzëna.

PS)D

Pyetja 1147 V)1

Cili është vendi kryesor i degradimit të insulinës?

- A) Veshka
- B) Hepar
- C) Pulmoni
- D) Indri muskular
- E) Indri dhjamo

PS)B

Pyetja 1148 V)1

Divertikuli i Meckel është një anomali kongjenitale e:

- A) Ezofagut.
- B) Duodenit.
- C) Jejunumit.
- D) Ileumit.
- E) Rectumit.

PS)D

Pyetja 1149 V)1

Një rritje e Transferinemisë së pamaturuar vihet re:

- A) Në anemine hemolitike.
- B) Në hemokromatozën idiopatike.
- C) Në aneminë hipokromike hiposideremike.
- D) Në aneminë megaloblastike.
- E) Në aneminë aplazike.

PS)C

Pyetja 1150 V)2

Në rast të apendisitit akut, një eksplorim rektal dhe/ose vaginal i dhimbshëm, në përgjithësi shkakton:

- A) Piosalpingit.
- B) Fistule rekto-vaginale.
- C) Cistit adjacent.
- D) Peritonit endopelvik.
- E) Peritonit difuz.

PS)D

Pyetja 1151 V)2

Cili nga risqet maternale të mëposhtëm shtohet në shtatzënësinë gemelareë

- A) Infeksioni i rrugeve urinare
- B) Hipertensioni i induktuar nga shtatzënësia.
- C) Diabeti gestacional.
- D) Nivele të ulëta të alfa-feto proteinës serike tek nëna.
- E) Kandidoza vaginale

PS)B

Pyetja 1152 V)1

Cili është komplikacioni që pason një okluzion intestinal të sipërmë

- A) Infarkti i miokardit
- B) Nekroza tubulare
- C) Anemia severe
- D) Septicemia
- E) Dizekuilibri elektrolitik

PS)E

Pyetja 1153 V)1

Në cilën nga hemopatitë e mëposhtme është i pranishëm një shtim i HbA2 ?

- A) Hemofili
- B) Talasemia minore
- C) Purpura trombocitopenike idiopatike
- D) Limfoma Hodgkin
- E) Leucemia limfoide kronike

PS)B

Pyetja 1154 V)1

Mastocitet e subjekteve alergjike paraqesin në sipërfaqen qelizore:

- A) IgE specifike
- B) IgA specifike
- C) Antikorp anti-IgE
- D) IgG specifike
- E) IgA sekretore

PS)A

Pyetja 1155 V)1

Kimioterapia antitumorale ka një veprim:

- A) Lokal.
- B) Sistemik.
- C) Të dyja të mësipërmet (lokal dhe sistemik).
- D) Në bazë të seksit të pacientit.
- E) Në bazë të moshës së pacientit.

PS)B

Pyetja 1156 V)1

Fibrat nervore të mielinizuara të një nervi periferik përbëhen nga:

- A) Aksoni, astroцитet dhe membrane bazale.
- B) Aksoni, dendritet dhe membrane bazale.
- C) Aksoni, mbështjellja mielike dhe membrana bazale.
- D) Aksoni dhe oligodendrocitet.
- E) Neuroni, mbështjellja mielike dhe membrana bazale.

PS)C

Pyetja 1157 V)1

Hiperuricemia haset shpesh në:

- A) Leuceminë mieloide kronike nën trajtim citolitik.
- B) Mononukleoze infektive.
- C) Hemofili.
- D) Sindromën Gilbert.
- E) Aplazinë medulare.

PS)A

Pyetja 1158 V)1

Infeksioni nozokomial më i shpeshtë është:

- A) Infeksioni i plagës operatorie.
- B) Bakteremia e kateterit venoz.
- C) Infeksioni i rrugëve urinare.
- D) Pneumonia.
- E) Diarreja nga variante rezistente ndaj antibiotikeve të zakonshëm.

PS)C

Pyetja 1159 V)1

Embolia e arteries pulmonare pasohet nga:

- A) Pneumotoraksi.
- B) Atelektazia.
- C) Infarkti pulmonar.
- D) Sindromi i Asman-Redecker.
- E) Sindromi i Bernard-Horner.

PS)C

Pyetja 1160 V)2

Përse karcinoma pulmonare skuamoze quhet ndryshe 'kanceri-abces'ë

- A) Sepse shkakton një nekrozë likuidiene centrale
 - B) Sepse shkakton një nekrozë koagulative centrale
 - C) Sepse shkakton një nekrozë supurative në indet adjacente
 - D) Të gjitha tipet e neoplazive pulmonare përkufizohen në këtë mënyrë
 - E) Asnjë tip neoplazie pulmonare nuk përkufizohet në këtë mënyrë
- PS)A

Pyetja 1161 V)1

Mediatorët e para-formuar të mastociteve dhe bazofileve janë:

- A) Prostaglandina.
- B) TNF alfa.
- C) Histamina.
- D) Leukotrieni.
- E) IL-3.

PS)C

Pyetja 1162 V)2

Një vajzë 2-vjeçare ishte në gjendje të mirë deri para 10 orësh, kur fillon të paraqesë letargji, të vjella, të qara të përsëritura me ndërprerje , me retraksion të anësive të poshtme mbi abdomen. Në spital paraqet fece në ngjyre kafe. Diagnoza më e mun

- A) Stenozes pilorike.
- B) Apendisitit.
- C) Infeksionit të rrugëve urinare.
- D) Invaginacionit intestinal.
- E) Ulcerës duodenale.

PS)D

Pyetja 1163 V)1

Në Morbus Hodgkin, në përgjithësi janë të pranishme të gjitha shenjat klinike të mëposhtme, përveç :

- A) Rënies në peshë.
- B) Etheve.
- C) Pruritit.
- D) Djersitjes nokturne.
- E) Hipertensionit arterial.

PS)E

Pyetja 1164 V)1

Glukagoni sekretohet:

- A) Kur janë të ulëta nivelet e glukozës në gjak.
- B) Kur janë të larta nivelet e glukozës në gjak.
- C) Në vijim të një inflamacioni.
- D) Në vijim të një stimuli hormonal
- E) Pas një vakti ushqimor

PS)A

Pyetja 1165 V)1

Sideremia është e rritur në:

- A) Aklorhidrinë gastrike.
- B) Hypovitaminozën C.
- C) Hypovitaminozën B6.
- D) Aneminë hemolitike.
- E) Aneminë hipokromike.

PS)D

Pyetja 1166 V)1

Hipoventilimi si pasojë e depresionit të qendrës respiratore shfaqet me:

- A) Hypoksia nga hypokapnia.
- B) Hypoksia dhe hiperkapnia.
- C) PO₂ normal dhe hiperkapnia.
- D) Hypoksia dhe PO₂ normal.
- E) PO₂ normal dhe hypokapnia.

PS)B

Pyetja 1167 V)2

Cila nga patologjitë kronike të organeve mund të shkaktojë osteodistrofië

- A) Miokardioskleroza
- B) Hepatopatia kronike
- C) Insuficienca renale kronike
- D) Gastriti kronik
- E) Pankreatiti kronik

PS)C

Pyetja 1168 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm kufizon përdorimin diagnostik të radiografisë tradicionale në studimin e truritë

- A) Diferenca tepër e vogël e imbibimit të rrezatimit midis strukturave të ndryshme të parenkimës cerebrale
- B) Imbibim i njëjtë i rrezatimit nga ana e calvarias dhe trurit
- C) Prania e hapësirave likuorale
- D) Pamundësia e vizualizimit të kalcifikimeve.
- E) Ekzistenca e barrierës hemato-encefalike

PS)A

Pyetja 1169 V)1

Cili nga këto pohime është i gabuarë

- A) Oftalmopatia Basedowiene mund të paraprijë ose të pasojë disfunkcionin e tiroides.
- B) TSH-ëja është e ulët në morbus Graves.
- C) Normalizimi i funksionit të tiroides siguron regresionin e oftalmopatisë Basedowiene
- D) Në oftalmopatinë Basedowiene, fibroblastët prodhojnë acid hialuronik që çon në rritje të presionit osmotik indor.
- E) Femrat vuajnë nga oftalmopatia basedowiene më shpesh se meshkujt.

PS)C

Pyetja 1170 V)1

Çfarë nënkupton shenja e Bauer-itë

- A) Shfaqjen e venave pre-tibiale
- B) Shfaqjen e dhembjes në pulpën e këmbës nga dorsofleksioni pasiv i sforcuar i këmbës
- C) Shfaqjen e dhembjes në palpacionin e fortë të pulpës
- D) Mungesën e pulseve arteriale periferike
- E) Shfaqjen e dhembjes krampi-formë në pulpë gjatë ecjes

PS)C

Pyetja 1171 V)2

Cila nga simptomat e mëposhtme nuk haset në rastin e një gravidance tubarike (extra-uterine)ë

- A) Dhembje në kuadrantin abdominal inferior
- B) Humbje hematike vaginale ose spotting
- C) Amenorrhea
- D) Proktorragjia
- E) Dhembje në sup

PS)D

Pyetja 1172 V)1

Vëzhgimi i ngjarjeve që ndodhin 'ex novo', gjatë një periudhe kohe të caktuar, në një popullatë në të cilën nuk ishin shfaqur më parë nënkupton:

- A) Prevalencë.
- B) Frekuencë.
- C) Prevalencë periodike.
- D) Incidencë.
- E) Përqindje

PS)D

Pyetja 1173 V)1

Artikulationet më të prekura në artritin reumatoid janë:

- A) Radiokarpale dhe të dorës.
- B) Coxofemorale.
- C) Akromio-klavikulare.
- D) Temporo-mandibulare.
- E) Genu.

PS)A

Pyetja 1174 V)2

Cila është forma më e shpeshtë e pneumo-mediastinitë

- A) Idiopatike
- B) Spontanisht-patologjike
- C) Esenciale
- D) Traumatike
- E) Iatrogene

PS)D

Pyetja 1175 V)1

Anoreksia nervosa paraqet shpesh:

- A) Alopecia.
- B) Amenorrhea.
- C) Sprue celiaki.
- D) ërregullime të gjumit.
- E) Cefale.

PS)B

Pyetja 1176 V)1

Diagnoza e infarktut të miokardit konfirmohet kryesisht me:

- A) Matjen e TA-së.
- B) EKG-në dhe dozimin e CPK-ës dhe troponinës I.
- C) Ekokardiogramën bi-direksionale.
- D) Radiografi toraksi.
- E) Matjen e presionit venoz qendror.

PS)B

Pyetja 1177 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm është i gabuar?

- A) Viruset janë agjentë të fuqishëm piogenikë.
- B) Bakteret patogjenë që penetrojnë në organizëm shpesh provokojnë infeksione të rënda.
- C) Disa baktere mund të jenë 'gëlltitur' nga fagocitet por jo 'tretur/shpërbërë'.
- D) Sasia, zgjatja e ekspozimit dhe patogeniciteti i një agjenti modifikon pergjigjen imune.
- E) Bakteret e fagocituara para se të shpërbëhen duhet të vriten.

PS)A

Pyetja 1178 V)1

Shërimi biologjik i një frakturë karakterizohet nga:

- A) Reduktimi anatomik i fragmenteve.
- B) Rikthimi i shpejtë funksional.
- C) Formimi i kallusit kockor.
- D) Mungesa e komplikacioneve të hershme ose tardive.
- E) Nevoja e një traksioni skeletik.

PS)C

Pyetja 1179 V)2

Struktura kimike e beta-endorfinës është:

- A) Aminoacidike.
- B) Glikoproteinike.
- C) Polipeptidike.
- D) Steroidiene.
- E) Lipoproteinike.

PS)C

Pyetja 1180 V)1

Astma tek një fëmijë 6-vjeçar mund të lidhet me të gjitha alternativat e mëposhtme, përveç:

- A) Anamnezës familjare për atopi.
- B) Alergjisë nga agjentët inhalatorë.
- C) Alergjisë ushqimore.
- D) Infeksioneve virale.
- E) Deficitit e IgA -asë.

PS)E

Pyetja 1181 V)1

Tek mashkulli, hiperprolaktinemia mund të indukojë:

- A) Infertilitet sekretor+impotencë ereksioni.
- B) Infertilitet sekretor.
- C) Infertilitet ekskretor.
- D) Impotence ereksioni.
- E) Hirsutizem.

PS)A

Pyetja 1182 V)1

Në bllokun e degës, vonesa e konduksionit është në nivel:

- A) Të nyjes atrio-ventrikulare.
- B) Të njerës nga degët e tufës së His-it.
- C) Të sinusit atrial.
- D) Interatrial.
- E) Të fillimit të tufës së His-it.

PS)B

Pyetja 1183 V)1

Aldosteroni:

- A) Prodohet në medulën renale.
- B) Prodohet në korteksin renal.
- C) Hipersekretimi i tij shkakton sindromën Cushing.
- D) Rrit ri-absorbimin tubular të Na-së.
- E) Rrit ri-absorbimin tubular të K-së.

PS)D

Pyetja 1184 V)2

Cili është gjeni onko-supresor që akuzohet shpesh në gjenezën e tumoreve pulmonare?

- A) P47
- B) P53
- C) RAS
- D) Myc
- E) Fos

PS)B

Pyetja 1185 V)1

Skleroza multiple quhet ndryshe edhe:

- A) Sklerodermi.
- B) Sklerozë sistemike.
- C) Sklerozë sistemike progresive.
- D) Sklerozë me pllaka.
- E) Arteriosklerozë polifokale

PS)D

Pyetja 1186 V)1

Cila nga neoplazitë e mëposhtme shkaktohet me siguri nga H. Pylori?

- A) Adenocarcinoma e ezofagut.
- B) Adenocarcinoma e stomakut.
- C) Limfoma gastrike primitive MALT.
- D) Leiomyosarkoma e stomakut.
- E) Fibrosarkoma e stomakut.

PS)C

Pyetja 1187 V)1

Në një ind me inflamacion akut, në mënyrë karakteristike hasim një numër të madh:

- A) Të qelizave plazmatike.
- B) Të polimorfonukleareve neutrofile .
- C) Të eritrociteve.
- D) Të qelizave gjigande.
- E) Të limfociteve.

PS)B

Pyetja 1188 V)3

Në cilin tip patologjie indikohet interveni i gastro(fundo)plication sipas Nissen?

- A) Refluksin veziko-ureteral
- B) Stenoza hipertrofike të Pilorit.
- C) Refluksi gastro-ezofageal
- D) Ulcera peptike
- E) Megaezofag

PS)C

Pyetja 1189 V)1

Cila nga molekulat e mëposhtme mund të kalojë membranën përmes difuzionit të thjeshtë:

- A) Molekula e oksigjenit.
- B) Molekula proteinike jonike.
- C) Molekula e ujit.
- D) Joni i kaliumit.
- E) Acidi yndyror.

PS)A

Pyetja 1190 V)1

Hiperventilimi nënkupton:

- A) Acidozë respiratore.
- B) Alkalozë respiratore.
- C) Hiperkapni.
- D) Hiperoksijenim.
- E) Hipotension arterial.

PS)B

Pyetja 1191 V)1

Një burrë 50-vjeçar, ndërkohë që shihte televizor, tregon për dhimbje retrosternale me irradim në krahun e majtë. Simptomatologjia regredon spontanisht në harkun e një gjysmë ore dhe rishfaqet me vonë në gjumin e natës. Çfarë diagnoze provizore do të bë

- A) Infarkti subendokardial i sigurtë
- B) Angina e efortit
- C) Sindromi koronarien akut
- D) Arteriti Kawasaki
- E) Angina stabile

PS)C

Pyetja 1192 V)1

Me cilën mënyrë trashëgimie transmetohet distrofia muskulare e Duchenneë

- A) Recessive e lidhur me kromozomin X
- B) Autosomale recessive
- C) Multifaktoriale
- D) Dominante e lidhur me kromozomin X
- E) Autozomale dominante

PS)A

Pyetja 1193 V)1

Manovra e Giordano-s konsiston në:

- A) Palpacionin e llozhave renale nen harkun kostal ekstern të muskulit quadratum.
- B) Perkusioni i llozhave renale mbi harkun kostal extern te muskulit quadratum.
- C) Perkusionin e llozhave renale mbi harkun kostal në nivel të fiankeve.
- D) Kompresionin e llozhave renale mbi harkun kostal të fiankeve.
- E) Perkusionin e llozhave renale në nivel të brinjëve të fundit në paravertebral.

PS)B

Pyetja 1194 V)1

Divertikuliti i Meckel-it mund të shkaktohet nga abdomeni akut:

- A) Vetëm tek adultët.
- B) E vërtetë.
- C) E vërtetë, por vetëm nëse shoqërohet me apendisit akut.
- D) Nuk është e vërtetë.
- E) Vetëm tek një pacient që i është nënshtruar më pare laparotomisë eksplorative.

PS)B

Pyetja 1195 V)1

Tek adulti i shëndoshë feritinemia është:

- A) Në përpjestim të zhdrejtë me sasinë e depozituar të hekurit.
- B) Në proporcion të drejtë me volumin total eritrocitar.
- C) Në proporcion të drejtë me sasinë e depozituar të hekurit.
- D) Në proporcion të drejtë me transferineminë.
- E) Në proporcion të zhdrejtë me sidereminë.

PS)C

Pyetja 1196 V)1

Secila nga procedurat e mëposhtme është e vlefshme në dallimin e leucemisë akute nga leucemia limfoide akute, përveç:

- A) Ngjyrimin cito-kimik për mieloperoksidazën.
- B) Ngjyrimin citokimik për acidin periodik të Schiff (PAS).
- C) Studimit të terminal deoksinukleotidik transferazës (TdT)
- D) Studimit të ri-organizimit të imunoglobulinave dhe gjenit për receptorin e qelizave T.
- E) Dozimit të niveleve serike të vit B12.

PS)E

Pyetja 1197 V)2

Cili prej hormoneve të mëposhtëm nuk shpjegon veprimin e vertetë integruar me receptorët nuklearë?

- A) Testosteroni
- B) Aldosteroni
- C) Estradioli
- D) Glukagoni
- E) Kortizoli

PS)D

Pyetja 1198 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm rreth vështirësisë diagnostike tek një pacient me ethe është i gabuar?

- A) Disa mikro-organizma izolohehen dhe kultivohen me vështirësi.
- B) Është i nevojshëm një laborator serologjik shumë i specializuar për të përcaktuar diagnozën.
- C) Radiologjia e toraksit nuk sjell asnjë informacion për ekzaminimin objektiv.
- D) Pacienti mund të mbajë të fshehur të dhëna anamnestike shumë të rëndësishme.
- E) Disa terapi të mëparshme ose konkomitante mund të jenë ngatërruese .

PS)C

Pyetja 1199 V)1

Cili nga medikamentet përdoret në trajtimin e infeksioneve sistemike nga funget ?

- A) Ciproflaksacina
- B) Amfotericina B
- C) Penicilina
- D) Amiodaroni
- E) Streptomicina

PS)B

Pyetja 1200 V)1

Mastiti akut më shpesh vërtetohet gjatë:

- A) Ciklit menstrual normal
- B) Pubertetit
- C) Laktacionit
- D) Shtatzënisë.
- E) Menopauzës.

PS)C

Pyetja 1201 V)1

Në hiperparatiroidizëm, përqindja plazmatike e kalciumit dhe fosforit modifikohet. Cila nga këto rrethana është e vërtetë?

- A) Hyperkalcemi, hyperfosforemi
- B) Hyperkalcemi, hypofosforemi
- C) Hypokalcemi, hypofosforemi
- D) Hypokalcemi, hyperfosforemi
- E) Normokalcemi, normofosforemi

PS)B

Pyetja 1202 V)1

Të gjithë medikamentet e mëposhtëm mund të përdoren në trajtimin e statutit astmatik, përveç:

- A) Salbutamolit.
- B) Oksigjenit.
- C) Kortikosteroirdit.
- D) Aminofilinës.
- E) Fenobarbitalit

PS)E

Pyetja 1203 V)1

Punksion-biopsia pulmonare është e vlershme për diagnozën e:

- A) Bronkoektazisë.
- B) Emfizemës.
- C) Tbc miliar.
- D) Kancerit bronkogen.
- E) Fistulës arteriovenoze.

PS)D

Pyetja 1204 V)2

Sindroma e Plummer-Vinson konsiston në:

- A) Purpura trombocitopenike, diarre, ataksi.
- B) Divertikul ezofageal me ulcera peptike.
- C) Piroze retrosternale dhe regurgitim acidik.
- D) Anemi, disfagi, glosit.
- E) Sindromë gastro-ezofageale.

PS)D

Pyetja 1205 V)1

Faktori kryesor i riskut për nekrozën avaskulare të 'caput femuri' është:

- A) Diabeti.
- B) Podagra.
- C) Terapia kortikoide.
- D) Hiperparatiroidizimi.
- E) Hipotiroidizmi.

PS)C

Pyetja 1206 V)1

Shkaku i hipertensionit sekondar sistolo-diastolik është:

- A) Hemorragjia.
- B) Miokarditi.
- C) Glomerulonefriti akut.
- D) Tuberkulozi.
- E) IAM.

PS)C

Pyetja 1207 V)2

Cila nga etiologjitë e mëposhtme të meningitit kërkon fillimin e një antibio-profilaksie me të afërmit e pacientit?

- A) *Listeria monocitogenes*
- B) *Streptococcus pneumonie*
- C) *Neisseria meningitis*
- D) *Mycobacterium tuberculosis*
- E) *Escheria Coli*

PS)C

Pyetja 1208 V)2

Terapia antikoagulante me warfarine mund të shoqërohet me nekroza kutane tek pacientët e prekur nga nje nga patologjia e:

- A) Deficitit të antitrombines III.
- B) Deficitit të proteines C.
- C) Deficitit të faktorit VIII.
- D) Deficitit të plasminogenit.
- E) Disfibrinogenemisë.

PS)B

Pyetja 1209 V)1

Tek pacientët e prekur nga kontuzioni kardiak nuk duhet të administrohen:

- A) Medikamente antiaritmike.
- B) Medikamente anksiolitike.
- C) Medikamente antikoagulante.
- D) Medikamente anlagjezike.
- E) Medikamente antibiotike

PS)C

Pyetja 1210 V)1

Cila nga këto qeliza nuk bën pjesë tek lëkura?

- A) Melanociti
- B) Celulat e Langerhansit
- C) Celulat e Meckel
- D) Fibroblastet
- E) Celulat e Clara-s

PS)E

Pyetja 1211 V)1

Gishtat e Hipokratit konsistojnë:

- A) Në sklerodaktilinë.
- B) Në ngjyrën cianotike të shprehur.
- C) Në rritjen e falangës së fundit me thonjtë si xhama sahati.
- D) Në shfaqjen e noduseve tendinoze të dhimbshëm në falangje.
- E) Në rënien e thonjëve.

PS)C

Pyetja 1212 V)1

Në cilën nga koagulopatitë e mëposhtme hasen në një frekuencë të shtuar hemartrozat e artikulacione të mëdha?

- A) Trombocitemia idiopatike
- B) Deficiti i protrombinës
- C) Koagulimi intravaskular i diseminuar
- D) Hemofilia A, B
- E) Hiperfibrinolize

PS)D

Pyetja 1213 V)1

Në vlerësimin e patologjisë infektive pulmonare, të tipit të bronkopneumonisë, cilat teknika diagnostike imazherike rezultojnë më të përshtatshmet?

- A) Studimi radiografik konvencional i pasuar nga CT skaner
- B) Ekografia standarte e ndjekur nga echokolor-Doppler
- C) Angiografia selektive e arteries pulmonare e pasuar nga CT skaner
- D) Rezonanca magnetike e pasuar nga angiografia pulmonare
- E) CT skaner me rikonstruksion 3D

PS)A

Pyetja 1214 V)1

Pacienti me IRK (insuficiencë renale kronike) Do të pohojë nikturia, ose ndryshe:

- A) Diarre të ujshme.
- B) Djersitje profuze.
- C) Diurezë edhe nokturne.
- D) Lemzë të pakontrollueshme.
- E) Rhinitis alergjik.

PS)C

Pyetja 1215 V)2

Patogjeneza e hipernatremisë gjatë ushqyerjes parenterale lidhet me:

- A) Shtimin e riabsorbimit proksimal të natriumit.
- B) Diurezën osmotike.
- C) Sekretimin e reduktuar të hormonit anti-diuretik.
- D) Sekretimin e shtuar të hormonit aldosteron.
- E) Shtimin e filtracionit glomerular.

PS)B

Pyetja 1216 V)1

Nje grua është diagnostikuar me adenokarcinomë të lokalizuar në kokën e pankreasit. Cilat struktura anatomike mund te jene dëmtuar?

- A) Arteria mezenterike inferiore
- B) Lien
- C) Koledoku
- D) Arteria lienale
- E) Veshka e majtë

PS)C

Pyetja 1217 V)1

Çfarë nënkupton kapaciteti funksional rezidual pulmonar?

- A) Volumin aktual (plus) +volumin rezidual
- B) Volumin e rezervës ekspiratore(plus) +volumin rezidual
- C) Kapacitetin vital (plus) +volumin rezidual
- D) Kapacitetin inspirator (plus) +volumin rezidual
- E) Volumin e rezervës inspiratore (plus)+volumin rezidual

PS)B

Pyetja 1218 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm nuk është i vërtetë mbi sëmundjen Alzheimerit ?

- A) Gjetjet patologjike përfshijnë lëmshtet neurofibrilare dhe degjimin neuronal.
- B) Pjesa më e madhe e rasteve janë familjare.
- C) Aktiviteti kortikal cerebral i kolin-acetiltransferazës është i reduktuar.
- D) Simptomat fillestare shpesh simulojnë depresionin.
- E) Nuk ka ekzaminime specifike laboratorike patologjike.

PS)B

Pyetja 1219 V)1

Cili nga ekzaminimet e mëposhtëm është diagnostik për të diferencuar një trombocitopeni nga mielo-inhibimi nga një trombocitopeni nga shkatërrimi periferik i trombociteve?

- B) Aneurisma disekante e aortës.
- C) Ruptura ose fisurimi i aneurizmës së aortës abdominale.
- D) Sindromi Leriche.
- E) Aneurizma e arteries hepatike.

PS)C

Pyetja 1396 V)2

Me 'adrenarche' nënkuptojmë:

- A) Shfaqjen e hirsutizmit përpara menarkeve.
- B) Shfaqjen e pelurisë pubike afërsisht 2 vjet përpara pubertetit e bashkëshoqeruar me rritje të nivelit serik të DHEA-së.
- C) Shfaqjen e hirsutizmit me origjinë surenaliene tek femra.
- D) Praninë në fëmijëri të një tumori surenal që prodhon DEA-S.
- E) Shfaqjen e cikleve menstruale tek pacientët me sindromin adreno-genital.

PS)B

Pyetja 1397 V)2

Cila triade identifikon sëmundjen e Huntington-it?

- A) Lëvizje të pavullnetshme-dementia-asinergji
- B) Katarakt-demencë-asinergji
- C) Ataksi-demencë-asinergji
- D) Lëvizje koreike-katarakt-akromegali
- E) Epilepsi-lëvizje të pavullnetshme-kardiopati

PS)A

Pyetja 1398 V)1

Medikamentet e mëposhtëm përdoren në insuficiencën kardiake kronike, përveç:

- A) Digoksinës.
- B) ACE-inhibitorët.
- C) Diuretikët e ansës.
- D) Diuretikët kali-protetore.
- E) Cimetidinës.

PS)E

Pyetja 1399 V)2

Në cilën nga rrethanat e mëposhtme mund të vërehet 'turgori jugular'?

- A) Hipertensioni arterial
- B) Obstruksioni i vena cava superior
- C) Obstruksioni i vena cava inferior
- D) Stenoze aorte
- E) Struma multinodulare

PS)B

Pyetja 1400 V)3

Cili organ midis të poshtë shënuarve përfshihet shpesh në dekursin e panarteritit nodoz?

- A) Kocka
- B) Kartilago
- C) Veshi
- D) Veshka
- E) Uretra

PS)D

Pyetja 1401 V)3

Me çfarë mund të bashkëshoqërohet fenomeni RAYNAUD?

- A) Tromboflebit
- B) Eritermalgji
- C) Sklerodermi
- D) Limfadenitis
- E) Dermatitis

PS)C

Pyetja 1402 V)2

Psoriasis i lëkurës me flokë indukon:

- A) Një alopeci tranzitore.
- B) Një alopeci definitive.
- C) Një alopeci vetëm të vertex-it dhe të regjioneve frontale.
- D) Nuk indukon alopeci.
- E) Zbardhjen e flokut.

PS)D

Pyetja 1403 V)1

Cili është shkaku më i shpeshtë i sterilitetit femëror?

- A) Hormonal (mungesë ovulacioni)
- B) Tubarik
- C) Uterin
- D) Kongenital
- E) Vaginal

PS)A

Pyetja 1404 V)1

Nje vlerë e Kaliumit 7mEq/L

- A) Është normale
- B) Është një vlerë e rritur e shkaktuar nga diarreja dhe të vjellat.
- C) Është e reduktuar.
- D) Është teresisht jashtë vlerave.
- E) Është një vlerë e rritur që mund të provokojë iritabilitet muskular.

PS)E

Pyetja 1405 V)2

Cili nga këta trajtime do të duhej të përdorej në rutinë për trajtimin e pre-eklampsisë?

- A) Diuretikët
- B) Kufizimi i kripës
- C) Propranololi
- D) Sulfati i magneziumit
- E) Deambulacioni (qëndrimi në kembë)

PS)D

Pyetja 1406 V)1

Cili nga diuretikët e mëposhtëm është një antagonist i aldosteronit

- A) Furosemidi
- B) Spironolaktoni
- C) Acetazolamidi
- D) Manitoli
- E) Hidroklortiazidi

PS)B

Pyetja 1407 V)3

Cili nga tumoret testikularë të mëposhtëm ka prognozë më të keqe?

- A) Seminoma anaplazike
- B) Karcinoma embrionale infantile
- C) Teratoma
- D) Koriokarcinoma
- E) Poliembrioma

PS)D

Pyetja 1408 V)2

Përqendrimet plazmatike të C3, C4 janë gjithnjë të reduktuara në fazën e aktivizimit të cilës nga sëmundjet e mëposhtme?

- A) Lupus eritematoz sistemik (i diseminuar)
- B) Miastenia gravis
- C) Astma
- D) Sarkoidoze
- E) Sëmundja e Alzheimer-it

PS)A

Pyetja 1409 V)1

Cila nga këto enzima dëshmon për një dëmtim hepatocelular?

- A) Aminotransferazat (ALT e AST)
- B) Fosfataza acide (ACP)
- C) Kreatin fosfokinaza (CPK)
- D) Glukozë 6 fosfat dehidrogjenaza (G6PD)
- E) Enolazë neuron specifike (NSE)

PS)A

Pyetja 1410 V)1

Diagnoza citologjike e kancerit bronkogen tek një pacient me ekzaminim ekspektorant dhe bronkoskopi negative mund të perftohet nga:

- A) Aspirimi me age.
- B) CT skaner.
- C) Stratografia.
- D) Shintigrafia.
- E) Bronkografia.

PS)A

Pyetja 1411 V)1

Kur niveli i glukozës në gjak është i ulur, në mëlçi aktivizohet:

- A) Sintetza e acideve yndyrore.
- B) Glikoliza.
- C) Fosforilimi oksidativ.
- D) Cikli i Krebs-it.
- E) Glukoneogjeneza.

PS)E

Pyetja 1412 V)1

Diabeti mellitus i tipit I karakterizohet nga të gjitha gjendjet shëndetësore të mëposhtme, përveç

- A) Poliurisë.
- B) Polifagisë.
- C) Shtimit në peshë.
- D) Polidipsisë.
- E) Dhembjes abdominale.

PS)C

Pyetja 1413 V)1

Aneuploidia është:

- A) Një alterim i numrit të kromozomeve.
- B) Një defekt i shikimit.
- C) Një alterim i strukturës së kromozomeve.
- D) Prania e delecioneve të kromozomeve.
- E) Një metafaze anormale.

PS)A

Pyetja 1414 V)1

Faktorët reumatoide janë:

- A) Imunoglobulinat (Ig) specifike për fragmentin Fc të IgG-ve.
- B) Faktorët serikë të pranishëm në reumatizmin artikular akut.
- C) Antikorp të anti-membrane sinoviale.
- D) Të pranishëm në menyrë tipike në podagër.
- E) Pozitive tek pacientët me osteoartrozë.

PS)A

Pyetja 1415 V)1

Mediatorët përgjegjës për bronkospazmën në astmë nuk përfshijnë:

- A) Leukotrienët.
- B) Acetilkolinën.
- C) Histaminën.
- D) Prostaglandinën D2.
- E) TGF-beta.

PS)E

Pyetja 1416 V)1

Kur një proteinuri e 24-orëve do të quhet nefrotike?

- A) Proteinuria>3g
- B) Proteinuria>2g
- C) Proteinuria>1g
- D) Proteinuria> ose e = 5g
- E) Proteinuria> ose e = 8g

PS)A

Pyetja 1417 V)2

Shfaqja e atakut të podagrës akute artikulare i detyrohet:

- A) Një reduktimi të papritur të vlerave të uricemisë.
- B) Fagocitozës, nga ana e neutrofilëve të likidit sinovial të kristaleve të urateve të natriumit.
- C) Theksimit të një uricemie të shtuar dhe ngulmuese.
- D) Pranisë së një metaboliti të veçantë të acidit urik me likidin sinovial.
- E) Pranisë së tofeve (depozitimeve të forta të dhembshëm të kristaleve të acidit urik)

PS)B

Pyetja 1418 V)1

Heparina vepron:

- A) Si një antikoagulant kryesisht duke bllokuar protrombinën.
- B) Si antikoagulant falë ndërveprimit me antitrombinën e inhibimit të faktorit X dhe trombinës.
- C) Si antikoagulant kryesisht duke inhibuar fibrinogenin.
- D) Si antikoagulant kryesisht duke inhibuar fibrinën.
- E) Duke bllokuar antitrombinën.

PS)B

Pyetja 1419 V)2

Cila nga këto citokina është faktori rritës më i rëndësishëm për eozinofilët?

- A) IFN
- B) IL4
- C) IL2
- D) IL1
- E) IL5

PS)E

Pyetja 1420 V)2

Cili është komplikacioni i menjëhershëm dhe më i shpeshtë në luksacionin posterior të kofshës?

- A) Nekroza avaskulare e caput femuri
- B) Tromboza e vena profunde të anesive inferiore
- C) Coxartroza

- D) Ishemia e anësise inferiore
 - E) Paraliza e nervit shiatik
- PS)E

Pyetja 1421 V)1

Teknika për vlerësimin statistikor të rezultateve komplekse të disa studimeve epidemiologjike që evidentojnë një faktor risku të një sëmundjeje është

- A) Standartizimi i vlerave.
 - B) Regresioni i shumëfishtë.
 - C) Evidencë based medecine.
 - D) Llogaritja e vlerave specifike.
 - E) Meta-analiza.
- PS)E

Pyetja 1422 V)2

Të gjitha gjendjet e mëposhtme bashkëshoqërohen me sindromin Pickwick, përveç:

- A) Obezitetit
 - B) Somnolencës.
 - C) Oreksit të shtuar.
 - D) Anemisë.
 - E) Policitemisë.
- PS)D

Pyetja 1423 V)1

Mosha e shfaqjes së një skizofrenie hebefrenetike në përgjithësi është:

- A) Midis 6-10 vjeç.
 - B) Midis 30-40 vjeç.
 - C) Midis 16-20 vjeç.
 - D) Para 4 vjeç.
 - E) Pas 70 vjeç.
- PS)C

Pyetja 1424 V)1

Cili nga parametrat e mëposhtëm ka rëndësi të pakët në studimin e mirëqenies në ambientet e banimit?

- A) Temperatura
 - B) Lagështia
 - C) Presioni
 - D) Nxehësia rrezatuese
 - E) Lëvizja e ajrit
- PS)C

Pyetja 1425 V)3

Cili është tipari karakteristik citodiagnostik i pemfigus-it?

- A) Granulocitet neutrofile
 - B) Granulocitet bazofile
 - C) Granulocitet eozinofile
 - D) Qelizat akantolitike
 - E) Qelizat balloniforme
- PS)D

Pyetja 1426 V)1

Nga matja e volumit të O₂-së të konsumuar dhe të CO₂-së të ekspiruar ne mund të llogarisim:

- A) Volumin e vdekur respiratore.
- B) Presionin parcial të CO₂-së.
- C) Metabolizmin energjetik bazal.
- D) Presionin parcial të O₂-së.
- E) Koeficientin respirator.

PS)E

Pyetja 1427 V)1

Ndërprerja e vullnetshme e shtatzënisë brenda 90 ditëve të para është e lejuar ne rastin e:

- A) Patologjisë së nënës.
- B) Malformacioneve fetale.
- C) Motivacioneve ekonomike.
- D) Kërkesën e babait
- E) A+B+C

PS)E

Pyetja 1428 V)1

Cili është agjenti etiologjik i zgjebes?

- A) Stafilokoku aureus
- B) Streptokoku piogen
- C) Ascaris lumbricoides
- D) Treponema pallidum
- E) Sarcoptes scabiei

PS)E

Pyetja 1429 V)1

Faktori reumatoid përbëhet nga një imunoglobuline

- A) IgG anti-IgA
- B) IgE anti-IgM
- C) IgA anti-IgE
- D) IgD anti-IgG
- E) IgM anti-IgG

PS)E

Pyetja 1430 V)2

Në acidozën respiratore të kompensuar, cili nga këta parametra përkon gjithnjë me vlerat normale?

- A) PaO₂
- B) PaCO₂
- C) PH
- D) SatO₂
- E) HCO₃⁻

PS)C

Pyetja 1431 V)1

Agjenti etiologjik i hepatitit C është një:

- A) RNA virus.
- B) DNA virus.
- C) Bakter.

- D) Protozoar.
 - E) Helminth.
- PS)A

Pyetja 1432 V)3

Cili nga këta agjentë kolonizon veçanërisht lezionet bronko-ektazike?

- A) Aspergillus terrum
 - B) Citomegalovirus
 - C) Pseudomona aeruginosa
 - D) Mykoplazma pneumonie
 - E) Micobakterium tuberculosis
- PS)C

Pyetja 1433 V)1

Cilat anastomoza aktivizohen në rast të obstrukcionit të vena porta ?

- A) Midis venës mesenterike inferior dhe venave rektale superiore
 - B) Midis venës splenike dhe venës gastro-epiploike sinistrale
 - C) Midis venës gastrike sinistrale dhe venës ezofageale
 - D) Midis venave paraumbelike dhe venave epiploike
 - E) Midis venës cava superior dhe venave lumbare ascendente
- PS)C

Pyetja 1434 V)1

Në cilën sëmundje është e pranishme hiperkaliemia?

- A) Morbus Addison
 - B) Diabet mellitus
 - C) Sindromen Gilbert
 - D) Cirrhose hepatike
 - E) Tireotoksikozë
- PS)A

Pyetja 1435 V)1

Psikodrama terapeutike:

- A) Konsiston në recitimin e një grupi pacientësh të roleve të ndryshme nga jeta e tyre dhe me problematikat e tyre.
 - B) Është një vepër teatrale me përmbajtje të thellë psikologjike që shfaqet me qëllim terapeutik.
 - C) Konsiston në recitimin e pacientëve të teksteve teatrale klasike emotive të rëndësishëm.
 - D) Konsiston në ndihmën ndaj pacientëve për recitimin e teksteve teatrale klasike emotive të rëndësishëm.
 - E) Është një term që tregon një formë të veçantë të psikoterapisë së shkurtër.
- PS)A

Pyetja 1436 V)2

Lazer-i në terapinë e retinopatisë diabetike përdoret sepse

- A) Shkatërron neovazat (vazat e sapoformuara) .
 - B) Rrit vaskularizimin .
 - C) Pengon formimin e mikroaneurizmave.
 - D) Është në pakësimin e dilatacioneve venoze.
 - E) Rrit grenazhin limfatik.
- PS)A

Pyetja 1437 V)1

Vlera anormale në formulën leukocitare të mëposhtme është

- A) Granulocitet neutrofilike: 57%.
- B) Granulocitet eozinofilike: 15%.
- C) Granulocitet bazofilike: 0.5%.
- D) Monocitet: 5.5%.
- E) Limfocitet: 22%.

PS)B

Pyetja 1438 V)1

Cili nga medikamentet e mëposhtëm antihipertensive mund të shkaktojë kollë?

- A) Antagonistët alfa-1 adrenergjikët
- B) Sartanët
- C) ACE-inhibitorët
- D) Kalci-blokuesit
- E) Nitratet

PS)C

Pyetja 1439 V)1

Një krizë epileptike parciale motore e djathtë mund të shkaktohet nga një vatër epileptike e lokalizuar në:

- A) Lobin frontal të djathtë.
- B) Lobin parietal të majtë.
- C) Lobin okcipital të majtë.
- D) Talamusin e djathtë.
- E) Zonën rolandike të majtë.

PS)E

Pyetja 1440 V)3

Përballë cilës rrethanë do të perjashtonit me një probabilitet të lartë, diagnozën e lupus-it ?

- A) Mungesa e rash-it
- B) Teste normale të funksionit renal
- C) Mungesa e antikorpeve anti-nukleare
- D) Prania e faktorit reumatoid
- E) Reperti ekografik i hipertensionit pulmonar

PS)C

Pyetja 1441 V)1

Arteria dorsalis pedis mund të vlerësohet:

- A) Në dorsum pedis midis metatarsit të I e II.
- B) Në nivel retromalleolar të brendshëm.
- C) Në nivel retromalleolar të jashtëm.
- D) Në nivel pre-malleolar.
- E) Në dorsum pedis midis metatarsit të IV dhe V.

PS)A

Pyetja 1442 V)1

Ngjyra e verdhë e lëkurës në mungesë të ngjyrës së verdhë të sklerave është për shkak të sasisë së tepërt në:

- A) Melaninë.
- B) Bilirubinën.
- C) Karoten.

- D) Hemoglobinë e glukozuar.
 - E) Hemoglobinë e sulfuruar.
- PS)C

Pyetja 1443 V)1

Në ulcerën duodenale, terapia më e mirë është:

- A) Kirurgjia.
 - B) Dieta.
 - C) Me medikamente frenues të pompës.
 - D) Vagotomia.
 - E) Me sukralfat për os.
- PS)C

Pyetja 1444 V)1

Cili është agjenti etiologjik klasik i erizipelës?

- A) Stafilokokus aureus
 - B) Stafilokokus epidermidis
 - C) Streptokokus pyogenes
 - D) Korinebakterium minutissimum
 - E) Bartonella toruidea
- PS)C

Pyetja 1445 V)1

Manifestimet klinike të Miastenia Gravis janë për shkak të:

- A) Turbullimeve të përçimit elektrik përgjatë nervit motor.
 - B) Alterimit në nivel të sinapsit neuromuskular.
 - C) Neoplazive cerebrale.
 - D) Alterimeve të qelizave të cornu anterior.
 - E) Turbullimeve funksionale në nivel mezencefalik.
- PS)B

Pyetja 1446 V)2

Infeksioni kronik nga virusi i hepatitit C bashkëshoqërohet me cilën nga këta manifestime?

- A) Purpura krioglobulinemike
 - B) Sëmundje e Churg-Strauss
 - C) Leucemi me qeliza capullute
 - D) Panarterit nodoz
 - E) Polimialgji reumatike
- PS)A

Pyetja 1447 V)3

Cila nga manifestimet e mëposhtëm nuk bën pjesë në kuadrin klinik të etes mesdhetare familjare?

- A) Ethe
 - B) Dhimbje abdominale
 - C) Pleuriti
 - D) Ikteri
 - E) Artralgjia
- PS)D

Pyetja 1448 V)2

Cilët janë shkaqet me të zakonshëm të deficitit të ereksionit me natyrë organike?

- A) Vaskulare
- B) Nervore
- C) Iatrogene
- D) Hormonale
- E) Patologjie e trupit kaverno

PS)A

Pyetja 1449 V)1

Meningiti limfocitar me hipoglikoraki shkaktohet nga

- A) Meningokoku.
- B) Pneumokoku.
- C) Mykobacterium tuberkulozit.
- D) Ekovirus.
- E) Penicilum Roqueforti.

PS)C

Pyetja 1450 V)1

Terapia me gonadotropina mund të realizohet në të gjitha rrethanat e mëposhtme, përveç:

- A) Anovulacionit me nivele të ulura të gonadotropinave.
- B) Anovulacionit me nivele normale të gonadotropinave.
- C) Anovulacionit me nivele të larta të gonadotropinave.
- D) Policistozes ovarike.
- E) Hipogonadizmit hipogonadotropik.

PS)C

Pyetja 1451 V)2

Cili është trajtimi i zgjedhjes së parë në embolinë arteriale?

- A) Terapia fibrinolitike
- B) Vazodilatatorët
- C) Pritje
- D) Antibiotikët
- E) Kortizoni

PS)A

Pyetja 1452 V)2

Refleksi i akomodimit të syve konsiston në:

- A) Midriaze, konvergencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
- B) Midriaze, rotacion intern dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
- C) Miozë, divergjencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
- D) Miozë, konvergencë dhe rritje e kurbaturës së kristalinit.
- E) Miozë, rrotullim ekstern dhe ptosis.

PS)D

Pyetja 1453 V)1

Në prani të insuficiencës hepatike nga hepatiti kronik C, është pak e mundshme të gjendet një shenjë klinike si:

- A) Purpura e palpueshme në gjymtyrët e poshtme
- B) Topitje e lëvizshme gjatë perkusionit abdominal
- C) Flapping tremor
- D) Unaza e Kayser-Fleisch

E) Nevus si merimangë
PS)D

Pyetja 1454 V)2

Dhembja, shpesh e fortë, nivel peri-umbelikal dhe epigastrik dhe posteriorisht në 1/3 e poshtme të toraksit, zakonisht është për shkak të:

- A) Ulcerës gastrike.
- B) Ulcerës duodenale.
- C) Pankreatopatisë akute dhe difuze.
- D) Kolonopatisë e transversum-it.
- E) Kolonopatisë e descenditit dhe sigmoides.

PS)C

Pyetja 1455 V)1

Cili është agjenti etiologjik i pneumonisë atipike primare?

- A) Mykoplasma pneumonie
- B) Legionela pneumofila
- C) Diplokokus pneumonie
- D) Streptokokus pneumonie
- E) Mycoplasma arthritidis

PS)A

Pyetja 1456 V)1

Rezistenca që kundërshton fluksin e gjakut në një vaze gjaku:

- A) Është e pavarur nga statusi i muskulaturës së lëmuar të paretit vazal.
- B) Është në proporcion të kundërt me viskozitetin e gjakut.
- C) Varet nga trashësia e endoteliumit.
- D) Ndryshon në proporcion të drejtë me gjatësinë e vazës.
- E) Zvogëlohet me 12 herë kur rrezja e vazës reduktohet në një të tretën.

PS)D

Pyetja 1457 V)1

Cili nga AIJS e mëposhtëm ka potencialin gastrotoksik më të dobët?

- A) Acidi acetil salicilik
- B) Diklofenak
- C) Indometacina
- D) Paracetamoli
- E) Sulindak

PS)D

Pyetja 1458 V)2

Tek femrat e moshës nën 40 vjeç, mamografia është:

- A) E indikuar.
- B) Potencialisht karcinogenike.
- C) Absolutisht e kundër-indikuar.
- D) Paraqet një rezolucion diagnostik të dobët për problemet e lidhura me përbërjen glandulare.
- E) Ka një rezolucion të madh diagnostik sepse gjendra është me dense.

PS)D

Pyetja 1459 V)1

Nje cist paraziti në shpretkë vjen si pasojë e:

- A) Filarias.
- B) Askarideve.
- C) Entamebas.
- D) Ekinokokut
- E) Tenias.

PS)D

Pyetja 1460 V)3

Degëzimi si gjethe fieri i mukusit endocervikal vërehet:

- A) Në shtatzëni
- B) Në menopauzë
- C) Në fazë ovulatore
- D) Në periudhë menstruale
- E) Në rast të hiper-estrogjenizmit

PS)C

Pyetja 1461 V)2

Në cilën sëmundje renale haset më rrallë hipertensioni?

- A) Pielonefriti kronik
- B) Glomeruloskleroza dianetike
- C) Glomerulonefriti kronik
- D) Tuberkulozi renal
- E) Reni polikistik

PS)D

Pyetja 1462 V)1

Kur një embol mbyll trungun kryesor të arteries pulmonare tek një grua adulte cila do të ishte pasoja?

- A) Vdekja imediate
- B) Infarkti pulmonar hemorragjik
- C) Infarkti pulmonar anemik
- D) Staza pulmonare
- E) Edmea pulmonare

PS)A

Pyetja 1463 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me enzimët është i gabuar ?

- A) Enzimët furnizojnë substratet me energji duke i lejuar kështu të tejkalojnë barrierën e përfaqësuar nga energjia e aktivizimit.
- B) Enzimët janë, në shumicën e rasteve proteina.
- C) Enzimët paraqesin specificitet për substratin.
- D) Aktiviteti i një enzime mund t'i nënshtrohet rregullimit.
- E) Në dekursin e reaksionit enzimatik, normalisht enzima rishfaqet e paalteruar në fund të reaksionit.

PS)A

Pyetja 1464 V)1

Njësia e matjes së fushes magnetike në sistemin ndërkombëtar është:

- A) Gauss/m
- B) Tesla
- C) Weber/cm
- D) A/mq
- E) Xhaul

PS)B

Pyetja 1465 V)1

Kriteri kryesor diagnostik i sëmundjes hemolitike autoimmune bazohet në:

- A) Testin Coomb.
- B) Formën e eritrociteve.
- C) Rezistencën osmotike të eritrociteve.
- D) Praninë e pikëzimeve bazofilike.
- E) Sidereminë.

PS)A

Pyetja 1466 V)3

Një përqindje e madhe e individëve me deficit të alfa-1-antitripsinës zhvillojnë një sëmundje pulmonare obstruktive kronike ose emfizeme. Graviteti i sëmundjes mund të ndikohet në mënyrë domethënëse nëse pacienti është:

- A) Neutropenik.
- B) Homozigote peralelet nul të genit për elastazën.
- C) Një grua.
- D) Heterozigote për një mutacion me një kopje normale të genit për alfa-1-antitripsinën.
- E) Duhanpirës i rëndë.

PS)A

Pyetja 1467 V)2

Çfarë mund të evidentojë ekzaminimi spirometrik në dekursin e astmës bronkiale?

- A) Sindrom disventilator të tipit restriktiv
- B) Vlerat në limitet e normës.
- C) Sindrom disventilator i tipit obstruktiv
- D) Reduktim të volumit rezidual
- E) Reduktim të izoluar të kapacitetit funksional rezidual

PS)C

Pyetja 1468 V)1

Cili nga lezionet e mëposhtëm është pre-kanceroz?

- A) Keratoza atinike
- B) Veruke vulgare
- C) Verruke plana
- D) Keratoza seborroike
- E) Lichen Ruben planus

PS)A

Pyetja 1469 V)2

DSM-IV është një sistem klasifikimi i sëmundjeve psikike:

- A) Hierarkik multiaksial.

- B) Dimensional.
- C) Kategorial.
- D) Hierarkik.
- E) Kategorial multiaksial.

PS)E

Pyetja 1470 V)1

Në cilën gjendje pH i gjakut është i rritur?

- A) Hiperventilim
- B) Eklampi
- C) Acidozë diabetike
- D) Pneumoni
- E) Uremi

PS)A

Pyetja 1471 V)1

Përmbajtja hemoglobinike normale e gjakut tek njeriut është:

- A) 3-5 g%.
- B) 7-10g%.
- C) 13-16g%.
- D) 18-20g%.
- E) 22-25g%.

PS)C

Pyetja 1472 V)1

Depozitimi i komplekseve imune fluoreshente në nivel të membranës bazale glomerulare, vërehet në të gjitha patologjitë e mëposhtme, me përjashtim të:

- A) Glomerulonefritit me lezione minimale.
- B) Glomerulonefritit proliferativ endokapilar.
- C) Glomerulonefritit proliferativ mezangial.
- D) Glomerulonefritit proliferativ endo-extra-kapilar.
- E) Glomerulonefritit proliferativ mezangio-kapilar.

PS)A

Pyetja 1473 V)1

Një obstrukcion urinar që shkakton hidronefrozë tek femija normalisht shkaktohet nga:

- A) Malformacioni kongenital i traktit urinar.
- B) Vaza anormale që komprimojne ureterin.
- C) Kalkula.
- D) 'Kingking' të një ureteri si pasojë e renit heptozik.
- E) Fimozë tepër e rëndë.

PS)A

Pyetja 1474 V)1

Administrimi i TRH-ësë tek një subjekt normal provokon:

- A) Vetëm sekretimin e TSH-ësë.
- B) Sekretimin e TSH-ësë dhe PRL-së.
- C) Sekretimin e TSH-ësë dhe ACTH-së.
- D) Sekretimin e TSH-ës, LH-së e FSH-ësë
- E) Sekretimin e TSH-ës e GH-ësë.

PS)B

Pyetja 1475 V)1

Për të drejtuar ajrin e ambientit të jashtëm drejt alveolave, është e nevojshme të gjenerohet një gradient presioni midis alveolave dhe ajrit ambiental. Cila nga fjalitë e mëposhtme është e vërtetë?

- A) Depresioni intrapleurik (presioni negativ i kavitetit pleural) nuk i transmetohet alveolave.
- B) Përftohet i njëjti fluks ajri duke aplikuar një presion pozitiv në ajrin ekstern, ose një presion të njëjtë negativ intrapleurial.
- C) Ventilatorët artificialë gjenerojnë në mënyrë artificiale një presion negativ intrapleurial.
- D) Alveolat fryhen më tepër kur nuk realizohet reduktimi i presionit pleural.
- E) Tensioni superficial i alveolave frenon transmetimin e depresionit intrapleurial drejt alveolave

PS)B

Pyetja 1476 V)1

Aminoacidet riabsorbohet plotësisht nga filtri glomerular përmes transportit aktiv në:

- A) Ansën ascendente të Henle.
- B) Tubulin proksimal.
- C) Ansen escendente te Henle
- D) Tubulin distal.
- E) Duktusin kolektor.

PS)B

Pyetja 1477 V)1

Disfunksionet seksuale më të zakonshme tek meshkujt janë:

- A) Mungesa e kenaqësisë seksuale.
- B) Ejakulacioni retrograd.
- C) Dispareunia.
- D) Fetishizmi.
- E) Transseksualizmi.

PS)B

Pyetja 1478 V)1

Hormoni luteinizues (LH) ka këto veprime, përveç:

- A) Promocionit e ovulacionit.
- B) Stimulimit të drejtpërdrejtë të spermatogenezës.
- C) Promocionit të luteinizimit të folikujve orvariene.
- D) Stimulimit të prodhimit të progesteronit të corpus luteum.
- E) Stimulimit të sekretimit të testosteronit.

PS)B

Pyetja 1479 V)1

Në grafikun elektroforetik normal, proteinat në sasi më të madhe janë:

- A) Albumina.
- B) Alfa-1-globulina.
- C) Alfa-2-globulina.
- D) Beta-globulina.
- E) Gama-globulina.

PS)A

Pyetja 1480 V)1

Pielonefriti akut:

- A) Është sëmundja karakteristike e seksit mashkull.
- B) Prek vetëm subjektet në moshë të avancuar.
- C) Karakterizohet vetëm nga prania e etheve të tipit septik.
- D) Paraqitet me vlera normale të eritrosedimentit dhe proteinës C reaktive.
- E) Paraqitet me një neutropeni të theksuar.

PS)C

Pyetja 1481 V)3

Cila nga sindromat e mëposhtme epileptike paraqet prognozën më të rëndë?

- A) Epilepsia e tipit të absencave tek femija
- B) Epilepsia e tipit të absencave juvenile
- C) Epilepsia me absenca mioklonike
- D) Epilepsia nioklonike juvenile
- E) Epilepsia parciale beninje e fëmijërisë me maja centro-temporale

PS)C

Pyetja 1482 V)2

Një neoplazi e ventrikulit të IV do të jape lehtësisht:

- A) Hemorragji subaraknoidale.
- B) Verbim.
- C) Malaci multiple.
- D) Hidrocefali.
- E) Paralizë spastike.

PS)D

Pyetja 1483 V)1

Në limfocitogramën e gjakut periferik mbizotërojnë:

- A) Limfocitet gama/delta.
- B) Limfocitet T CD4+.
- C) Limfocitet T CD8+.
- D) Limfocitet B CD19+.
- E) Qelizat Natural Killer NK CD16+.

PS)B

Pyetja 1484 V)1

Hipokalcemia në insuficiencë renale kronike vjen si pasojë e:

- A) Hiperkalciurisë.
- B) Marrjes së pakësuar të kalciumit në dietë.
- C) Mungesës së vitaminës D aktive.
- D) Mungesës së PTH-ësë
- E) Hiperparatiroidizmit.

PS)C

Pyetja 1485 V)2

Në dyshimin klinik të bronkoektazisë me radiografi toraksi në dukje normale është e nevojshme të kërkohet:

- A) Një bronkografi.
- B) Një fibrobronkoscopi.
- C) Një CT skaner toraksi me rezolucion të lartë.
- D) Një shintigrafi vaskulare pulmonare.
- E) Një ekografi toraksi.

PS)C

Pyetja 1486 V)1

Humbja e ujit në 24 orë përmes rrugëve respiratore dhe perspirimit insensibilis tek një subjekt adult i shëndoshë, në kushte ambientale normale është rreth:

- A) 100-200 ml.
- B) 200-400 ml.
- C) 400-800 ml.
- D) 800-1000ml.
- E) 1300-1500ml.

PS)D

Pyetja 1487 V)1

Nitratet:

- A) Japin vazodilatacion vetëm në prani të integritetit endotelial të ruajtur.
- B) Janë vazodilatatorë specifikë për arteriolat dhe vazat prekapilare.
- C) Reduktojnë si input-in ashtu edhe output-in.
- D) Nuk veprojnë mbi muskulin e lemuar ekstravaskular.
- E) Induktojnë efekte inotrope e kronotrope negative.

PS)C

Pyetja 1488 V)2

Cili nga efektet e mëposhtëm të AIJS është i reduktuar në rastin e inhibitorëve selektivë të COX-2?

- A) Efektshmëria anti-inflamatore.
- B) Rreziku i hemorragjisë gastro-intestinale.
- C) Rreziku i insuficiencës renale akute.
- D) Rreziku i nefropatisë nga analgjezikët.
- E) Rreziku i reaksioneve idiosinkrazike.

PS)B

Pyetja 1489 V)1

Cili nga pohimet e mëposhtëm në lidhje me verapamil-in nuk është i saktë ?

- A) Duhet të administrohet në bashkëshoqërim me beta-blokues adrenergjikë.
- B) Është i dobishëm në trajtimin e flaterit atrial.
- C) Është i dobishëm në trajtimin e fibrilacionit atrial.
- D) Efekti i tij inotrop negativ e kufizon përdorimin në rastet me demtime kardiake.
- E) Është i dobishëm në trajtimin e takikardisë supraventrikulare paroksistike.

PS)A

Pyetja 1490 V)2

Një djalë 20 vjeçar u dërgua me urgjencë sepse ishte letargjik, me ethe (T 39°C) dhe petekie. Menjëherë i nënshtrohet punkcionit lumbar dhe likidi cerebro-spinal ka një pamje të ngjashme me një meningit bakterial. Cilin nga këta agjente etiologjikë do

- A) Neisseria gonorrhea

- B) *Neisseria meningitidis*
- C) *Streptococcus pyogenes*
- D) *Listeria monocytogenes*
- E) *Mycobacterium tuberculosis*

PS)B

Pyetja 1491 V)3

Cili nga parametrat e mëposhtëm është një tregues i konsumimit alkoolik të shtuar?

- A) Volumi globular <80fl
- B) Uremia >80mg/dl
- C) Creatinemia urinare < 15mg/kg/dite
- D) Raporti AST/ALT >2
- E) Bilirubina e konjuguar <0.3mg/dl

PS)D

Pyetja 1492 V)1

Është indeks i efikasitetit (fuqisë) së një medikamenti:

- A) $T_{1/2}$
- B) EC_{50}
- C) CL
- D) V_d
- E) AUC

PS)B

Pyetja 1493 V)1

Busulfani është :

- A) Një derivat i metilhidralazinës.
- B) Një antibiotik.
- C) Një agjent alkilant.
- D) Një kortikosteroid.
- E) Një nitrozourë.

PS)C

Pyetja 1494 V)3

Në shumicën e rasteve të membranave biologjike janë të pranishme glikosfingolipidet. Cila pjesë e këtyre molekulave pritet të gjendet vetëm në pjesën e jashtme të membranës?

- A) Zinxhiri akilik i ceramides
- B) Zinxhiri akilik i sfingozinës
- C) Ciladoqoftë pjesë e lipidit
- D) Zinxhiri oligosakaridik
- E) Grupi fosfat

PS)D

Pyetja 1495 V)2

Një tumefacion monolateral i qafës në nivel të fossa supraklavikulare të majtë verëhet me incidencë të shtuar në patologjinë e:

- A) Leucemisë limfatike akute.
- B) Leucemisë limfatike kronike.
- C) Metastazës karcinomatoze të stomakut.
- D) Limfomës Hodgkin.
- E) Limfosarkomatozës.

PS)C

Pyetja 1496 V)2

Diagnoza e malacisë kraniale post-traumatike mund të bëhet përmes radiologjisë duke u nisur nga cili moment i kohës?

- A) Menjëherë
- B) Në distancë 1 mujore
- C) Në distancë 3 mujore
- D) Në distancë prej të paktën 8 muajsh
- E) Pas të paktën 3 vjetësh

PS)D

Pyetja 1497 V)1

Është e saktë të pohosh se hormoni adrenokortikotrop (ACTH) :

- A) Favorizon mobilitetin e kalciumit nga kocka.
- B) Është i natyrës steroidiene.
- C) Sintetizohet në neurohipofizë
- D) Rrit prodhimin e adrenalinës.
- E) Stimulon prodhimin e glukokortikoideve.

PS)E

Pyetja 1498 V)3

Në ultrastrukturën e qelizës epiteliale, Desmozomet janë:

- A) Zgjatime të pjesës apikale të qelizës epiteliale
- B) Kompleks ankorues mes dy qelizave epiteliale
- C) Shtrese sipërfaqësore papilare
- D) Dendeshim i qelizave bazal

PS)B

Pyetja 1499 V)2

Cilën nga funksionet e mëposhtme kryejnë qelizat e Langerhans-it:

- A) Funksion sensor
- B) Funksion kalimtar
- C) Funksion imunologjik
- D) Funksion depozitues

PS)C

Pyetja 1500 V)1

Kandidoza prek me shumë:

- A) Moshën femërore dhe moshën e tretë
- B) Moshën adulte
- C) Adoleshentët
- D) Të gjitha grupmoshat njësoj

PS)A

Pyetja 1501 V)2

Në kandidozën akute Pseudomembranoze, diagnoza diferenciale bëhet me:

- A) Fruthin
 - B) Aftet
 - C) Leukoplakinë
 - D) Difterinë
- PS)D

Pyetja 1502 V)1

Lezione potencialisht malinje:

- A) Aftet Reaktive
 - B) Stomatiti Ulceroz
 - C) Herpes Simplex
 - D) Eritroplakia
- PS)D

Pyetja 1503 V)3

Keiliti Aktinik ka lidhje me:

- A) Faktorë të ndryshëm traumatic
 - B) Çrregullimet e sistemit neurovegjetativ
 - C) Ndriçimin diellor
 - D) Çrregullime të gjëndrave endocrine
- PS)C

Pyetja 1504 V)1

Cili është vargu me renditjen e sakte te 4 stadeve kryesore te Afteve:

- A) Preulçeroz, Ulçeroz, Predormal, I Shërimit
 - B) Predormal, Preulçeroz, Ulçeroz, I Sherimit
 - C) Ulçeroz, Preulçeroz, I Sherimit, Predormal
 - D) Ulçeroz, Preulçeroz, Predormal, I Sherimit
- PS)B

Pyetja 1505 V)3

Cili prej medikamenteve nuk ndikon në hipertrofinë gingivare:

- A) Ceftriaxone
 - B) Kontraceptivët orale
 - C) Ciklosporina
 - D) Nifedipina
- PS)A

Pyetja 1506 V)1

Qelizat përbërëse të ligamentit periodontal janë:

- A) Langerhans, Merkel, Osteoblastet, Osteoklastet, Cementoblastet
 - B) Fibroblastet, Osteoblastet, cementoblastet, Merkel, Langerhans
 - C) Osteoklaste, Cementoklaste, Merkel, Melanocyte, Neutrofile
 - D) Fibroblastet, Osteoblastet, Osteoklastet, Cementoblastet, Cementoklastet
- PS)D

Pyetja 1507 V)1

Hiperplazia gingivare gjatë shtatëzanisë:

- A) Ndodh si pasojë e rritjes së nivelit të estrogenit dhe uljes së progesteronit në minimum

- B) Ndodh si pasojë e rrijjes së nivelit të estrogjenit dhe progesteronit
 - C) Ndikohet nga dieta ushqimore e cila ndryshon gjatë shtatëzanisë
 - D) Përbën një komplikacion me predispozicion gjenetik
- PS)B

Pyetja 1508 V)1

Cili është roli qelizave Merkel në gingivë:

- A) Ndjeshmëri temperature
 - B) Funksion pigmentues
 - C) Funksion imunitar
 - D) Funksion sensorial
- PS)D

Pyetja 1509 V)2

Cementi radikular:

- A) Nuk përmban enë gjaku por ka vetëm inervim
 - B) Nuk rimodelohet por vetëm depozitohet në mënyrë të vazhdueshme
 - C) Mbulon vetëm apaksin dhe siguron lidhjen e kësaj pjese me kockën
 - D) Rimodelohet vazhdimisht por nuk depozitohet në mënyrë të vazhdueshme
- PS)B

Pyetja 1510 V)3

Sëmundja periodontale nekrotizuese:

- A) Shfaqet në të shumtën e rasteve në pacientë me probleme sistematike
 - B) Mund të shkaktojë endokardit bakterial
 - C) Mund të shoqërohet me temperaturë dhe limfadenopati
 - D) Nuk i përgjigjet mirë terapi me antibiotik
- PS)C

Pyetja 1511 V)1

Kariesi i biberonit shkakton:

- A) Inklinim vestibular të maxilës
 - B) Inklinim lingual të mandibulës
 - C) Anomali kockore
 - D) Anomali kockore dhe okluzioni
- PS)D

Pyetja 1512 V)1

Molari i parë permanent preket më shpesh nga kariesi për arsye se

- A) Ka fisurë të thella
 - B) Ka smalt të pamaturuar
 - C) Higjiena jo e mirë sepse ka denticion të përzier
 - D) Të tre faktorët
- PS) D

Pyetja 1513 V)1

Aplikimi i këllëfëve të prefabrikuar aplikohen në dhëmbët e qumështit:

- A) Në molar të kariuar
- B) Në molar të devitalizuar
- C) Në dentinogenezis imperfecta

D) Në molar të devitalizuar dhe të destruktuar
PS)D

Pyetja 1514 V)1

Indi i pamineralizuar i dhëmbit është:

A) Smalti
B) Dentina
C) Pulpa
D) Cementi
PS) C

Pyetja 1515 V)1

Mbulimi indirekt i pulpës në dhëmbët e qumshtit ndikohet sipas stadeve fiziologjike:

A) Në stadin e parë
B) Në stadin e dytë
C) Në stadin e tretë
D) Kur dhëmbi do të qëndrojë për një kohë të gjatë
PS)A

Pyetja 1516 V)1

Në rastin e pulpave në dhëmbët e qumshtit me nekrozë të pulpës me patologji pulpore në stadin e tretë kemi trajtim:

A) Pulpotomi
B) Trajtim dhe mbushje kanalesh
C) Mjekim Biologjik
D) Extraksion
PS)D

Pyetja 1517 V) 1

Cili është disavantazhi i cement glassionomereve në Pedodonti:

A) Adeziv
B) Estetik
C) Lëshon Fluor
D) I prekshëm erozioni
PS) D

Pyetja 1518 V)1

Cili nga medikamentet ka dhënë rezultate të shkëlqyera në pulpotominë pulpore në dhëmbët e qumshtit:

A) Formokrezoli
B) M.T.A
C) Ca(OH)₂
D) Glutaraldehidi
PS)B

Pyetja 1519 V)1

Kur realizohet mbyllja e rrënjës së kaninit maxilar permanent :

A) 10-11 Vjeç
B) 13-14 Vjeç
C) 11-12 Vjeç
D) 9-10 Vjeç
PS)B

Pyetja 1520 V)1

Kur realizohet mbyllja e rrënjës së molarit të dytë permanent:

- A) 10-11 vjeç
- B) 11-13 vjeç
- C) 13-14 vjeç
- D) 14-15 vjeç

PS) D

Pyetja 1521 V)1

Në mjekimin indirekt në dhëmbët permanent me rrënjë të paformuar, kontrolli radiologjik do te bëhet:

- A) Mbas 10 ditëve
- B) Mbas 20 ditëve
- C) Mbas 90 ditëve
- D) Mbas 40 ditëve

PS) C

Pyetja 1522 V)1

Errozioni i smaltit në fëmijë shaktohet nga:

- A) Flora bakteriale e kavitetit oral
- B) Nga dieta e pasur me produkte acide
- C) Nga Bruksizmi
- D) Ekspozimi në një mjedis me acide

PS)B

Pyetja 1523 V)1

Përdorimi i fenildontonoinës në fëmijë shkakton:

- A) Hiperplazi Gingivare
- B) Atrofi Gingivare
- C) Ulceracione papilare
- D) Rezorbim kockor

PS)A

Pyetja 1524 V)1

Diagnoza e një pulpit në dhëmbët e qumështit përcaktohet nga të dhënat:

- A) Anamneza
- B) Testi termik
- C) Testi Klinik
- D) Të treja së bashku

PS)D

Pyetja 1525 V)1

Në pulpotominë parciale sipas CVEK në raste traumash sa milimetra është heqja e pulpës me frezë:

- A) 0,5 mm
- B) 1 mm
- C) 2 mm
- D) 1,5 mm

PS)C

Pyetje 1526 V)1

Në traumat e dhëmbëve anterior, cili është splintimi(fiksimi) më i mirë:

- A) Me kompozit
- B) Me Brackets
- C) Me Titan
- D) Fleksibël

PS)D

Pyetja 1527 V)1

Cili nga këta irrigues në trajtimin e pulpektomisë të dhëmbëve të qumshtit dëmton folikulin e dhëmbit permanent:

- A) Uji Distile
- B) Na OCl 10%
- C) NaOCl 5%
- D) EDTA 17%

PS)D

Pyetja 1528 V)2

Përqindja e malokluzionit si rezultat i humbjes së dhëmbëve të qumshtit konsiderohet

- A) 20%
- B) 40%
- C) 60%
- D) 90%

PS)C

Pyetja 1529 V)2

Në fëmijë, gingivostomatiti herpetik nga një gingivostomatit nekrotik nga çfarë dallohet:

- A) Temperatura
- B) Dhimbje të gingivës marginale
- C) Prezenca e ulçerës të dhimbshme të mukozës dhe gjuhës
- D) Nekrozë të papilës interdentalë

PS)C

Pyetja 1530 V)2

Kërkesa për vitaminë D (ergosteron) për fëmijë është:

- A) 100 UI
- B) 750 UI
- C) 400 UI
- D) 250 UI

PS)C

Pyetja 1531 V)2

Rezorbimi i kaninit maksilar të qumshtit fillon:

- A) Në moshën 5 vjeç
- B) Në moshën 7 vjeç
- C) Në moshën 8 vjeç
- D) Në moshën 9 vjeç

PS)C

Pyetja 1532 V)2

Amelogenезis imperfekta paraqitet në formën:

- A) Hypoplazike
 - B) Hypokalcifikuar
 - C) Hypomaturuar
 - D) Në të tri format
- PS)D

Pyetja 1533 V)2

Rizaliza patologjike takohet në:

- A) Kista
 - B) Neoplazma
 - C) Osteomelit
 - D) Ne te tri format
- PS)D

Pyetja 1534 V)2

Sindromi Turner është i shkaktuar nga:

- A) Dëmtimet traumatike të dhëmbëve të qumështit
 - B) Patologjitë kronike të molarëve të qumështit
 - C) Nga përdorimi i antibiotikeve në moshë të vogël
 - D) Nga mungesa e Ca
- PS)B

Pyetja 1535 V)1

Smalti e merr origjinën nga:

- A) Mezenkima
 - B) Ektoderma
 - C) Kreshta nervore
 - D) Proçeset mandibulare
- PS) B

Pyetja 1536 V)1

Cila përgjigje nuk është e saktë:

- A) GIC(glass ionomer cementet) çlirojnë fluor
 - B) GIC nuk janë biokompatibël me indet e dhëmbit
 - C) GIC janë radiopak
 - D) GIC sigurojnë remineralizimin intern
- PS)B

Pyetja 1537 V)1

Cila nga pohimet e mëposhtëme nuk është i vërtetë:

- A) Smalti është ind aqelizor
 - B) Smalti është asensitiv
 - C) Smalti mund të ripërtërihet
 - D) Smalti është i ndërtuar nga prizma
- PS)C

Pyetja 1538 V)2

Cili nga përbërësit e mëposhtëm të kompoziteve realizon lidhjen midis lëndës organike dhe përforcuesit inorganik?

- A) Hidrokinonet
 - B) Aminat terciare
 - C) Oksidi i titanit
 - D) Silanet
- PS)D

Pyetja 1539 V)2

Në cilën nga teknikat e mbushjes kompoziti mund të vendoset në shtresa 4-5 mm?

- A) Teknika oblike
 - B) Teknika me sferë
 - C) Teknika bulk-fill
 - D) Teknika sandwich
- PS)C

Pyetja 1540 V)2

Në një restaurim me mbyllje të diastemës duhet të :

- A) Theksojmë perikimatën gingivare
 - B) Zbutim elementet vertikal
 - C) Shkurtojmë marginet incizale
 - D) Theksojmë elementët vertikal
- PS)D

Pyetja 1541 V)2

Koncepti i raportit të artë bazohet në :

- A) Raportet e tre dimensioneve të dhembit
 - B) Madhësinë e dukshme të dhëmbëve anterior maksilar
 - C) Madhësinë reale të dhëmbëve anterior maksilar
 - D) Raportin gjerësi – gjatësi të anteriorve maksilar
- PS)B

Pyetja 1542 V)1

Cili nga komponentet e mëposhtem lubrifikon mukozat:

- A) Amylaza
 - B) IgA sekretore
 - C) Mucina
 - D) Lyozima
- PS)C

Pyetja 1543 V)2

Trajtimi i dentinogenezis imperfekta realizohet me :

- A) Restaurime estetike me kompozit
 - B) Faseta
 - C) Korona
 - D) Inleje/onleje
- PS)C

Pyetja 1544 V)2

Lezionet jokarioze karakterizohen nga:

- A) Dhimbje natën

- B) Dhimbje pa shkak
 - C) Hipersensitivitet dentinar
 - D) Dhimbje në perkursion
- PS)C

Pyetja 1545 V)2

Trashësia e smear layer në muret e kavitetit të preparuar :

- A) Varet nga ashpërsia e frezave
 - B) Varet nga madhësia e kavitetit
 - C) Rritet në lezionet jokarioze
 - D) Varet nga sasia e mikroorganizmave
- PS)A

Pyetja 1546 V)2

Cila nga anomalitë e mëposhtëme ka origjinë kongjenitale:

- A) Atricion
 - B) Geminacion
 - C) Erozion
 - D) Rezorbim intern
- PS)B

Pyetja 1547 V)2

Aplikimi i Primerit të sistemeve adezive:

- A) Zgjeron lumenin e tubulave dentinar
 - B) Obliteron tubulat dentinar
 - C) E bën dentinen më hidrofobe
 - D) Eleminon smear layerin
- PS)C

Pyetja 1548 V)2

Llaqet:

- A) Eleminojnë smear layer
 - B) Rritin fuqinë e bondimit
 - C) Obliterojnë tubulat dentinar
 - D) Nxisin formimin e dentinës sekondare.
- PS)C

Pyetja 1549 V)2

Stresi elastik është faktori etiologjik i :

- A) Erozioneve cervikale
 - B) Abfraksioneve
 - C) Hypomineralizimit
 - D) Reçesioneve gingivare
- PS)B

Pyetja 1550 V)1

Qëllimi i acidifikimit është :

- A) Të eliminojë pelikulen
- B) Të eliminojë smear layer
- C) Të obliterojë tubulat dentinar

D) Të nxisë remineralizimin
PS)B

Pyetja 1551 V)2

Për të shmangur hipersensitivitetin dentinar në procedurat e zbardhimit :

- A) Kryejmë anestezi
 - B) Izolojmë gingivat dhe buzët
 - C) Përdorim rubber dam
 - D) Aplikojmë nitratin kaliumi
- PS)D

Pyetja 1552 V)2

Cilin nga acidet e mëposhtëm përdorin sistemet adezive të kompoziteve:

- A) Acid ortofosforik 27%
 - B) Acid polialkenoik 10%
 - C) Acid hidrofluorik 10%
 - D) Acid ortofosforik 37%
- PS)D

Pyetja 1553 V)2

Në cilën nga gjeneratat e sistemeve adezive u reduktua sensitiviteti postoperator:

- A) Gjenerata e IV
 - B) Gjenerata e V
 - C) Gjenerata e VI
 - D) Gjenerata e I-II
- PS)C

Pyetja 1554 V)2

Në një kavitet të preparuar ku trashësia e dentinës nga dhoma pulpare është 2,5 mm cilin nga materialet e mëposhtëme do të përdorni për izolim:

- A) Hidroksid kalciumi
 - B) Kalcimol
 - C) Glass ionomer cement
 - D) Asnjë
- PS)D

Pyetja 1555 V)1

Cila thënie e mëposhtme është e vërtetë?

- A) Silantet janë më efektive në parandalimin e kariesit në sipërfaqet e lëmuara.
 - B) Fluori është më efektiv në parandalimin e kariesit në fisura.
 - C) Fluori rekomandohet të jepet si suplement te individët që hyjnë në grupin me rrezikshmëri të lartë ndaj kariesit.
 - D) Filli dentar eliminon totalisht pllakën bakteriale.
- PS)C

Pyetja 1556 V)1

Kariesi dentarprek:

- A) Vetëm Zmaltin
- B) Vetëm Dentinën

- C) Të gjitha indet e forta të dhëmbit
 - D) Pulpën
- PS)C

Pyetja 1557 V)3

Cilat nga bakteriet e mëposhtme nuk ka veti kariogjene:

- A) Streptokoku mutans
 - B) Streptokoku Sobrinus
 - C) Enterokoku fekalis
 - D) Aktinomicetet
- PS)C

Pyetja 1558 V)1

Kariesidentar koronar prek më tepër moshën:

- A) Feminore
 - B) Adulte
 - C) Moshën e tretë
 - D) Adoleshentët
- PS)A

Pyetja 1559 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm nuk luan rol në procesin e demineralizimit:

- A) xerostomia
 - B) higjena e keqe
 - C) bakteriet
 - D) kriprat minerale
- PS)D

Pyetja 1560 V)3

Niveli i kariesit dentar është më i lartë:

- A) Tek individët me nivel të lartë social ekonomik
 - B) Tek individët që përdorin ujë të fluorizuar
 - C) Tek individët që kanë një sekretim normal të pështymës.
 - D) Tek individët që vuajnë nga patologji të përgjithshme të cilat prekin edhe sistemin endokrin.
- PS)D

Pyetja 1561 V)3

Në patologjinë e kariesit dentar faktori gjenetikë ndikon në:

- A) Transmetimin gjenetik të patologjisë së kariesit dentar.
 - B) Transmetimin e bakterieve kariogjenike.
 - C) Transmetimin e strukturës së indeve të dhëmbëve, gjëndrave salivare
 - D) Transmetimin e procesit të demineralizimit
- PS)C

Pyetja 1562 V)1

Në fazën pre-eruptive ushqyerja ndikon:

- A) Në formimin dhe maturimin e indeve dhëmbore
- B) Në prekshmërinë e individit nga kariesi
- C) Sasinë e pështymës

D) Në procesin e remineralizimit
PS)A

Pyetja 1563 V)2

Në rastet e një keq ushqyerje proteinike kemi:

A) Nxitjet e demineralizimit
B) Patologjia periodontale është më e shprehur se sa kariesi dentarë
C) Nxitet aktiviteti mitotik
D) Vetëm karies dentar
PS)B

Pyetja 1564 V)1

Mungesa e kriprave minerale Ca (calcium) dhe P (fosfor) sjell:

A) Hipermineralizim të indeve dhëmbore
B) Daljet e parakohshme të dhëmbëve
C) Hipomineralizim të strukturës dhëmbore
D) Nxitje të procesit të remineralizimit
PS)C

Pyetja 1565 V)3

Në rastin e A vitaminozës C (mungeses se vitaminës C) kemi:

A) Dëmtim të procesit të shërimit
B) Hipomineralizim
C) Hipermineralizim
D) Celiosis
PS)A

Pyetja 1566 V)2

Cilat nga sheqernat e mëposhtme ka më pak veti kariogjene:

A) Maltoza
B) Sakaroza
C) Galaktoza
D) Xylitoli
PS)D

Pyetja 1567 V)1

Për moshën e tretë është më i shprehur:

A) Kariesi koronar
B) Kariesi fisural
C) Kariesi radikular
D) Kariesi sekondar
PS)C

Pyetja 1568 V)1

Shkaku kryesor i kancerit të gojës për moshën e tretë është:

A) Protezat difektoze
B) Infamacioni i mukozës së gojës
C) Diabeti
D) Konsumi i alkoolit dhe duhanit

PS)D

Pyetja 1569 V)3

Në Shqipëri doza ditore e suplementeve të fluorit (tablet ose sol) për fëmijët e moshës 2 vjeç, kur niveli i fluorit në ujin e pijshëm është <0.3 ppm duhet të jetë:

- A) 0 ppm
- B) 0.25mg
- C) 0.75 mg
- D) 1 mg

PS)B

Pyetja 1570 V)1

Funksioni i forcës së dhëmbëve në higjenën orale është:

- A) Kimik
- B) Mekanik
- C) Neutral
- D) Të treja janë të vërteta

PS)B

Pyetja 1571 V)2

Furçat interdental nuk përdoren në:

- A) Në hapësirat ndërdhëmbore tek fëmijët
- B) Tek fëmijët me aparate ortodontike fikse
- C) Për pastrimin e urave
- D) Për pastrimin e atashmenteve dhe implanteve

PS)A

Pyetja 1572 V)2

Komponenti aktiv në pastat dhëmbore me efekt zbardhues është:

- A) Jonet Ca^{++}
- B) Sorbitoli
- C) Peroksidi
- D) Triklosani

PS)C

Pyetja 1573 V)3

Shplarësit e zgjasin efektin e tyre në zgavrën e gojës deri në:

- A) 1 orë
- B) 4 orë
- C) 6 orë
- D) 12 orë

PS)D

Pyetja 1574 V)1

Cili nga faktorët e mëposhtëm ka më pak rëndësi në lindjen e kariesit dentar:

- A) Lloji i karbohidrateve
- B) Shpeshtësia e marrjes së karbohidrateve
- C) Konsistenca e karbohidrateve
- D) Kushtet e ruajtjes së karbohidrateve

PS)D

Pyetja 1575 V)2

Doza e Fluorit në pastat dhëmbore për fëmijë 3-6 vjec duhet të jetë :

- A) 500ppm
- B) 900 ppm
- C) 1000 ppm
- D) 1450 ppm

PS)A

Pyetja 1576 V)3

Ciët nga faktorët nuk ndikon në fillimin e sëmundshmërisë periodontale?

- A) Pllaka
- B) Mekanizmat mbrojtës të bartësit
- C) Epiteli sulkular
- D) Agjentët ekzogjenë antimikrobia

PS)C

Pyetja 1577 V)1

Cila nga alternativat e mëposhtme mund të përdoret për të parandaluar grumbullimin e tepërt të pllakës?

- A) Mekanizmat mbrojtës të bartësit
- B) Larja efektive e dhëmbëve
- C) Tabletat zbuluese të bio filmit
- D) Shplarja e gojës

PS)B

Pyetja 1578 V)3

Për formimin e gurit subgingivar kriprat minerale vijnë kryesisht nga:

- A) Endotoksina
- B) Eksudati inflamator
- C) Epiteli Sulkular
- D) Likidi muko-gingivar

PS)B